Vlerësimi i nevojave:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore

në Ballkanin Perëndimor



IOM Development Fund
DEVELOPING CAPACITIES IN MIGRATION MANAGEMENT

International Organization for Migration (IOM)

Pikëpamjet e shprehura ne këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Organizates Ndërkombëtare për Migracionin (ONM). Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë raport nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e ONM në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti ose zone, ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me kufijtëe tij.

ONM është e përkushtuar ndaj parimit se migracioni njerëzor dhe i rregullt është në përfitim të migrantëve dhe shoqërisë. Si një organizatë ndërqeveritare, ONM bashkëpunon me partnerët e saj në komunitetin ndërkombëtar: për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve aktuale të migracionit; për të çuar përpara të kuptuarit e çështjeve të migracionit; inkurajuar zhvillimin social dhe ekonomik nëpërmjet migracionit; dhe mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe mirëqenien e migrantëve.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin dëshiron të falënderojë Fondin e Zhvillimit të ONM për mbështetjen financiare për hartimin dhe botimin e këtij studimi si edhe Qeverinë e Italisë për kontributin financiar për zbatimin e aktiviteteve të vlerësimit të nevojave të lidhura me të.

Botues: Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
17 route des Morillons
1211 Geneva 19
Switzerland
Tel: +41.22.717 91 11
Fax: +41.22.798 61 50
E-mail: hq@iom.int
Internet: http://www.iom.int

© 2014 Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në çdo formë ose me çdo mjet, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistrues, ose ndryshe pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

IOM Development Fund
DEVELOPING CAPACITIES IN MIGRATION MANAGEMENT

International Organization for Migration (IOM)

Farnesina
Ministero degli Affari Esteri
e della Cooperazione Internazionale

Vlerësimi i nevojave:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor

Përgatitur për
Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin
nga **Grupi i Komunikimit të Studimit**

Jacqueline Berman
Donatella Bradic
Phil Marshal

www.rcgglobal.net

Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes....4
Akronime dhe shkurtime....5
Lista e Tabelave....6
Lista e Shtojcave....7
Falënderime....8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE....11
1.HYRJE DHE SFONDI....19
1.1 Sfondi dhe Konteksti....20
2. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NEVOJAVE....27
2.1 Kufizimet ndaj Vlerësimit të Nevojave....31
3. REZULTATET DHE GJETJET E VLERËSIMIT TË NEVOJAVE....35
3.1 Tendencat që po shfaqen në TP....35
3.2 IIdentifikimi dhe referimi....46
3.3 Mbështetje dhe shërbime....53
3.4 Bashkëpunimi mes aktorëve kundër trafikimit....60
3.5 Boshllëqe në identifikim, referim dhe ndihmë....65
4. TAKIM VLERËSIMI....75
4.1 Prioritizimi nga takimi në grupe të vogla....75
4.2 Prioritizimi dhe përmirësimet në takimin e gjithë grupit....80
4.3 Komente të pjesëmarrësve në takim....83
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME....85
Referenca....97

Akronime dhe shkurtime

BH	Bosnjë Hercegovina
CIS	Komunuelthi i Shteteve të Pavarura
KiE	Këshilli i Europës
KEDNJ	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
BE	Bashkimi Europian
FRONTEX	Agjencia Europiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit
ONQ	Organizatë Ndërqeveritare
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IO	Organizatë Ndërkombëtare
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
MoU	Memorandum Mirëkuptimi
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
MKR	Mekanizëm Kombëtar Referimi
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
KBPEJL	Konventa e Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore
SDC	Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim
EJL	Europa Juglindore
SELEC	Qendra e Europës Juglindore për Zbatimin e Ligjit
SOP	Procedura Standarde Pune
TP	Trafikimi i Personave
TQNJ	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
MNR	Mekanizëm Ndërkombëtar Referimi
USAID	Zhvillimi Ndërkombëtar dhe Ndihma e Shteteve të Bashkuara
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNSC	Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara
VT	Viktima të Trafikimit
BP	Ballkani Perëndimor

Lista e Tabelave

Tabela 1: Kuadri i IOM-it për Vlerësimin e Nevojave kundër Trafikimit në Ballkanin Perëndimor....22

Tabela 2: Numri Intervistave sipas nën-rajonit....29

Tabela 3: Të intervistuarit e sondazhit sipas Rolit dhe Zonës, në përqindje....30

Tabela 4: Politikat dhe Praktikat e Identifikimit....47

Tabela 5: Shërbimet mbështetëse që ofrohen në Rajon (në përqindje)....57

Tabela 6: Range and Quality of Available VoT Support Services (in percentages)....58

Tabela 7: Gama dhe cilësia e shërbimeve që ofrohen për rastet e trafikimit....59

Tabela 8: Prioritizimi i Rekomandimeve të Grupit të Vogël....76

Tabela 9: Prioritizimi sipas të gjithë grupit (shpeshtia)....80

Tabela 10: Rekomandimet e renditura sipas prioritetit....82

Lista e Shtojcave

Shtojca A Termat e Referencës 104-109

Shtojca B Mekanizmat Kuadër për Identifikimin e Aktorëve të Vlerësimit të Nevojave 110-117

Shtojca C Lista e Dokumenteve të Rishikuara 118-121

Shtojca D Guida e Intervistës 122-126

Shtojca E Sondazhi 127-139

Shtojca F Fjalori Analitik i Kodeve 140-143

Shtojca G Takimi i punës së Aktorëve 144-145

Shtojca H Prezantimi në Takimin e e punës së Aktorëve 146-162

Falënderime

Autorët falënderojnë stafin e IOM për kontributin dhe mbështetjen: Gianluca Rocco, Anh Nguyen, Myra Albu, Euridice Márquez Sánchez, Ivona Todorovska, Andrea Dabizzi, Alketa Gaxha, Habib Habibi, Marko Perovic, Edita Selimbegovic, Dusica Zivkovic, Jorge Baca, Sonja Bozinovska, Alma Jani, dhe Lidija Markovic si edhe personat e mëposhtme:

Shqipëri: Znj. Elona Gjebrea (Hoxha), Zëvendës Ministre e Punëve të Brendshme, Koordinatore Kombëtare e Anti-Trafikimit; **Znj. Etleva Bisha**, Drejtoreshë e Shërbimit Social Shtetëror; **Z. Engjëll Begalla,** Drejtor, Departamenti i Çështjeve Konsullore & Diasporës, Ministria e Punëve të Jashtme; **Znj. Denada Seferi,** Shefe e Departamentit të Kujdesit dhe Shërbimit Social, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; **Znj. Emanuela Tollozhina,** Shefe e Sektorit të Shëndetit Mendor dhe Adiktologjisë, Ministria e Shëndetësisë; **Znj. Anila Trimi,** Specialiste e Anti-Trafikimit, Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit; **Znj. Matilda Nonaj,** Specialiste, Departamenti i Kujdesit Social dhe i Shërbimeve të Integruara, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; **Znj. Merita Beqiri,** Specialiste, Shërbimi Social Shtetëror; **Z. Sandër Simoni,** Kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda; **Znj. Erviola Stoja,** Prokurore, Prokuroria e Krimeve të Rënda; **Z. Nathaniel Haft,** Oficer Politik, Ambasada e SHBA në Tiranë; **Z. Mark Stikevers,** Programi ICITAP; **Znj. Tamara Agolli,** Përfaqësuese e ICMPD në Shqipëri; **Znj. Juliana Rexha,** Oficere Kombëtare e Anti-trafikimit, Departamenti i Çështjeve mjedisore, ekonomike dhe të qeverisjes, Prania e OSBE-së në Shqipëri; Koalicioni Kombëtar Shqiptar i Strehëzave të Anti-Trafikimit**; Znj. Mariana Meshi,** Drejtoreshë, OJQ, Të Ndryshëm dhe të Barabartë; **Znj. Brikena Puka,** Drejtoreshë, Qendra Psiko-sociale, OJQ**, Z. Arian Çala,** Drejtor, OJQ, Tjetër Vision; **Znj. Rajmonda Bozo,** Presidente, Koalicioni Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve.

Bosnjë Hercegovinë: Z. Samir Rizvo, Departamenti për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Ministria e Sigurisë; **Znj. Saliha Djuderija**, Ministre e Shtetit për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët, **Z. Mevludin Omerbegovic**, Drejtoria për Koordinimin e Organeve Policore të Bosnjë Hercegovinës; **Znj. Sabiha Husic**, OJQ, Medica Zenica; **Z. Bojan Arula**, OJQ, Nova Generacija, Banja Luka; **Znj. Amela Efendic**, OJQ, Forumi Ndërkombëtar i Solidaritetit, Sarajevë.

Kosova e administruar nga Rezoluta e UNSC 1244: Z. Sasa Rasic, Koordinatori Kombëtar i Anti-Trafikimit, **Z. Ramadan Ahmeti**, Departamenti kundër Krimit të Organizuar, Sektori për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore; **Znj. Sendrine Constant**, Terre des Homes, **Znj. Luljeta Gjonbala**, USAID; **Znj. Emel Ajdini**, OJQ, Integra.

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: **Znj. Violeta Jankovska,** Ministre e Punëve të Brendshme, Koordinatore Kombëtare e Anti-Trafikimit; **Z. Sande Kitanov**, Drejtues, Njësia për Luftën kundër Trafikimit dhe Migracionit të Paligjshëm, Zëvendës Koordinator Kombëtar i Anti-trafikimit; **Znj. Elena Grozdanova**, Këshilltare Shteti, Ministria e Punës dhe e Politikave Sociale, **Znj. Svetlana Cvetkovska**, Koordinatore e Zyrës së Mekanizmit Kombëtar të Referimit, Ministria e Punës dhe e Politikave Sociale, **Znj. Verica Stamenkova Trajkova**, Drejtoreshë, OJQ, Për një Fëmijëri të Lumtur; **Znj. Jasmina Dimiskovska Rajkovska**, Drejtoreshë, OJQ, Portë e Hapur/La Strada; **Z. Ljupco Markudov**, Njësia për Luftën kundër Trafikimit dhe Migracionit të Paligjshëm; **Z. Adrian Ismaili**, Asistent Politik, Ambasada e SHBA-ve në Shkup; **Z. Zoran Drangovski**, Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj; **Znj. Sanija Burageva**, OJQ, Akses i Barabartë.

Mali i Zi: **Z. Zoran Ulama**, Shef i Zyrës së Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore; **Znj. Daliborka Mugosa**, Zyra e Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore; **Znj. Marijana Radunovic**, Zyra e Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore; **Znj. Valentina Vlahovic**, Lobimi i Grave Malazeze; **Z. Marko Brajovic**, Drejtoria e Policisë, Njësia kundë Krimit të Organizuar.

Serbi: Z. Mitar Djuraskovic, Koordinator i Anti-Trafikimit, Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë; **Z. Dragan Vulevic**, Ministria e Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Politikave Sociale të Republikës së Serbisë; **Znj. Sanja Kljajic** dhe **Znj. Lidija Milanovic**, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore; **Znj. Marijana Savic**, OJQ, Atina; **Znj. Jovana Mihajlovic**, Bashkëpunimi dhe Zhvillimi Zvicerian, Serbi.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin dëshiron të falënderojë Fondin e Zhvillimit të ONM për mbështetjen financiare për hartimin dhe botimin e këtij studimi si edhe Qeverinë e Italisë për kontributin financiar për zbatimin e aktiviteteve të vlerësimit të nevojave të lidhura me të.

Vlerësimi i nevojave:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në shtator 2013, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ndërmori një vlerësim gjashtë mujor për situatën e trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë [BH] Kosovën e administruar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së[1] [Kosovë], ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbi)[2].

Qëllimi i vlerësimit të nevojave ishte mbledhja dhe përmbledhja e këndvështrimeve të aktorëve të ndryshëm për situatën aktuale të mekanizmave dhe burimeve në dispozicion të luftës kundër trafikimit të personave (TP) në rajon. Vlerësimi synonte identifikimin e opinioneve të aktorëve për boshllëqet kyçe në lidhje me identifikimin dhe referimin e personave të trafikuar, si edhe ndihmën dhe mbështetjen për ta. Aktorëve gjithashtu u janë kërkuar rekomandime për mënyrën se si mund të përmirësohen jo vetëm përgjigjet/reagimet ekzistuese ndaj problemit në fjalë, por edhe proceset e papërshtatshme dhe për plotësimin e boshllëqeve thelbësore në burimet rajonale të anti-trafikimit.[3]

Fokusi parësor si tek identifikimi i menjëhershëm dhe i saktë i çështjeve të trafikimit, ashtu edhe tek trajtimi i duhur i tyre tregon se sa thelbësore janë këto hapa për reagimin e efektshëm ndaj TP. Pa identifikimin e duhur të rasteve nuk është e mundur as që të identifikohen, kapen dhe ndiqen penalisht rrjetet e trafikimit, as edhe të nxirren të dhënat e kërkuara për të informuar rreth veprimtarive parandaluese dhe për të përmirësuar politikat. Pa referimin e duhur dhe mbështetjen e duhur për të gjithë personat që kanë qenë objekt trafikimi dhe shfrytëzimi, nuk është e mundur që të jepet një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj trafikimit. Ndaj, vlerësimi i nevojave është fokusuar në këto dy komponentë të përgjigjes/reagimit ndaj trafikimit në rajon.

1 Kosova e administruar nga Rezoluta e UNSC 1244. Tani e më poshtë, Kosova.

2 Rajoni i Ballkanit Perëndimor tradicionalisht përfshin Kroacinë, por anëtarësimi i fundit në Bashkimin Europian e riorienton pozicionin e saj si vend origjine, tranziti dhe destionacioni për trafikimin e qenieve njerëzore, si edhe burimet në dispozicion për ta trajtuar atë.

3 Siç është e nevojshme për një vlerësim nevojash, gjetjet dhe rekomandimet në këtë raport pasqyrojnë këndvështrimet e aktorëve dhe jo një vlerësim objektiv, empirik të panoramës së TP në rajon. Është pozicioni i këndvështrimit të aktorëve si provë empirike e studimit ai që drejtoi (1) metodën e studimit për të analizuar këndvështrimin e aktorëve si bazë të zhvillimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të studimit, dhe (2) zgjedhjen dhe zhvillimin e metodologjisë, përfshirë mënyrën e mbledhjes së të dhënave, instrumentet dhe metodat analitike.

Vlerësimi i nevojave përfshin gjashtë hapa kryesore: (1) rishikimin që përbëhet nga mbledhja, kodimi dhe analizimi i dokumenteve të identifikuara dhe të kërkuara nga IOM dhe të plotësuara nga ekipi kërkimor; (2) zhvillimin e dy mekanizmave për identifikimin e aktorëve dhe rolet e tyre për t'u përfshirë në vlerësimin e nevojave; (3) intervista ballë për ballë dhe nëpërmjet telefonit me 37 aktorë; (4) sondazh online i stafit të IOM (në zyra rajonale, nënrajonale dhe jashtë tyre) dhe aktorëve të tjerë (që jep 99 pyetësorë nga 135 të plotësuar, pra 73 përqind); (5) analizimin dhe trekëndëzimin e të gjitha burimeve të të dhënave duke përdorur një skemë kodimi të strukturuar për të hartuar gjetjet dhe rekomandimet fillestare; si edhe (6) përfaqësimin dhe korrigjimin/vlerësimin e gjetjeve të studimit dhe rekomandimeve në një seminar me aktorët e lartpërmendur.

Metodologjia e vlerësimit të nevojave ka disa kufizime të rëndësishme, nga të cilat tre të parat u identifikuar që në fillim të vlerësimit. Këto kufizime janë si më poshtë:

1. Përdorimi i këndvështrimeve dhe reagimeve të aktorëve si burim parësor i të dhënave, do të thotë që të dhënat e studimit bazohen në njohuritë subjektive të aktorëve për situatën e TP, në këndvështrimet e tyre personale për mangësitë në burimet e ndryshme dhe në reagime dhe përshtypje individuale për atë që duhet të bëhet për të trajtuar këto boshllëqe në momentin e vlerësimit të nevojave. Edhe pse mënyra si është hartuar studimi kërkon ta zbusë këtë me anën e një rishikimi në nivel të lartë të studimit të kryer nga pala e tretë në lidhje me temën, puna kërkimore nuk duhet të shihet si një skanim dhe analizë objektive e situatës së TP në rajon.
2. Përzgjedhja jo e rastësishme e kampionëve për sondazhin dhe intervistat pengon përgjithësimin e gjetjeve për popullata të mëdha prej të cilave janë marrë kampionët. Ekipi nuk mund të prezumojë që këndvështrimet e donatorëve, partnerëve, OJQ-ve dhe organizatave ndërqeveritare dhe stafi tjetër të identifikuar i përfshirë në studim dhe i identifikuar nga IOM përfaqësojnë opinionet e të gjithë stafit në të gjitha institucionet, nën-rajonale apo ato në mbarë rajonin.
3. Disponueshmëria e të dhënave për rishikim në mbarë rajonin dhe nën-rajone nuk ka qenë e njëjtë, siç ka qenë ajo e informatorëve për intervista të detajuara.
4. Gjetjet dhe rekomandimet që u janë dhënë aktorëve në seminar janë bazuar në kërkimin e pavarur dhe vlerësimin e këndvështrimeve dhe burimeve të shumëfishta. Kështu nuk garantohet që ato pasqyrojnë këndvështrimet e cilitdo aktori. Prandaj, një seminar nuk siguron pranimin dhe mbështetjen për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e studimit.

Gjithashtu, edhe pse ekipi fillimisht mendoi që të bënte dallim ndërmjet rekomandimeve të aktorëve përsa u përkiste hapave të menjëhershme që

duheshin ndërmarrë, qëllimeve të ndërmjtme dhe atyre afatgjata, më shumë se 90 përqind e aktorëve të intervistuar zgjodhën që të mos bëhej ky dallim. Për rrjedhojë, rekomandimet nuk janë ndarë në këtë mënyrë.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, qasja me metoda të ndryshme e bazuar në të dhëna cilësore dhe sasiore dhe gjetje të trekëndëzuara mund të jepte gjetje të shumëfishta dhe të qëndrueshme në lidhje me burimet, boshllëqet dhe nevojat për të luftuar trafikimin në rajon.

Gjetjet e Vlerësimit të Nevojave

Vlerësimi i nevojave identifikoi gjithsej 20 gjetje parësore. Gjetjet nuk mbulonin çdo pyetje të bërë apo temë të ngritur gjatë mbledhjes së të dhënave. Megjithatë, ato u fokusuan në çështje (1) që citohen më shpesh nga informatorët, të intervistuarit dhe dokumentet; (2) të cilave informatorët, të intervistuarit dhe dokumentet i kushtonin më shumë kohë ose hapësirë diskutimi; dhe (3) që më shpesh ishin identifikuar si më të rëndësishme nga të intervistuarit dhe dokumentet rajonale/nën-rajonale. Ekipi kërkimor i grupoi gjetjet sipas pesë fushave kyçe të mëposhtme: (1) tendencat në shfaqje në lidhje me TP; (2) identifikimi dhe referimi; (3) mbështetja për personat që kanë qenë objekt trafikimi; (4) bashkëpunimi me aktorët e ndryshëm kundër TP; dhe (5) boshllëqet në identifikim, referim dhe programet e mbrojtjes.

Tendencat që po shfaqen në lidhje me TP

Vlerësimi identifikoi disa tendenca që po shfaqen në llojin dhe formën e TP në rajon, si më poshtë:

- Trafikimi i personave në Ballkanin Perëndimor përfshin modele të shumëfishta, forma të shumta shfrytëzimi dhe forma të shumta shtrëngimi/vulnerabiliteti
- Migracioni i parregullt po shtohet në rajonin e Ballkanit Perëndimor
- Informatorët në rajon raportojnë rritje të trafikimit të brendshëm, duke dhënë shpjegime të ndryshme për këtë rritje
- Raste të trafikimit në forma të shumëfishta të shfrytëzimit për punë duket se po shtohen në Ballkanin Perëndimor
- Forma të reja të shfrytëzimit të fëmijëve janë shfaqur në rajon
- OJQ-të dhe nëpunësit e qeverisë kanë perceptime të ndryshme për qëllimin dhe mjaftueshmërinë e përgjigjes/reagimit ndaj TP në rajon

Megjithatë, të dhënat nuk japin informacion se deri në ç'shkallë këto tendenca përfaqësojnë modele të reja trafikimi apo pasqyrojnë dallim/njohje të shtuar të modeleve ekzistuese. Për shembull, të dhënat janë të ndryshme në lidhje me masën në të cilën trafikimi për lypjen e organizuar nga fëmijët ka qenë fenomen i ri apo nëse është një fenomen i vjetër që vetëm së fundmi është parë si formë e TP.

Identifikimi dhe referimi i rasteve të TP

Në lidhje me kuadrin ekzistues për identifikim dhe referim të rasteve (të mundshme) të trafikimit të qenieve njerëzore, vlerësimi i nevojave konstaton që:

- Rajoni ka disa sisteme të ndryshme dhe ndonjëherë kontradiktore për identifikimin e rasteve të TP
- Mekanizmi i identifikimit paraqet disa dobësi përfshirë varësinë e tepruar tek policia, mospërputhje në përkufizim dhe kufizime institucionale
- Mospërfshirja e inspektorëve të punës nga proceset e identifikimit dhe përjashtimi i shfrytëzimit për punë nga përkufizimet e TP janë pengesa të mëdha për identifikimin e rasteve dhe dhënien e reagimit të plotë ndaj TP

Mbështetja në dispozicion

Gjetjet në lidhje me mbrojtjen dhe ndihmën për trafikimin e personave fokusohen në çështje gjithëpërfshirëse në mbarë rajonin, përfshirë sa më poshtë:

- Ndihma në dispozicion është kryesisht në formën e strehëzave të cilat drejtohen nga OJQ-të. Asnjë vend nuk ka një strehëz të dedikuar për fëmijët ose meshkujt të cilët kanë qenë objekt trafikimi
- Periudhat e reflektimit dhe lejet e qëndrimit të përkohshëm ofrohen, por shpesh vetëm në rast bashkëpunimi me autoritetet
- Në pak raste është dhënë shpërblim, ose nga trafikantët ose nga shteti, me sa duket për shkak të procedurave komplekse ose jo funksionale, mungesa e mbështetjes ligjore dhe në disa raste mungesa e inkurajimit nga autoritetet
- Rajoni ofron disa shërbime mbështetjeje dhe shërbime për personat e trafikuar. Cilësia dhe gama e këtyre shërbimeve synojnë që të variojnë me llojin e trafikimit të përjetuar- sektori i brendshëm, ndërkombëtar dhe i punës

Bashkëpunimi mes aktorëve të anti-trafikimit

Gjetjet për partneritetet, rrjetet dhe bashkëpunimin trajtojnë çështje në lidhje me bashkëpunimin formal dhe informal brenda dhe përmes kufijve në përgjigje të TP, përfshirë mekanizmat kombëtare dhe ndërkombëtare të referimit. Ato gjithashtu theksojnë dallimet ndërmjet proceseve siç përcaktohen në letër dhe reagimet ndaj trafikimit si të operacionalizuar dhe të zbatuar në praktikë, sidomos që:

- Pavarësisht proceseve të bashkëpunimit të shumëfishtë në vend, aktorët nuk shohin që zbatimi i këtyre mekanizmave është i plotë apo plotësisht funksional
- Ndërsa ekzistojnë një sërë marrëveshjesh rajonale dhe dypalëshe kundër trafikimit, shumë prej tyre nuk janë operacionale, duke i lënë aktorët

të mbështeten në rrjete informale për të bashkërenduar reagimet ndërkufitare ndaj trafikimit

Boshllëqe në identifikim, referim dhe ndihmë

Gjetjet në lidhje me mekanizmat e identifikimit dhe referimit dhe programet e mbrojtjes dhe ndihmës zbulojnë disa boshllëqe kryesore që ndërthurnin një gamë çështjesh përfshirë disponueshmërinë dhe funksionalitetin e mekanizmave të identifikimit, zbatimin e ligjeve që synojnë mbrojtjen e personave të trafikuar, shërbimet e mbështetjes dhe riintegrimit dhe bashkëpunimin ndërmjet aktorëve kundër TP:

- Rajonit i mungojnë mekanizmat e efektshme për identifikimin e shpejtë dhe të saktë të personave të trafikuar. Ky boshllëk rezulton në shkallën e ulët të identifikimit të llojeve të ndryshme të rasteve të trafikimit. Çështje specifike përfshijnë:
    - Probleme me kuadrin ligjor bazë
    - Mungesën e identifikimit proaktiv në vende ku mund të gjenden raste
    - Mospërfshirjen e të gjithë sektorëve të nevojshëm në identifikim
    - Mungesën e kapacitetit mes aktorëve kyç të përfshirë në identifikim
    - Mungesa thelbësore të vullnetit politik në disa raste
- Shërbimet afatgjata të riintegrimit mbeten sfidë në mbarë rajonin
- Ligjet e krijuara për të mbrojtur personat që kanë qenë objekt trafikimi funksionojnë dhe zbatohen jo në mënyrë të qëndrueshme në rajon
- Në shumë raste nuk ofrohet shërbim i duhur nga mbështetja dhe shërbimet në dispozicion
- Ka shumë pak shërbime që të sigurojnë se ndihma e cila i ofrohet personave që kanë qenë objekt trafikimi (1) të plotësojë standardet minimale dhe (2) të konsiderohet e mjaftueshme nga vetë viktimat.

Rekomandime të Vlerësimit të Nevojave

Rekomandimet që rrjedhin nga këndvështrimet e aktorëve dhe këto gjetje synojnë të trajtojnë boshllëqet parësore dhe përparësitë e identifikuara në nivel rajonal. Rekomandimet parësore pasqyrojnë sugjerimet e bëra nga informatorët e intervistuar dhe nga të intervistuarit nëpërmjet sondazhit, si edhe të diskutuara dhe të vlerësuara në takimin e punës së aktorëve. Prandaj, jo të gjitha rekomandimet do të jenë njësoj të rëndësishme për çdo vend. Gjithashtu, rekomandimet në shtetëror dhe përparësitë për veprim përfshihen në seksionin e rekomandimeve të raportit (seksioni 5). Sipas temës jepen 15 rekomandime të njëpasnjëshme; renditja e rekomandimeve të dhëna nuk pasqyron rëndësinë e tyre.

Identifikimi i personave të trafikuar

Rekomandimi 1: Të konsiderohet përfshirja e një game më të madhe aktorësh në identifikimin proaktiv të rasteve të trafikimit. Këta aktorë duhet të përfshijnë: inspektorë të punës, profesionistë në fushën e shëndetësisë, punonjës socialë dhe mësues.

Rekomandim 2: Të punohet për të përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet e policisë – dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në proces – për të identifikuar rastet e trafikimit përfshirë kontrollin, intervistimin dhe referimin e rasteve siç duhet.

Rekomandimi 3: Të forcohen kapacitetet dhe motivimi i të gjithë aktorëve përgjegjës për identifikimin e rasteve të trafikimit.

Rekomandim 4: Të ndiqet një qasje proaktive për identifikimin e rasteve të trafikimit duke:

a. Inkurajuar inspektimin e punës në sektorët më të rrezikuar (p.sh bujqësi, hotele dhe argëtim, ndërtim, fabrika të vogla, peshkim)

b. Zhvilluar sisteme ndërgjegjësimi për të arritur tek ata që janë të përfshirë në veprimtari me rrezikshmëri të lartë si lypja, të punësuarit si ndihmëse shtëpiake dhe atyre që punojnë në industrinë e seksit

c. Zbatuar procedura kontrolli mes migrantëve të parregullt, azilkërkuesve dhe të deportuarve

d. Krijuar metoda të reja për të lehtësuar vetë-identifikimin e rasteve

Shërbime mbështetjeje për personat e trafikuar

Rekomandim 5: Të ofrohen më shumë shërbime për të gjitha rastet, jo vetëm për ato që kanë qenë objekt i shfrytëzimit seksual.

Rekomandim 6: Të ofrohen më shumë alternativa me bazë komunitare/jo strehëzat për ata persona që nuk duan, ose nuk përfitojnë nga akomodimi në strehëza.

Rekomandim 7: Të zhvillohen dhe të realizohen shërbime mbështetjeje të dedikuara për viktimat fëmijë të trafikimit, sipas nevojave të tyre specifike. Kjo përfshin krijimin e programeve të specializuara për integrimin e fëmijëve, ofrimin e mbështetjes së duhur për familjet birësuese sipas rastit dhe përmirësimin e kapaciteteve të punonjësve në institucionet e kujdesit për fëmijët.

Rekomandim 8: Të përmirësohet cilësia e shërbimeve (1) duke zhvilluar standardet dhe duke certifikuar organizatat që ofrojnë mbështetje për viktimat, përfshirë strehëzat, (2) duke monitoruar standardet e reja dhe ekzistuese dhe (3) duke mbledhur dhe përdorur mekanizmat e reagimit të viktimave bazuar në standardet ndërkombëtare.

Rekomandim 9: Të ofrohet mbështetje afatgjatë, e qëndrueshme riintegrimi për të gjitha rastet, përfshirë qasje/akses në sistemet kombëtare dhe vendore të mbrojtjes dhe mbështjes sociale.

Bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Rekomandim 10: Të përmirësohet bashkëpunimi dhe koordinimi mes aktorëve kombëtarë në përgjigje të trafikimit të personave.

Rekomandim 11: Të përmirësohet bashkëpunimi ndërkombëtar nëpërmjet zbatimit të përmirësuar dhe institucionalizimit të MKR-së rajonale; të forcohet bashkëpunimi ndërkufitar dhe hetimet e përbashkëta.

Procese të drejtësisë penale

Rekomandim 12: Të rriten kapacitetet e aktorëve të drejtësisë penale për të mbrojtur personat që kanë qenë objekt trafikimi dhe për të ndjekur penalisht trafikantët në gjithë plotësinë e ligjit.

Rekomandim 13: Të përmirësohet mbështetja gjatë procesit të drejtësisë penale, duke u dhënë viktimave periudhë të plotë reflektimi, mbështetje gjatë proceseve ligjore dhe ndihmë për të kërkuar kompensim/dëmshpërblim.

Angazhimi i qeverisë dhe alokimi i burimeve

Rekomandimi 14: Të rritet financimi për programe kundër TP, sidomos për OJQ-të dhe institucionet që mbështesin personat e trafikuar.

Qëndrime që pengojnë reagimin ndaj trafikimit të personave

Rekomandim 15: Të përfshihen/ndërmerren veprimtari për të përmirësuar qëndrimet që pengojnë reagimin e duhur ndaj trafikimit, me anën e trajnimeve të specializuara për të gjithë aktorët e përfshirë në identifikimin, ndjekjen, ndihmën dhe mbrojtjen e personave që kanë qenë objekt shfrytëzimi, si edhe me anën e fushatave të ndërgjegjësimit dhe seminareve për përmirësimin e aftësive.

Vlerësimi i nevojave:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor

1. HYRJE DHE SFONDI

Në shtator 2013, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ndërmori një vlerësim gjashtë mujor për situatën e trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë [BH] Kosovën e administruar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së[4] [Kosovë], ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbi)[5].

Qëllimi i vlerësimit të nevojave ishte mbledhja dhe përmbledhja e këndvështrimeve të aktorëve të ndryshëm për situatën aktuale të mekanizmave dhe burimeve në dispozicion të luftës kundër trafikimit të personave (TP) në rajon. Vlerësimi synonte identifikimin e opinioneve të aktorëve për boshllëqet kyçe në lidhje me identifikimin dhe referimin e personave të trafikuar, si edhe ndihmën dhe mbështetjen për ta. Aktorëve gjithashtu u janë kërkuar rekomandime për mënyrën se si mund të përmirësohen jo vetëm përgjigjet/reagimet ekzistuese ndaj problemit në fjalë, por edhe proceset e papërshtatshme dhe për plotësimin e boshllëqeve thelbësore në burimet rajonale të anti-trafikimit.[6]

Fokusi parësor si tek identifikimi i menjëhershëm dhe i saktë i çështjeve të trafikimit, ashtu edhe tek trajtimi i duhur i tyre tregon se sa thelbësore janë këto hapa për reagimin e efektshëm ndaj TP. Pa identifikimin e duhur të rasteve nuk është e mundur as që të identifikohen, kapen dhe ndiqen penalisht rrjetet e trafikimit, as edhe të nxirren të dhënat e kërkuara për të informuar rreth veprimtarive parandaluese dhe për të përmirësuar politikat. Pa referimin e duhur dhe mbështetjen e duhur për të gjithë personat që kanë qenë objekt trafikimi dhe shfrytëzimi, nuk është e mundur që të jepet një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj trafikimit. Ndaj, vlerësimi i nevojave është fokusuar në këto dy komponentë të përgjigjes/reagimit ndaj trafikimit në rajon.

4 Kosova e administruar nga Rezoluta e UNSC 1244. Tani e më poshtë, Kosova.

5 Rajoni i Ballkanit Perëndimor tradicionalisht përfshin Kroacinë, por anëtarësimi i fundit në Bashkimin Europian e riorienton pozicionin e saj si vend origjine, tranziti dhe destionacioni për trafikimin e qenieve njerëzore, si edhe burimet në dispozicion për ta trajtuar atë.

6 Siç është e nevojshme për një vlerësim nevojash, gjetjet dhe rekomandimet në këtë raport pasqyrojnë kënd-vështrimet e aktorëve dhe jo një vlerësim objektiv, empirik të panoramës së TP në rajon. Është pozicioni i këndvështrimit të aktorëve si provë empirike e studimit ai që drejtoi (1) metodën e studimit për të analizuar këndvështrimin e aktorëve si bazë të zhvillimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të studimit, dhe (2) zgjedhjen dhe zhvillimin e metodologjisë, përfshirë mënyrën e mbledhjes së të dhënave, instrumentet dhe metodat analitike.

Kjo pjesë e raportit jep një vështrim të shkurtër të situatës aktuale të TP në Ballkanin Perëndimor. Seksioni 2 detajon metodologjinë e përdorur në vlerësim, paraqet kuadrin dhe pyetjet kryesore të kërkimit për vlerësimin dhe nënvizon kufizimet e studimit. Seksioni 3 raporton gjetjet kryesore të vlerësimit. Ne kemi kategorizuar gjetjet sipas pyetjes së kërkimit të vlerësimit përfshirë (1) tendencat në shfaqje; (2) identifikimin dhe referimin; (3) mbështetjen dhe shërbimet; (4) bashkëpunimin mes aktorëve kundër TP; dhe (5) boshllëqet në identifikim, referim dhe programin e mbrojtjes. Çdo temë e studimit jepet me numra dhe e theksuar. Secila ndiqet nga gjetjet që trajtojnë pyetjen, të paraqitur me një simbol renditës dhe në shkronja të pjerrëta për të dalluar statusin e tyre si gjetje. Secili simbol renditës ndiqet nga një diskutim i të dhënave në mbështetje të gjetjes, përfshirë citimet ilustruese të mbledhura gjatë rishikimit, intervistave me anë të telefonit, vizita në terren dhe sondazhit online. Numri i gjetjeve dhe diskutimet mbështetëse ndryshojnë sipas fushës tematike dhe gjetjeve. Ky variacion pasqyron thellësinë dhe detajimin e reagimeve që jepen gjatë mbledhjes së të dhënave dhe të identifikuara në analizë. Seksioni 4 përmbledh rezultatet e takimit rajonal të vlerësimit (maj 2014). Raporti mbyllet me Seksionin 5, që ofron një sërë rekomandimesh nga aktorët të ndjekura nga përfundimet përmbledhëse dhe rekomandimet e konsoliduara bazuar në gjetjet e studimit. Ky raport përfshin gjithashtu gjashtë shtojcat e mëposhtme: Shtojca A: Termat e Referencës, Shtojca B: Mekanizmat Kuadër për Identifikimin e Aktorëve të Vlerësimit të Nevojave, Shtojca C: Lista e Dokumenteve të Rishikimit, Shtojca D: Guida e Intervistës, Shtojca E: Instrumenti i Sondazhit, Shtojca F: Fjalori Analitik i Kodit, Shtojca G: Pjesëmarrësit e Takimit të Aktorëve dhe Shtojca H: Prezantimi në Takimin e Aktorëve.

1.1 Sfondi dhe Konteksti

Ballkani Perëndimor përballet me sfida të vjetra dhe të reja në përgjigje të problemit të TP. Gjatë dy dekadave të shkuara, trazirat socio-ekonomike dhe politike në rajon kanë shkaktuar një rritje të madhe të migracionit të parregullt nga dhe përmes Ballkanit Perëndimor për në Bashkimin Europian (BE). Kjo rritje dhe ky fluks i qenieve njerëzore kanë bërë që trafikimi i personave të bëhet një fenomen më i dukshëm brenda dhe përmes rajonit.

Edhe pse aktualisht po kalon një periudhë stabiliteti politik relativ, TP mbetet një sfidë e vazhdueshme dhe komplekse në rajon. I tillë është sidomos rasti me grupet e margjinalizuara të shoqërisë, përfshirë komunitetin rom dhe fëmijët e rrugës, si edhe të papunët dhe të rinjtë. Këto grupe shpesh përballen me betejën e jetesës me mundësi shumë të kufizuara për punë të ligjshme dhe mjete për të mbajtur veten dhe familjet në vendet e tyre të origjinës. Përballë papunësisë dhe me pak mundësi alternative, ata mund të vendosin që të pranojnë oferta të paskrupullta për punë të zezë në rajone që janë veçanërisht më afër gjeografikisht dhe historikisht me Ballkanin Perëndimor- BE, Kaukaz, Azi qendrore dhe Rusi. Larg nga mekanizmat mbrojtëse të rregullatorëve të qeverisë, sindikatave të punës dhe mbrojtjes ligjore për punëtorët, punëtorët e parregullt, sidomos

migrantët, përballen me rrezikun e madh të trafikimit. Si zgjerimi i BE-së me Rumaninë dhe Bullgarinë, ashtu edhe shtrëngimi i kufijve përmes Europës jugore e kanë ndërlikuar më tej situatën rajonale të TP-së. Ato kanë riorientuar dhe intensifikuar fluksin e migracionit të parregullt nga Azia Jugore, Afrika Veriore dhe Lindja e Mesme nëpërmjet Ballkanit Perëndimor dhe për në BE. Flukset e reja migratore mund të ndikohen veçanërisht nga trafikimi, sepse individët dhe komunitetet kërkojnë kohë që të gjejnë mënyra të reja për të identifikuar, zbutur dhe tejkaluar rreziqet që lidhen me migracionin.

Edhe pse shumë statistika zyrtare sugjerojnë rënie të shifrave të trafikimit në vitet e fundit, një shumësi aktorësh vazhdon të shprehë shqetësim për situatën e TP në Ballkanin Perëndimor. Ata që punojnë në mënyrë aktive në këtë fushë, janë të mendimit se statistikat zyrtare nuk pasqyrojnë shkallën e problemit, për shkak se mekanizmat e identifikimit nuk përputhen me tendencat kryesore të trafikimit, si edhe për shkak të mungesës së plotë të mekanizmave të duhura për të identifikuar personat e trafikuar dhe për t'i referuar ata në shërbimet kryesore. Kjo më pas pengon publikun dhe qeverinë që të kuptojnë shkallën dhe kompleksitetin e problemit. Pa kuptuar mirë çështjen, qeveritë nuk mund (1) t'i japin përparësinë e duhur luftës kundër trafikimit; (2) të njohin plotësisht modalitetet e ndryshueshme të trafikimit dhe rrjeteve specifike të trafikimit; apo (3) të punojnë me organizatat ndërqeveritare (OJQ) dhe rrjetet e kërkimit shkencor për të zhvilluar një bazë të qëndrueshme mbi të cilën të forcohen kapacitet kundër trafikimit, shërbimet e mbrojtjes dhe të ndihmës, si edhe veprimtaritë e parandalimit të trafikimit. Shkurtimisht, mangësitë në identifikim mund të çojnë në një nënvlerësim të problemit, i cili mund të pengojë përpjekjet për të krijuar përgjigje/reagime të efektshme, rajonale ndaj TP.

Përveç mangësive të lartpërmendura, apo atyre të mundshme në reagimin aktual ndaj TP, Ballkani Perëndimor përballet me kërkesën për të harmonizuar kuadrin e vet legjislativ me atë të BE-së. Më shumë ndihmë duhet dhënë, edhe pse, në fakt, aktorët në rajon e kanë filluar këtë proces tashmë. Kundrejt këtij sfondi sfidash dhe përgjegjësish të reja, dhe nevojës për të siguruar alokimin e burimeve të kufizuara në fushat me ndikimin më të madh të mundshëm, IOM vendosi që të bëjë një vlerësim të burimeve ekzistuese, boshllëqeve kryesore dhe nevojave të prioritizuara për t'iu përgjigjur siç duhet TP-së në rajon.

Për të drejtuar studimin, IOM rekrutoi një ekip të vogël kërkimor, i cili hartoi kuadrin e vlerësimit të nevojave, duke përfshirë mbledhjes e të dhënave dhe analizimin e tyre (Tabela 1). Struktura e kuadrit përfshin një sërë pyetjesh kërkimore bazuar në qëllimin e studimit, sipas përcaktimit që u bë në Termat e Referencës (Shtojca A). Ekipi kërkimor përdori pyetjet e studimit për të organizuar kuadrin e vlerësimit të nevojave dhe për të hartuar/zhvilluar pyetjet ose masat e mbledhjes së të dhënave. Ekipi i mblodhi masat në instrumente të përshtatshme të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave përfshirë strukturën e kodimit analitik për të drejtuar rishikimin (dhe më vonë për të analizuar të dhëna të tjera cilësore), sondazhin e kryer në internet me aktorët, protokollin e intervistimit për të orientuar intervistat në terren, dhe prezantimin power point për të orientuar aktorët gjatë seminarit.

Tabela 1: Kuadri i IOM-it për Vlerësimin e Nevojave kundër Trafikimit në Ballkanin Perëndimor

Pyetja e studimit	Nën-pyetjet	
1. Cilat trende, forca, faktorë apo modalitete të reja të TP po shfaqen në rajonin e Ballkanit Perëndimor?	● Cilat janë rrugët ekzistuese të trafikimit? ○ Cilat janë vendet kryesore të burimit, tranzitimit dhe destinacionit? ○ Cilat janë format kryesore të shfrytëzimit? ○ Cilat janë rrugët që po shfaqen ose zhvillohen në dhe përmes këtyre vendeve? ○ Cilat janë metodat e reja që përdoren nga rrjetet e trafikimit?	
	● Cilat modele të reja të shfrytëzimit po shfaqen? ○ Cilat industri kyçe janë përfshirë? ○ Prej nga vijnë trafikantët? ○ Si i identifikojnë dhe përfshijnë viktimat e tyre? ○ Cilët janë viktimat e tyre (mosha, seksi, origjina)?	
2. Cili është kuadri ligjor dhe i politikave për identifikimin dhe referimin e viktimave (të mundshme) të trafikimit të qenieve njerëzore?	● Cilat organizata kanë autoritet për të caktuar zyrtarisht një person si viktimë trafikimi?	
	● Cilat kritere janë përdorur për të identifikuar viktimat? A përdoren listat e kontrollit? Kush ka akses në këto lista kontrolli (punonjësit social, ofruesit e kujdesit shëndetësor, mësuesit në shkolla etj). A ndahen ato me aktorët e mundshëm të përfshirë?	
	● Cilat mënyra ekzistojnë që viktimat të "vetë-identifikohen" (p.sh. linja telefonike direkte)? Sa përqind e viktimave po identifikohet nëpërmjet këtyre mënyrave?	
	● Cilat marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi kombëtare dhe rajonale ekzistojnë në lidhje me identifikimin, referimin dhe mbështetjen?	
	● Sa funksionale janë mekanizmat e identifikimit dhe referimit? Në çfarë mase të dhënat e qeverisë përfaqësojnë shifrat e vlerësuara të viktimave të trafikimit (të identifikuar dhe të pa-identifikuar)	
	● Në çfarë mase profili i viktimave të identifikuara është përfaqësues i të gjitha rasteve të trafikimit në rajon?	
	● Cilat janë pengesat kryesore ndaj identifikimit sistematik dhe ofrimit të ndihmës për VT?	
3. Cilat institucione ofrojnë aktualisht mbrojtje dhe ndihmë për VT në rajon dhe/ose nën-rajon?	● Çfarë mbrojtje dhe shërbime ofrojnë ato?	
	● Cilat janë burimet e tyre të financimit (qeveria, donatorët, privat)?	
	● Cilat mekanizmat ekzistojnë për të ndihmuar personat që nuk janë përcaktuar zyrtarisht si të trafikuar?	
	● A janë burimet dhe mbështetja në dispozicion të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e tyre? A janë burimet në mospërputhje me nevojat e tyre në një farë mënyre?	
	● Cilat sisteme ekzistojnë për të siguruar që ndihma që ofrohet nga këto programe të jetë e duhur (p.sh standarde, mekanizma të reagimit të viktimave, vlerësim i jashtëm i programit)?	

	Burimet e të dhënave				
	Intervista me stafin e IOM	**Intervista me aktorët e përfshirë**	**Sondazh me aktorët e përfshirë**	**Rishikim dokumenti**	**Seminar me aktorët e përfshirë**
	X	X	X	X	
	X	X	X	X	
	X	X		X	
	X	X		X	
	X	X		X	
	X	X	X	X	
	X	X	X	X	
	X	X	X	X	
	X	X	X	X	
	X	X	X	X	
	X	X	X	X	
	X	X	X	X	

Pyetja e studimit	Nën-pyetjet	
4. Cilat lloj partneritete, rrjete dhe bashkëpunime mes aktorëve kundër trafikimit ekzistojnë në rajon dhe/ose nën-rajon?	● Sa operacionale janë këto partneritete? A janë institucionalizuar këto partneritete (p.sh MoU, protokoll, etj)? A është një institucion përgjegjës për të mbajtur dhe promovuar partneritetin?	
	● A është puna e tyre e qëndrueshme?	
5. Cilat janë boshllëqet në mekanizmin e identifikimit, referimit, programet e mbrojtjes dhe ndihmës?	● Në çfarë niveli ekzistojnë këto boshllëqe – lokal, kombëtar dhe/ose rajonal?	
	● Në çfarë mase këto shërbimet që u ofrohen viktimave preken nga/varen nga kombësia, mjetet me anë të të cilave janë identifikuar dhe/ose organizata që i identifikon ato?	
	● Cilat dallime ekzistojnë ndërmjet shërbimeve ofruar viktimave të trafikimit për qëllim shfrytëzimi seksual, viktimave të trafikimit për qëllim të shfrytëzimit për punë dhe viktimave të trafikimit për qëllime të tjera? Cilat dallime ekzistojnë ndërmjet viktimave të trafikimit të brendshëm dhe të jashtëm?	
	● Cilat dallime ekzistojnë ndërmjet shërbimeve ofruar viktimave të trafikimit të fëmijëve dhe të rriturve, viktimave të trafikimit?	
6. Cilat janë prioritetet e aktorëve sa i përket krijimit, shtrirjes ose përmirësimit të mekanizmave ekzistuese të identifikimit, referimit dhe mbështetjes?	● Përshkruani ndonjë proces rajonal, kombëtar, lokal të planifikuar ose të vazhdueshëm që përdoret për të vendosur prioritetet kundër trafikimit për rajonin (ose nën-rajonin) ○ Cilët janë aktorët kryesorë në këtë proces (qeveri/OJQ lokale/ndërkombëtare, organizata shumëpalëshe, sektor privat)? ● Cilat janë prioritetet për krijimin, shtrirjen ose përmirësimin e mekanizmave të identifikimit në nivel lokal dhe rajonal? ● Cilat janë prioritetet për krijimin, shtrirjen ose përmirësimin e referimit dhe mbështetjen ekzistuese në nivel lokal dhe rajonal?	
7. Çfarë rekomandojnë aktorët si (i) hapi i radhës më i afërt që duhet të merret, (ii) qëllimet e përkohshme, dhe (iii) qëllimet afatgjata për të krijuar, shtrirë ose përmirësuar mekanizmat dhe burimet ekzistuese për të luftuar TP dhe për të ndihmuar viktimat e tij në Ballkanin Perëndimor?		

	Burimet e të dhënave				
	Intervista me stafin e IOM	**Intervista me aktorët e përfshirë**	**Sondazh me aktorët e përfshirë**	**Rishikim dokumenti**	**Seminar me aktorët e përfshirë**
	X	X		X	
	X	X		X	
	X	X	X	X	X
	X	X	X	X	X
	X	X	X	X	
	X	X	X	X	
	X	X	X	X	X
	X	X	X	X	X

Vlerësimi i nevojave:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor

2. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NEVOJAVE

Në këtë seksion, ne përshkruajmë metodologjinë e përdorur në këtë vlerësim, paraqesim kuadrin dhe pyetjet kryesore të studimit dhe nënvizojmë kufizimet e studimit. Vlerësimi i nevojave përfshin gjashtë hapat kryesore: (1) rishikimin që përbëhet nga mbledhja, kodimi dhe analizimi i dokumenteve të identifikuara dhe të kërkuara nga IOM dhe të plotësuara nga ekipi kërkimor; (2) zhvillimin e dy mekanizmave për identifikimin e aktorëve dhe rolet e tyre për t'u përfshirë në vlerësimin e nevojave; (3) intervista me 37 aktorë të identifikuar, personalisht dhe nëpërmjet telefonatave; (4) sondazh online i stafit rajonal, nën-rajonal dhe jashtë-rajonal të IOM dhe aktorëve të tjerë (që jep 99 nga 135 plotësime për një-shkallë reagimi prej 73 përqind); (5) analizimin dhe-trekëndëzimin e të gjitha burimeve të të dhënave duke përdorur një skemë kodimi të strukturuar për të zhvilluar gjetjet dhe rekomandimet fillestare; dhe (6) përfaqësim dhe korrigjim/vlerësim i gjetjeve të studimit dhe rekomandimeve në takimin e aktorëve.

Rishikimi i dokumenteve

Rishikimi përfshiu dokumente kyçe institucionale dhe kërkimin për TP në Ballkanin Perëndimor në nivel rajonal dhe nën-rajonal. Stafi i IOM-it në rajon identifikoi një sërë dokumentesh dhe raportesh rajonale për t'u konsideruar në rishikim. Gjithsej u identifikuan 59 dokumente. Nga këto, ekipi rishikoi, plotësoi dhe në përfundim përfshiu në këtë rishikim 43 dokumente kyçe (Shtojca C: Lista e Dokumenteve të Rishikuara). Ekipi më pas zhvilloi një skemë kodimi analitik bazuar në pyetjet kërkimore të studimit dhe i kodoi dokumentet me Dedoose[7], program për analizimin e përmbajtjes cilësore (Shtojca E: Fjalori i Kodeve Analitike). Siç diskutohet më poshtë, ekipi tabeloi të dhënat e rishikimit me burime të tjera të të dhënave për të identifikuar, eksploruar, shtjelluar dhe vlerësuar gjetjet si edhe për të dhënë rekomandimet.

Identifikimi i aktorëve

Një komponent kyç i vlerësimit të nevojave është përfshirja e aktorëve. Aktorët janë ata individë ose organizata që kanë një lloj investimi, përvoje ose njohurie për një problem, çështje ose institucion (marrë nga CDC 2012). Shembuj të aktorëve

7 Dedoose – aplikacion në internet për të analizuar metodat cilësore dhe të përziera kërkimore. http://www.dedoose.com/?gclid=CKb4u43f_bOCFabLtAodp0YASQ

të interesuar përfshijnë stafin e programit që punon direkt për një çështje ose me një popullsi specifike, staf administrativ dhe mbikëqyrës, staf nga institucione partnere që punojnë me të njëjtat grupe ose pjesëmarrës ose çështje, donatorë dhe mbështetës financiarë të programeve dhe institucioneve, studiues dhe vlerësues, ekspertë të pavarur, me njohuri specifike të një problemi ose çështjeje. Aktorët e interesuar në çdo program, nismë ose çështje do të varen nga ai/ajo që punon direkt në ose me programin ose çështjen dhe që pozicionohen më mirë për të patur ndikim. Ashtu si ata që përfshihen për trajtimin e një programi ose problemi, ata janë gjithashtu persona ose institucione që janë në pozicionin më të mirë për të përdorur rezultatet e vlerësimit të çështjes ose problemit në mënyrë domethënëse. Identifikimi i aktorëve të duhur për t'u përfshirë dhe angazhuar në proces është thelbësor për të kryer çdo lloj vlerësimi të rëndësishëm.

Qëllimi i përfshirjes të aktorëve të interesuar në një vlerësim është rritja e rëndësisë së rezultateve ose gjetjeve dhe forcimi i pronësisë ndaj tyre. Për shkak të pozicionit të tyre të privilegjuar si ekspertë dhe atyre që punojnë direkt me një çështje në një farë mënyrë, kontributi i aktorëve të interesuar në hartimin, qëndrimin ose përmbajtjen e një vlerësimi mund të ndihmojë në rritjen e specifikës dhe përshtatshmërisë së gjetjeve. Gjithashtu ka më shumë mundësi që të ndihmojë për të siguruar që gjetjet të mund të zbatohen në jetën reale dhe të vihen shpejt në punë për të përmirësuar programet ose për të zgjidhur problemet në mënyrë më të efektshme. Madje, mund të ndihmojë gjithashtu që këto gjetje të pasqyrojnë nevojat dhe vlerat e vetë aktorëve të interesuar. Kur aktorët përfshihen në një vlerësim, ka më shumë mundësi që gjetjet të konsiderohen si rezultat i punës së tyre. Gjithashtu ka më shumë mundësi që ata t'i shohin ato në harmoni me këndvështrimet e tyre për një çështje ose problem. Në përfundim, përfshirja e aktorëve të interesuar ndihmon në nxjerrjen e gjetjeve që janë "më të dobishme, më të rëndësishme dhe të besueshme" (Preskill dhe Jones, 2009).

Ekipi kërkimor zhvilloi dy Mekanizma Kuadër për Identifikimin e Aktorëve në Vlerësimin e Nevojave (Shtojca B) për të mbështetur IOM-in në identifikimin dhe përfshirjen e aktorëve në vlerësimin e nevojave. Mekanizmi i parë synon të ndihmojë IOM që të identifikojë një grup të rëndësishëm dhe të qëndrueshëm aktorësh për t'u përfshirë në vlerësimin e nevojave. Mekanizmi i dytë synon që të ndihmojë IOM që të përcaktojë rolet e duhura të aktorëve në vlerësimin e nevojave.

Intervistimi i detajuar i aktorëve

Këndvështrimet dhe mendimet e aktorëve, përfshirë donatorëve që punojnë për të luftuar trafikimin në Ballkanin Perëndimor përbëjnë komponentin thelbësor të vlerësimit të nevojave. Për të krijuar një ide të detajuar dhe të larmishme për situatën dhe nevojat aktuale, ekipi i kërkimit zhvilloi intervista me telefon dhe personalisht me një sërë aktorësh kyç. Lista e informatorëve dhe të intervistuarve u përgatit nga stafi i IOM dhe mbuloi gjithë rajonin.[8] Siç detajohet në Tabelën 2, ekipi ka zhvilluar gjithsej 37 intervista.

8 Ky raport i referohet pjesëmarrësve të intervistuar si "informatorë" dhe pjesëmarrësve të sondazhit si "të intervistuar"

Me anë të pyetjeve të studimit, ekipi kërkimor zhvilloi një sërë pyetjesh për t'u përdorur si bazë për drejtimin e një interviste gjysmë të strukturuar, sipas kuadrit të vlerësimit të nevojave (Tabela 2). Guida më pas u përshtat me rolet e ndryshme të informatorëve dhe marrëdhëniet e tyre për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore (p.sh donatorë, zyrtarë, ofrues shërbimi, etj), duke ruajtur konsistencën në variante për të bërë të mundur krahasimin e të dhënave.

Tabela 2: Numri Intervistave sipas nën-rajonit

Roli		Numri i Intervistave sipas Zonës					
		Shqipëri	Bosnjë Hercegovinë	Kosovë	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Mal i Zi	Serbi
Zbatim i ligjit	Zyrtar në fushën e drejtësisë penale/ zbatimit të ligjit	2	1	1	1	1	1
	Punonjës policie		1	1	1	1	
	Roje kufitare				1		
Zyrtar	Zyrtar në fushën e mbështetjes së vikti-mave të trafikimit	1			1		1
	Zyrtar në fushën e mbrojtjes sociale dhe/ose kujdesit shëndetësor (jo domosdoshmërisht trafikim)		1				
	Zyrtar- tjetër	1					
OJQ	Punonjës i OJQ nga agjencia mbështetëse e viktimave	1	2	1	1	1	1
	Punonjës i OJQ- tjetër				2		
Gjyqtar/ prokuror		1		1			
IGO/staf zhvillimi	Staf i organizatës së OKB-së ose tjetër shumëkombëshe (IGO)*	1	1	2			
	Staf i agjencisë ndërkombëtare të zhvillimit (IDA)	1		2			1
Tjetër	Konsulent/ekspert i pavarur kundër trafikimit						
	Tjetër	1			1		
Gjithsej		9	6	7	8	3	4
							37

*Staf i IOM-it nuk është intervistuar në këtë vlerësim të nevojave.

Sondazhi online

Për të krijuar ide për këndvështrimet e një game më të gjerë aktorësh sesa ata të përfshirë në intervista, studimi përfshiu një sondazh në internet për 135 të intervistuar të mundshëm, të gjithë të identifikuar nga IOM. Sondazhi përmbante pesë fusha tematike, me 55 nën-pyetje të mbyllura, me përgjigje me përzgjedhje ose me shkallën Likert-like, si edhe katër pyetje të hapura. Ky format mundëson që aktorët të japin mendimet e tyre, si edhe të bëjnë komente për çështje të vlerësimit të nevojave në një format konfidencial (Shtojca E: Instrumenti i Sondazhit). Sondazhi u paraqit online dhe në anglisht, ndërsa stafi i IOM përktheu pyetjet me qëllim që aktorët të ndihmoheshin për të kuptuar përmbajtjen. Ekipi kërkimor punoi nga afër me IOM për të ndjekur aktorët që nuk ishin përgjigjur fillimisht. Me anë të kësaj metode, ne mund të merrnim normën e përgjigjes prej 73.3 përqind (N=99).

Tabela 3: Të intervistuarit e sondazhit sipas Rolit dhe Zonës, në përqindje

ROLI	Shqipëri	BH	Kosovë	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Mal i Zi	Serbi	Rajonal	Botëror
Zbatimi i ligjit	2.0	2.0	2.0	6.1	0.0	2.0	1.0	0.0
Zyrtarë	10.2	2.0	0.0	4.1	1.0	3.1	0.0	0.0
OJQ	6.1	3.1	0.0	10.2	1.0	2.0	1.0	1.0
Gjyqtar/Prokuror	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.0	0.0
IOM	2.0	1.0	0.0	2.0	1.0	1.0	0.0	0.0
IGO/IDA	3.1	2.0	2.0	9.2	0.0	1.0	1.0	0.0
Tjetër	4.1	4.1	0.0	4.1	1.0	0.0	0.0	0.0

Burimi: Sondazh i aktorëve (Vlerësim i IOM për Nevojat në BP 2014)
Shënime: Të dhënat e munguara janë hequr nga llogaritja e përqindjes.

Analizimi i të dhënave

Ekipi kërkimor analizoi të dhënat cilësore të studimit (dokumente dhe intervista) së pari duke zhvilluar kode specifike bazuar në pyetjet e studimit (Shtojca F: Fjalori Analitik i Kodeve) dhe duke koduar të dhënat cilësore (dokumente dhe intervista). Për sondazhin, ekipi analizoi të dhënat duke nxjerrë statistika përshkruese për të vlerësuar gamën më të gjerë të kontributit dhe këndvështrimeve mbi nevojat

aktuale kundër-trafikimit në rajon. Ekipi kërkimor më pas trekëndëzoi tre llojet e të dhënave (1) për të përcaktuar shpeshtinë dhe natyrën e temave dhe modeleve në shfaqje, (2) për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre në lidhje me njëra-tjetrën, (3) për të identifikuar kontradiktat midis dhe ndërmjet llojeve të të dhënave.

Ky proces mundësoi që ekipi (1) të identifikojë modelet kryesore, gjetjet dhe temat tek të dhënat (2) të zhvillojë një sërë gjetjesh konkrete që synojnë në trajtimin e çdo pyetjeje të studimit dhe (3) të grupojë gjetjet për të zhvilluar një sërë rekomandimesh për mënyrën më të mirë të trajtimit të nevojave rajonale.

Takimi rajonal i vlerësimit

Një hap drejt përfundimit të këtij vlerësimi të shkurtër të nevojave ishte mbledhja e aktorëve kyç për të diskutuar dhe shtjelluar gjetjet paraprake të studimit dhe rekomandimet. IOM identifikoi një grup aktorësh nga mbarë rajoni si edhe përfaqësues të donatorëve jashtë-rajonalë dhe organizatave ndërkombëtare dhe i ftoi në një takim rajonal vlerësimi (maj 2014) (shihni Shtojcën G për shifrat, organizatat dhe vendet pjesëmarrëse në takim). Takimi i punës përfshiu tre veprimtaritë e mëposhtme kryesore: (1) prezantimi i gjetjeve dhe rekomandimeve paraprake të studimit (Shtojca H), (2) prioritizimi në grupe të vogla sipas vendeve i rekomandimeve të studimit dhe (3) shtjellimi dhe prioritizimi i rekomandimeve të studimit në nivel rajonal. Qëllimi ishte përgatitja e një tërësie përfundimtare rekomandimesh që pasqyron përparësitë e aktorëve për hapat e ardhshëm drejt zhvillimit të reagimit më koherent dhe të efektshëm ndaj TP në rajon (Tabelat 4.1 dhe 4.2 paraqesin rezultatet e këtyre veprimtarive të takimit të punës).

2.1 Kufizimet ndaj Vlerësimit të Nevojave

Metodologjia e vlerësimit të nevojave ka disa kufizime të rëndësishme, e para nga të treja është identifikuar që në fillim të vlerësimit. Këto kufizime janë si më poshtë:

1. Përdorimi i këndvështrimeve dhe reagimeve të aktorëve si burim parësor i të dhënave, do të thotë që të dhënat e studimit të bazohen në njohuritë subjektive të aktorëve për situatën e TP, në këndvështrimet personale për mangësitë në burime dhe në reagime dhe përshtypje individuale për atë që duhet të bëhet për të trajtuar këto boshllëqe në kohën e vlerësimit të nevojave. Edhe pse mënyra si është hartuar studimi kërkon ta zbusë këtë me anë të një rishikimi në nivel të lartë të studimit të kryer nga pala e tretë në lidhje me temën, studimi nuk duhet të shihet si një skanim dhe analizë objektive e situatës së TP në rajon.
2. Përzgjedhja jo e rastësishme e kampionëve për sondazhin dhe intervistat pengon përgjithësimin e gjetjeve për popullata të mëdha prej të cilave

janë marrë kampionët. Ekipi nuk mund të prezumojë që këndvështrimet e donatorëve, partnerëve, OJQ-ve dhe organizatava ndërqeveritare dhe stafi tjetër të identifikuar nga IOM të përfshirë në studim përfaqësojnë këndvështrimin e të gjithë stafit në çdo institucion, nën-rajon ose në mbarë rajonin.

3. Të gjitha gjetjet dhe rekomandimet bazohen në mendimet individuale të aktorëve të vlerësimit të nevojave. Edhe pse ekipi kërkimor ka bërë trekëndëzim midis dhe ndërmjet informatorëve dhe të intervistuarve të ndryshëm duke përdorur shumë metoda, të dhënat e studimit përfaqësojnë tërësisht këndvështrimin subjektiv të këtyre aktorëve. Niveli i njohjes me çështjet aktuale të TP varionte ndjeshëm mes aktorëve të intervistuar. Kjo për shkak të mospërfshirjes ose përfshirjes së pjesshme në segmentin e ngushtë të sektorit më të gjerë. Më tej, meqë IOM identifikoi të gjithë aktorët që do të përfshiheshin në vlerësimin e nevojave, këta aktorë pasqyrojnë këndvështrimin dhe normat e IOM në lidhje me temën e kundër trafikimit, dhe jo një tërësi këndvështrimesh të ndryshme dhe të plota në këtë fushë.

4. Disponueshmëria e të dhënave për rishikim në mbarë rajonin dhe nën-rajonin nuk ka qenë e njëjtë, siç ka qenë ajo e informatorëve për intervista të detajuara. Për shembull në Malin e Zi pati vetëm një raport për këtë çështje ndërsa ekipi mundi që të intervistonte dy zyrtarë dhe një përfaqësues OJQ-je. Ndryshe nga kjo, në Shqipëri u rishikuan shtatë dokumente/raporte kombëtare përveç pesë raporteve rajonale që mbulonin Shqipërinë dhe u intervistuan nëntë persona (pesë zyrtarë, dy përfaqësues OJQ-je, një përfaqësues i organizatës ndërqeveritare dhe dy nëpunës të ambasadës së SHBA-ve).

5. Gjithashtu, edhe pse ekipi fillimisht planifikoi që të dallonte rekomandimet e aktorëve përsa i përket hapit tjetër më të afërt për t'u marrë, qëllimeve të përkohshme dhe afatgjata për t'u caktuar, më shumë se 90 përqind e aktorëve të intervistuar zgjodhën që të mos bëhej ky dallim. Për rrjedhojë, rekomandimet nuk ndahen në këtë mënyrë.

6. Takimi i aktorëve për vlerësimin nuk siguron që të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e studimit do të pranohen dhe mbështeten. Gjetjet dhe rekomandimet që u janë dhënë aktorëve në një takim pune janë bazuar në kërkimin e pavarur dhe vlerësimin e këndvështrimeve dhe burimeve të shumëfishta. Kështu nuk garantohet që ato pasqyrojnë këndvështrimet e një aktori dhe kështu nuk garantohet se do të vlerësohen dhe mbështeten nga ky aktor.

Një tjetër sfidë për çdo studim ku morën pjesë vullneratisht informatorët dhe të intervistuarit, është anësia e/paragjykimi i vetë-përzgjedhjes. Është e mundur që personat që vendosin të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave të jenë të

ndryshëm në mënyra të rëndësishme nga ata që nuk marrin pjesë. Për shembull, ata që morën pjesë mund të kenë pasur ndjenja më të forta pozitive ose negative për IOM-in sesa ata që nuk morën pjesë. Në përfundim, çdo studim që përmban të dhëna të vetë-raportuara ka sfidën e mundshme të një anësie të dëshirueshme sociale- tendenca e pjesëmarrësve që të përgjigjen në mënyrë të tillë që sipas tyre do të kënaqte të tjerët.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, metoda e përzierë e bazuar në të dhëna cilësore dhe sasiore dhe gjetjet e trekëndëzuara rezultoi në gjetje të shumëfishta, të qëndrueshme në lidhje me burimet, boshllëqet dhe nevojat për të luftuar trafikimin në rajon.

Vlerësimi i nevojave:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor

3. REZULTATET DHE GJETJET E VLERËSIMIT TË NEVOJAVE

Në këtë seksion, përshkruajmë gjetjet kryesore të vlerësimit të nevojave të IOM-it në lidhje me reagimin ndaj TP në Ballkanin Perëndimor. Gjetjet diskutojnë - dhe organizohen sipas- titujve të mëposhtëm: (1) tendencat në shfaqje; (2) identifikimi dhe referimi; (3) mbështetja dhe shërbimet; (4) bashkëpunimi mes aktorëve kundër TP; dhe (5) boshllëqet në identifikim, referim dhe programet e mbrojtjes. Këto tituj janë në përputhje me pyetjet kryesore të studimit të vlerësimit 1-5 (Tabela 1). Rekomandimet vijojnë nga prioritetet e aktorëve të përfshirë, siç diskutohet tek gjetjet dhe siç raportohet në Seksionin 5.

Gjetjet nuk mbulojnë çdo pyetje të bërë apo temë të ngritur gjatë mbledhjes së të dhënave. Përkundrazi, ato fokusohen në çështje (1) më shpesh të cituara nga informatorët dhe të intervistuarit dhe në dokumentet e rishikuara, (2) të cilave informatorët, të intervistuarit dhe dokumentet i kushtojnë më shumë kohë dhe hapësirë diskutimi dhe (3) që janë identifikuar më shpesh si të rëndësishme mes të intervistuarve dhe dokumenteve rajonale/nën-rajonale. Kur informatorët, të intervistuarit dhe dokumentet kanë pasur këndvështrime të ndryshme për thelbin apo karakteristikat e një çështjeje, ne përshkruajmë çdo këndvështrim të ndryshëm të ofruar.[9] Siç tregohet, gjetjet e studimit përcaktohen më një simbol renditës dhe theksohen, me blu, për të treguar statusin e tyre si gjetje. Seksioni mbyllet me një tabelë që përmbledh të gjitha gjetjet e studimit sipas temës së kërkimit dhe burimit të të dhënave. Numri i gjetjeve dhe shtrirja e diskutimit mbështetës ndryshon sipas fushës tematike dhe gjetjeve. Ky variacion pasqyron thellësinë dhe detajimin e reagimeve të treguara gjatë mbledhjes së të dhënave dhe të identifikuara në analizë.

3.1 Tendencat që po shfaqen në TP

Ky seksion përshkruan panoramën aktuale të trafikimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Fillon me një vështrim të përgjithshëm të situatës aktuale përfshirë

9 Në gjithë këtë diskutim, ne nuk përcaktojmë të dhënat cilësore ose nuk japim gjithmonë numrin e të intervistuarve që kanë dhënë një përgjigje të caktuar. Me të dhënat cilësore të mbledhura duke përdorur kategori reagimi jo standarde dhe që nuk janë përfaqësuese ose universale, ne ndonjëherë japim numrin e të intervistuarve, por më shpesh përdorim termat si, disa, pak, shumë, shumica, dhe madje të gjithë për të treguar shpeshtinë relative të përgjigjes. Ne i përdorim këto terma në mënyrë të vazhdueshme, sipas numrit të herëve që ngrihet një çështje nga çdo i intervistuar dhe midis të intervistuarve. Shtojcat metodologjike më tej shpjegojnë burimin e të dhënave dhe kontekstin për këtë lloj përmbledhjeje përshkruese të gjetjeve të të dhënave.

burimin kryesor, zonën e trazitit dhe destinacionit dhe reagimin e aktorëve ndaj karakteristikave të viktimave dhe trafikantëve. Më tej diskuton në mënyrë të detajuar modelet dhe tendencat në shfaqje të TP të raportuara gjatë vlerësimit. Këto janë migracioni i parregullt në rritje, trafikimi i brendshëm, trafikimi për shfrytëzimin për punë, lypja e fëmijëve dhe martesa me detyrim.

Edhe pse përshkruhen si tendenca në shfaqje nuk është e qartë nga të dhënat, masa deri në të cilën këto tendenca pasqyrojnë modelet e reja të trafikimit ose pranimin në rritje të modeleve ekzistuese. Për shembull, ndërsa trafikimi për lypje të organizuar nga fëmijët është identifikuar si një fenomen i ri në raport dhe në disa intervista, disa informatorë dhe të intervistuar raportojnë që lypja nga fëmijët nuk është gjë e re në rajon, por që vetëm së fundmi po kuptohet si një formë e mundshme e trafikimit.

Trafikimi i personave në Ballkanin Perëndimor përfshin shumësi modelesh, shumësi formash shfrytëzimi dhe shumësi formash shtrëngimi/ vulnerabiliteti.

Ashtu siç është globalisht e vërtetë, nuk ka vlerësime të pranuara gjerësisht për shifrat t personave që trafikohen nga, për në dhe përmes Ballkanit Perëndimor. Madje, të dhënat kombëtare në lidhje me rastet e identifikuara janë të kufizuara.[10]Më tej dhe për arsyet e diskutuara më poshtë, rastet e *identifikuara* mund të konsiderohen përfaqësuese të *të gjitha* rasteve të TP. Bazuar në të dhënat në dispozicion dhe intervistat e informatorëve, gratë përbëjnë shumicën e rasteve të identifikuara dhe të ndihmuara në mbarë rajonin; shumica janë trafikuar për shfrytëzim seksual. Megjithatë, informatorët theksojnë fuqishëm që ka më shumë raste trafikimi sesa ato që janë zbuluar me anë të rrugëve zyrtare dhe që shumë nga këto raste lidhen me forma të tjera të trafikimit, përfshirë punën e detyruar, punën shtëpiake dhe lypjen.

Të dhënat sugjerojnë që ka patur një ndryshim në modelet e TP nga mesi i vitit 2000 sa i përket rrugëve, destinacioneve dhe formave. Deri në 2004, shumica e rasteve të identifikuara në BH, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovë dhe Serbi, për shembull, kishin të bënin me shtetas të huaj. Konfliktet në rajon, anëtarësimi i Bullgarisë dhe Rumanisë në BE dhe regjimi i liberalizimit të vizave, rrugët e lëvizjes brenda rajonit janë zhvendosur. Migrantët- përfshirë rastet e trafikimit- me origjinë për shembull nga Moldavia, Ukraina dhe Bjellorusia u zhvendosën nga rajoni i Ballkanit Perëndimor drejt Europës Perëndimor si destinacion parësor. Megjithatë konfliktet e fundit në Azinë Qendrore dhe Afrikë çuan në lëvizjen e migrantëve drejt Ballkanit Perëndimor si vend traziti për në zonën Shengen të BE-së. Në kohën e vlerësimit, aktorët e shohin rajonin fillimisht

10 ICMPD zbatoi 'Programin për përmirësimin e reagimeve të anti-trafikimit në EJL: Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit' në vitin 2008. Projekti synoi krijimin e bankës së të dhënave për ndjekjen penale, reagimin e drejtësisë penale dhe ndihmën dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal për këto fusha specifike. Përvojat e këtyre fushave të përfshira në projekt ishin pozitive, por bankat e të dhënave nuk janë më funksionale. Çdo fushë mbledh dhe menaxhon të dhëna sipas praktikave të veta. http://www.icmpd.org/fileadmin/ICMPD-Website/ICMPD-Ëebsite_2011/Capacity_building/THB/FINAL_Assesment_report_pres.Bucharest.pdf

si rajon tranziti për migrantët e parregullt, rajon origjine dhe më pak zonë destinacioni për TP.

Sipas të dhënave të studimit, Shqipëria është kryesisht vend origjine për rastet. Destinacionet përfshijnë Italinë, Belgjikën, Greqinë, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë dhe gjithashtu Kosovën. Shqipëria është gjithashtu vend tranziti për migrantët e parregullt nga Afrika e Veriut që kryesisht synojnë të hyjnë në zonën Shengen të BE-së si edhe një numër i vogël i rasteve të Filipineve për punë shtëpiake që janë identifikuar në Shqipëri. Burime të shumta raportojnë që ish Republika Jugosllave e Maqedonisë sot është vend origjine dhe destinacioni për TP, si edhe vend tranzit për migracionin e parregullt. Autoritetet gjithashtu raportojnë një rritje të vëllimit të migrantëve të huaj pa dokumente në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, një grup shpesh i pambrojtur ndaj trafikimit. Mes tyre janë vënë re veçanërisht raste të të miturve të pashoqëruar, një grup që konsiderohet tepër i pambrojtur dhe rrezik i madh për TP, si nga autoritet ashtu dhe nga OJQ-të.

Sipas informatorëve të studimit, BH dhe Kosova janë të dy vend origjine për raste me destinacion vendet e Europës Perëndimore dhe pjesë të tjera të rajonit dhe të dy identifikojnë raste të trafikimit të brendshëm. BH vepron gjithashtu si pikë tranziti për rrugët e trafikimit nga Lindja e Mesme drejt BE-së. Mali i Zi është fillimisht një vend tranzit për personat e trafikuar dhe më pak vend origjine ose destinacioni për shfrytëzim seksual dhe pune. Ligjet dhe politikat e BH, Serbisë, Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë e konsiderojnë lypjen nga fëmijët dhe martesat e fëmijëve si një shqetësim në rritje, por jo domosdoshmërisht si TP. Serbia është vend origjine, tranziti dhe destinacioni për trafikimin. Informatorët vunë në dukje sidomos që gratë në Serbi dukej se rrezikonin të trafikoheshin për shfrytëzim seksual në disa vende të BE-së. Serbia u raportua gjithashtu si vend origjine për trafikimin për punë me destinacion Rusinë dhe CIS.[11]

Trafikimi i brendshëm gjendet në mbarë rajonin. Forma kryesore e trafikimit e raportuar vazhdimisht në vend dhe në nivel ndërkombëtar, mbetet shfrytëzimi seksual. Ambientet e shfrytëzimit përfshijnë hotelet, motelet dhe shtëpitë e marra me qira. Një informator nga Serbia shprehet që trafikimi i qenieve njerëzore po "zhvendoset" nga restorantet dhe lokalet në apartamente private dhe klube me anëtarësi, një praktikë e vënë re edhe në Shqipëri dhe BH. Siç diskutohet më poshtë, dokumentet e studimit, informatorët nga BH, Serbia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova dhe të intervistuarit e sondazhit theksojnë ekzistencën e formave të ndryshme të shfrytëzimit për punë si lypja nga fëmijët dhe puna e detyruar në sektorin e bujqësisë dhe ndërtimit.

Siç sugjerohet, shumica e rasteve të identifikuara në rajon janë vajza të reja të trafikuara për shfrytëzim seksual. Një aspekt i dallueshëm është që femrat janë të reja në moshë dhe shpesh të mitura. Rastet më të identifikuara vijnë nga zona rurale dhe rajone të varfra, urbane dhe rurale. Karakteristika të përbashkëta

11 Komunuelthi i Shteteve të Pavarura (CIS)

që vlejnë në Ballkanin Perëndimor duket se përfshijnë historikun e dhunës në familje dhe abuzimit fizik, psikologjik dhe emocional, neglizhencën prindërore dhe varfërinë ekstreme. Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovë, informatorët kanë raportuar që shumica e rasteve nuk kanë përfunduar arsimin fillor. Sigurisht, pa të dhëna krahasuese, nuk është e qartë nëse ky është një tipar dallues ndërmjet atyre që janë trafikuar dhe atyre me profile të ngjashme socio-ekonomike të cilët nuk janë trafikuar.

Informatorët gjithashtu komentuan atë që kuptonin në lidhje me personat e përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore. Ato theksuan që trafikantët janë individë, persona të afërt me familjen e viktimave (shpesh persona të cilët i njohin dhe u besojnë), ose anëtarë të grupeve të vogla. Siç shtjellon një informator:

> *Trafikimi në disa raste është tepër i organizuar, në disa raste në grupe të vogla, në disa raste oportunist si në rastin kur dy vëllezër marrin një femër për në Itali dhe përpiqen ta shesin në organizata të tjera kriminale. Grupe të tjera të organizuara janë të mirë-organizuara me role të qarta: rekrutë, transportues dhe kontrollues. Ata e bëjnë këtë gjë prej vitesh. Nuk duhet të harrojmë që trafikantët gjithashtu po evoluojnë (Informator i studimit, shkurt 2014).*

Ata gjithashtu citojnë raste të përfshirjes së rrjeteve të organizuara kriminale, shpesh në lidhje me krime të tjera. Bashkëbiseduesit në Kosovë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë në veçanti, specifikojnë që trafikantët shpesh janë pjesë e një ambienti kriminal, por jo domosdoshmërisht kualifikohen si pjesë e një rrjeti të krimit të organizuar. Një raport i kohëve të fundit (Dostic; Gocic 2013) përshkruan marrëdhëniet aktuale ndërmjet trafikantëve dhe krimit të organizuar nëpërmjet llojit të akuzave të ndjekjes penale. Raporti konkludon që është e gabuar që TP të njehsohet me krimin e organizuar në Serbi dhe kudo tjetër në rajon. Statistikat e fundit raportojnë që Qendra për Luftën Kundër Krimit të Organizuar (SBPOK) në Serbi, gjatë periudhës 2010-2012, ka depozituar gjithsej pesë raste me gjashtë akuza penale të cilësuara si raste të trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo është një përqindje e vogël (4.34 %) e të gjitha rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore që ndiqen në Serbi. Kjo sugjeron që shumica e trafikantëve nuk lidhen me krimin e organizuar, por veprojnë si individë ose grupe të vogla të përfshira në veprimtari kriminale që nuk përfshin rrjete të mëdha të organizuara kriminale.

Informatorët identifikuan formate dhe metoda të shumta të rekrutimit të personave që bëhen objekt shfrytëzimi në trafikim. Shumë shpesh rekrutimi bëhet personalisht, por reklamat, interneti, agjenci private punësimi gjithashtu shërbejnë si rrugë për rekrutimin e personave në ato që rezultojnë situata të trafikimit dhe shfrytëzimit. Metodat e përdorura nga rekrutuesit përfshijnë premtimin e një pune të mirë, premtimin për martesë (sidomos mes popullatës etnike rome), dhe ofertën për të shpëtuar nga situata ose vështirësia apo kriza

në familje (për shembull, divorci, dhuna në familje, familje të prishura, ose situata e keqe ekonomike). Këto lloj metodash rekrutimi, shpjegojnë informatorët, përfshijnë një nivel më të ulët dhune sesa ai që ekzistonte më përpara në Ballkanin Perëndimor, duke shtjelluar sesi në disa raste "shpesh arrihet marrëveshjet mes autorit dhe viktimës. Madje ka raste të migracionit për punë seksuale ku një femër bie dakord që të ndajë të ardhurat 50 me 50 me rekrutuesin (për një periudhë kohe), por më vonë kur përpiqen që të largohen, nuk mund të largohen". Një tjetër informator vëren që shumë trafikantë ndryshojnë mënyrën si kërkojnë të kontrollojnë personat që i trafikojnë dhe shfrytëzojnë. Në vend të kontrollit të rreptë të lëvizjes dhe dhunës fizike, përdorin kërcënimet dhe shantazhin, duke përfshirë shpesh familjarët e tyre. Për shkak se çështjet në gjykatë kërkojnë që prokuroria të përcaktojë që ka pasur shtrëngim për të përcaktuar që ka qenë rast i TP, këto forma jo fizike të shtrëngimit e komplikojnë procesin e prokurorisë. Këto të dhëna sugjerojnë që rekrutimi vijon në forma të mirë krijuara/përcaktuara në studimin kundër trafikimit; personat e njohur, grupe të vogla dhe agjenci private punësimi, po ashtu si, për të mos thënë më shumë se, rrjete të mëdha kriminale, rekrutojnë dhe shfrytëzojnë personat që përpiqen t'ia mbathin nga situatat e vështira në shtëpi dhe në ndjekje të punësimit të ri dhe mundësive të jetës.

Modele dhe trende të trafikimit vazhdojnë të zhvillohen në rajon, sa i përket rrugëve, formave të rekrutimit dhe personave të përfshirë. Këto ndryshime paraqesin sfida të vazhdueshme për profesionistët kundër TP dhe theksojnë nevojën për evoluim të vazhdueshëm të reagimit ndaj TP, sidomos në mënyrën se si kuptohen rrugët, rekrutimi, shfrytëzimi dhe viktimat e tij.

Migracioni i parregullt po shtohet në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Sipas shumë dokumenteve dhe informatorëve, rajoni i Ballkanit Perëndimor ka parë ndryshime të shpejta dhe të rëndësishme në trendin e migracionit të parregullt pas prezantimit të regjimit pa viza në zonën Shengen të BE-së. Zbulimi i rasteve të kalimit të parregullt të kufirit, si ndërmjet pikave të kalimit kufitar ashtu edhe në pikat e kalimit kufitar, po shtohet në pjesën më të madhe të rajonit (rritje me 33 përqind dhe 68 përqind përkatësisht në 2012 krahasuar me 2011) (FRONTEX 2013). Vlerësimi i FRONTEX (2013) tregon që në vitin e dytë radhazi, siguria kufitare rajonale e Ballkanit Perëndimor po preket nga fluksi i migrantëve nga Greqia drejt shteteve të tjera anëtare. Kjo rritje lidhet gjerësisht me migrantët e parregullt që synojnë të udhëtojnë nga Afrika e Veriut përmes Greqisë për në shtete të tjera anëtare të BE-së dhe gjithashtu nga një sërë destinacionesh në Azi, më shpesh Afganistan dhe Pakistan.

Bazuar në shifrat e zbulimit nga autoritet kombëtare dhe të raportuara nga FRONTEX (2013), Serbia është vendi më shumë i prekur nga rritja e migracionit të paligjshëm, ku numërohen katër nga dhjetë raste të zbulimit të kalimit të kufirit në mënyrë të parregullt në vitin 2011. Sipas FRONTEX (2013), kufiri ndërmjet Serbisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë është vend i kalimeve të

parregullta, me lëvizje ndërmjet Greqisë dhe Serbisë që kalojnë tranzit përmes kësaj zone. FRONTEX (2013) ka identifikuar gjithashtu një rrugë të re të lëvizjes së parregullt (me mundësi për trafikantët) përmes Kosovës dhe që më pas kalon përmes Malit të Zi, BH dhe Kroacisë.

Informatorët theksojnë dy aspekte të rëndësishme të marrëdhënies ndërmjet migracionit të parregullt dhe trafikimit të personave: një rritje e migracionit të parregullt dhe pasojave të tij në trajtimin e TP, si edhe mungesa e identifikimit të rasteve mes këtyre grupeve të migrantëve. Së pari, siç shpjegon një informator, "migracioni i paligjshëm dhe kontrabandimi i personave sot është problem më i madh për rajonin e Ballkanit Perëndimor sesa trafikimi i qenieve njerëzore" që e ka ulur rëndësinë ndaj investimit në përgjigje të trafikimit të qenieve njerëzore. Në vitin 2012, për shembull, në Serbi u regjistruan 14 000 migrantë të parregullt krahasuar me 43 rastet e identifikuara të trafikimit (Progres Raporti i BE-së, 2013). Për shembull, ligji për menaxhimin e migracionit në Serbi, i miratuar në nëntor 2012, identifikon komisariatin për refugjatët dhe migracionin si pikë fokale qendrore për zhvillimin e politikave dhe praktikave të migracionit. Megjithatë, ky organ është tërësisht i ndarë nga institucionet që reagojnë tradicionalisht ndaj TP në Serbi dhe qeveria duhet të sigurojë koordinim të efektshëm dhe mbështetje për institucione të tjera të rëndësishme që trajtojnë migracionin, sidomos këshillat vendore për migracionin të krijuara së fundmi (Progres Raporti i BE-së, 2013 faqe 49). Në përgjithësi, informatorët kanë shprehur shqetësimin që institucionet e reja dhe ekzistuese në përgjigje të migracionit nuk bashkëpunojnë në mënyrë të efektshme me njëra-tjetrën, dhe as nuk trajtojnë mjaftueshëm fenomenin e TP.

Informatorët gjithashtu theksojnë natyrën shfrytëzuese të rasteve më të shumta të migracionit të parregullt dhe mundësinë që ky grup të përbëjë një numër të madh të rasteve të trafikimit. Si informatorët e studimit ashtu edhe FRONTEX identifikuan një trend të ri në lidhje me migracionin dhe trafikimin, ku grupe kriminale detyrojnë migrantët e parregullt me borxhe monetare që të veprojnë si guida për migrantë të tjerë nga Afganistani dhe Pakistani që lëvizin përmes rajonit (FRONTEX, 2013). Këto "guida" qëndrojnë në zonat e tranzitit, duke vepruar si lehtësues/kontrollues për migrantë të tjerë në tranzit. Kur migrantët i paguajnë detyrimin e tyre trafikantëve, "guidat" shkojnë në vende më afër destinacionit përfundimtar. Këto lëvizje, "në tranzit" mund të zgjasin për disa vjet, deri në momentin që paguhet tërësisht detyrimi. Këto raste ilustrojnë një formë tërësisht të re të shfrytëzimit dhe trafikimit për të cilën duhet të zhvillohen reagime. Këto reagime kërkojnë burime të duhura për të trajtuar nevojat e këtyre migrantëve, përfshirë aftësitë gjuhësore dhe kulturore për të fituar besimin e tyre dhe për të ofruar mbështetje.

Informatorët identifikojnë mungesë thelbësore të mekanizmave për identifikimin e rasteve të trafikimit mes grupeve të migrantëve të parregullt. Mes termave që përdoren më shpesh për të përshkruar mekanizmat e identifikimit në rajon, informatorët shpesh zgjedhin "i pamjaftueshëm" "nuk ekziston" (shihni gjithashtu Tabelën 4: Politika dhe praktika të identifikimit). Një informator sugjeron që

mes 14 000 migrantëve të parregullt të përmendur më sipër, vetëm dy ishin identifikuar raste trafikimi, duke u shprehur që "është bërë e dukshme se mes kësaj kategorie të migrantëve të parregullt, gratë, të rinjtë dhe fëmijët janë në një pozitë veçanërisht të rrezikshme dhe ekziston rreziku për forma të ndryshme shfrytëzimi. Megjithatë, pavarësisht përpjekjes së moderuar, autoritetet nuk mund të identifikonin raste të trafikimit mes këtyre migrantëve të paligjshëm". Në vitin 2012, autoritetet në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë identifikuan 682 migrantë të parregullt me shifrën më të lartë të zbuluar në kufirin me Serbinë (Raporti i Progresit të BE-së, 2013). Raporti më tej thekson që zonës i mungon kapaciteti strategjik për t'iu përgjigjur shifrave në rritje të migrantëve që kalojnë tranzit në zonë. Disa informatorë theksojnë që procedurat ekzistuese në kufi nuk janë shumë të efektshme për të zbuluar migracionin e parregullt nga Greqia dhe më tej tranzitin drejt Serbisë. Sipas zyrtarëve në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, autoritetet nuk kanë identifikuar raste të trafikimit mes popullatave të migrantëve të parregullt vitet e fundit. Megjithatë, të dhëna nga burime të tjera tregojnë që migrantët e parregullt janë mes grupeve më të rrezikuara nga trafikimi, duke sugjeruar pamjaftueshmëri të mekanizmave ekzistuese të identifikimit në rajon (IOM, 2013, faqe 233).

Kështu, rritja e migracionit të parregullt paraqet një sfidë të dyfishtë për trafikimin e personave sa i përket vëmendjes që ka gjasa të shmanget nga problemi dhe burimeve, duke krijuar një hapësirë në rritje ku rrjetet kriminale kanë mundësi të shfrytëzojnë migrantë tepër të rrezikuar nëpërmjet trafikimit dhe formave të tjera të abuzimit.

Informatorët në rajon raportojnë rritje të trafikimit të brendshëm, duke dhënë shpjegime për këtë rritje.

Informatorë nga Shqipëria, BH, Kosova, Serbia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë identifikojnë trafikimin e brendshëm si forma aktualisht dominuese e zbuluar e trafikimit. Në të gjitha vendet, rastet më të identifikuara janë të vajzat e reja, shpesh të mitura. Në ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, për shembull, në një strehëz janë akomoduar 88 raste ndërmjet 2005 dhe 2012. Përveç një djali, të gjitha ishin femra, shtetase të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë që kishin qenë objekt i trafikimit të brendshëm. Në Serbi, në vitin 2013, u identifikuan 92 raste nga të cilat 70 përqind të trafikuara në vend. Vetëm katër shtetas të huaj u identifikuan në rastet e trafikimit në të njëjtin vit (Raporti Vjetor i Serbisë, 2013). Në BH, raporti i Koordinatorit të Shtetit në 2012, vëren "duket se ekziston trendi i rritjes së vazhdueshme të numrit të viktimave vendase që trafikohen në vend, së bashku me një numër në rritje të viktimave të huaja të trafikimit". Siç sugjerohet nga këto shembuj, pjesa më e madhe e rajonit është spostuar drejt reagimit ndaj rritjes në zbulimin e rasteve të trafikimit të brendshëm.

Informatorët dhanë shpjegime të ndryshme për raportin e rritur të rasteve të trafikimit të brendshëm. Siç vëren një raport, ky ndryshim në theksin e përpjekjeve të identifikimit ishte një funksion i përkufizimit historik dhe rasteve të trafikimit:

> *Trafikimi i brendshëm i personave ka qenë i padukshëm për një periudhë më të gjatë kohe. Policia, në fluksin e shtetaseve të huaja, u fokusua tërësisht në treguesit e dukshëm për identifikimin e viktimave të trafikimit të personave si për shembull: dokumente udhëtimi të konfiskuara, qëndrim i paligjshëm, gjurmë të dukshme të dhunës fizike, liri e kufizuar e lëvizjes dhe mosdije e gjuhës maqedonase. Këta tregues nuk janë tipik për viktimat maqedonase ose vendase dhe për trafikim të brendshëm (Balkan Act Now, 2013, faqe 145).*

Siç sugjeron ky citim, zyrtarët nuk kanë pasur përvojë dhe trajnim të nevojshëm për të identifikuar raste të trafikimit të brendshëm. Ndërsa ky fenomen është dokumentuar më së miri në rajon, njohja zyrtare e problemit mund të konsiderohet për rritjen aktuale në rastet e identifikimit (Limanowska, 2004, faqe 62).

Të dhëna të tjera të studimit tregojnë që rritja rajonale është rezultat i shfrytëzimit nga trafikantët të fokusit të mëparshëm rajonal dhe nën-rajonal mbi rastet e huaja:

> *Trafikantët e personave, që përballen me situatën e re në rajon, u kthyen drejt tregut të brendshëm dhe trafikimit të brendshëm të personave, duke përdorur mangësitë në strategjitë dhe legjislacionin kombëtar që mbulon trafikimin e personave që në këtë periudhë janë fokusuar fillimisht drejt goditjes së trafikimit ndërkombëtar të personave (Balkan Act Now, 2013, faqe 145).*

Informatorë të tjerë i vunë fajin kushteve ekonomike të këqija për rastet e shtuara të trafikimit të brendshëm. Për shembull, ata përmendin varfërinë në rritje, nivelet e larta të papunësisë dhe kushtet përgjithësisht të këqija socio-ekonomike që kontribuojnë në këtë rritje. Norma e papunësisë në rajon është shumë e lartë (për shembull, mbi 30 përqind në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe rreth 40 përqind në BH), me papunësi afatgjatë mes të rinjve, popullsive rurale, pakicave kombëtare (sidomos grave të pakicave etnike) dhe atyre më pak të shkolluar. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, një në dhjetë fëmijë nuk është regjistruar në arsimin fillor dhe një në pesë fëmijë nuk është regjistruar në institucion të arsimit dytësor, edhe pse është i detyrueshëm.[12] Sipas informatorëve kjo situatë ka çuar në rritjen e trafikimit të brendshëm.

> *Raste të trafikimit për forma të shumëfishta të shfrytëzimit për punë duket se po shtohen në Ballkanin Perëndimor.*

Shumë dokumente dhe informatorë citojnë që trafikimi për shfrytëzimin për punë po rritet në mbarë rajonin. Raporte kombëtare për trafikimin dhe informatorët nga

12 Zyra Statistikore e Shtetit, Femrat dhe Meshkujt në Maqedoni 2012

BH, Serbia, Shqipëria, Mali i Zi dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë theksojnë ekzistencën e shfrytëzimit për punë në sektorët e bujqësisë dhe ndërtimit, që përfshijnë kryesisht meshkujt. Një vlerësim i sektorit të punës në 2011 konstaton epërsinë e shfrytëzimit për punë në sektorin e tekstileve, turizmit dhe kateringut në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (Balkan Act Now, 2013 faqe 115). Kuadri ligjor kombëtar dhe strategjitë kombëtare njohin shfrytëzimin për punë si një shqetësim në rritje dhe e trajtojnë në dokumentet strategjike kombëtare. Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm, 2013-2016 e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për shembull pranon që ndërsa fokusi kryesor është në trafikimin për shfrytëzim për qëllime seksuale, trafikimi përfshin shumë forma të tjera të trafikimit për punë në përgjigje të të cilit duhet që të zhvillohet "një gamë e gjerë aktivitetesh" (Strategjia Kombëtare 2013). Megjithatë, në praktikë, rajonit i mungojnë mekanizmat dhe shërbimet për të reaguar ndaj formave të shumta të shfrytëzimit për punë. Siç shpjegon një informator, deri tani, "inspektorët e punës asnjëherë nuk kanë raportuar ndonjë rast dhe as nuk kanë aktualisht kapacitetin ligjor ose formal për të raportuar" (Informator i studimit, mars 2014). Në të vërtetë, siç sugjerojnë dokumente të ndryshme të studimit, gjatë katër ose pesë viteve të fundit, aktorët në mbarë rajonin kanë filluar të pranojnë që nevojiten reagime të efektshme ndaj shumësisë së formave të shfrytëzimit për punë.

Të dhënat e studimit citojnë gjithashtu një numër domethënës të rasteve të trafikimit për jashtë vendit me qëllim shfrytëzimi për punë në Shqipëri, BH dhe Serbi. Këto raste përfshijnë shumë shtetas të Shqipërisë, BH dhe Serbisë që shfrytëzohen jashtë vendit. Një studim i vitit 2010 për trafikimin e meshkujve në Europë raporton që rastet i nënshtrohet orëve të zgjatura të punës, dëmtimeve dhe problemeve shëndetësore, mohimit të dhënies së kujdesit mjekësor, kushteve të këqija të punës, cilësi të keqe të ushqimit dhe ushqim të racionuar, pagë të ulët ose mospagesë, ndalim dhe izolim dhe abuzim psikologjik, fizik dhe seksual (USAID, 2010). Në Shqipëri disa informatorë vërejnë që në Greqi ka shfrytëzim të madh të punës së shqiptarë, me një fluks të madh deportimesh një ditë përpara ditës së pagesës si një formë e zakonshme mashtrimi. Të dhëna të tjera sugjerojnë që ka një numër në rritje të rasteve serbe të shfrytëzimit për punë jashtë vendit. Për shembull, në vitin 2013, Serbia identifikoi 22 raste të shfrytëzimit për punë, 19 prej të cilave u identifikuan në Bjellorusi (Raporti Vjetor, 2013). Në praktikë, informatorët ishin të shqetësuar që këto raste nuk njihen si raste të trafikimit nga nëpunësit në vendet e destinacionit. Kjo ka bërë që personat që kanë qenë objekt trafikimi "të kthehen në shtëpi me shpenzimet e tyre ose të deportohen me kërkese të kompanive që i kanë shfrytëzuar". Madje ata besojnë që Serbia ka ndryshuar nga një vend destinacioni në një "vend origjine për shfrytëzimin për punë dhe vend burimi dhe destinacioni për punë në lidhje me shfrytëzimin për qëllime seksuale" (Informator i studimit, mars 2014). Të dhëna të studimit tregojnë që njohja e efektshme dhe reagimet ndaj këtij ndryshimi kanë qenë të ngadalta.

Shumë informatorë bien dakord që inspektorët e punës kanë rol në zbulimin dhe referimin e rasteve të mundshme të trafikimit për shfrytëzimin për punë.

Megjithatë, ka kufizime në mënyrën se si duhet të veprojnë inspektoratet e punës. Për shembull, siç theksohet në një raport, " në Serbi, inspektorët e punës kanë të drejtë të inspektojë vetëm bizneset e regjistruara zyrtarisht". Madje, inspektoratet e punës kanë kapacitet të kufizuar" (250 inspektorë pune për rreth 324500 biznese të regjistruara) për të mbikëqyrur vendet ku mund të ketë shfrytëzim (GRETA 2013, Serbi). Qeveria e ka pranuar këtë boshllëk dhe është në proces të ndryshimit të rregullave për t'ju dhënë inspektorëve të punës autoritetin që të kontrollojnë subjektet të cilat punësojnë migrantë të parregullt "në mënyrë proaktive" me qëllim identifikimin dhe reagimin ndaj rasteve të shfrytëzimit për punë në mënyrë më të efektshme.

Në fakt, burime të shumta të dhënash theksojnë që shfrytëzimi për punë mbetet gjerësisht i pazbuluar dhe i pa raportuar, por siç vëren një informator, ai është "i pranishëm dhe në rritje". Ajo që shfaqet si shqetësimi kryesor është mungesa e reagimit të duhur institucional ndaj shfrytëzimit për punë të meshkujve në ndërtim, bujqësi dhe turizëm si sektorët dominues të shfrytëzimit për punë.

Forma të reja të shfrytëzimit të fëmijëve janë shfaqur në Ballkanin Perëndimor.

Burime të shumta të dhënash diskutojnë një rritje të rasteve të trafikimit të fëmijëve në rajon, sidomos për qëllim lypjeje. Ato citojnë në veçanti rritjen në numrin e fëmijëve që lypin në rrugë në BH, Kosovë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipëri. Informatorët në BH duke përmendur përvojën personale dhe të dhëna nga një qendër ndihme për fëmijët në një OJQ, vërejnë që ndërsa në të shkuarën shumica e atyre që lypnin ishin fëmijë të komunitetit rom dhe komuniteti tjetër të pakicave etnike, tani lypësit fëmijë vijnë nga një origjinë më heterogjene dhe veprimtaritë e tyre të lypjes janë të organizuara nga kriminelë shfrytëzues.

Raporte nga Shqipëria, BH dhe Kosova theksojnë shfrytëzimin e fëmijëve për lypje në qendra urbane sidomos në semafor, shëtitoret kryesore dhe trotuare të rrugëve kryesore. Gjatë sezonit turistik, veprimtaria shtrihet në vendndodhje të turizmit dhe pika të kalimit kufitar. "Forma mbizotëruese e shfrytëzimit për punë është lypja nga fëmijët. Në të shkuarën, problemi i fëmijëve që jetojnë dhe punojnë në rrugë nuk është klasifikuar si trafikim i qenieve njerëzore" (BH 2010). Siç sugjeron ky citim, autoritetet kanë filluar të njohin problemin e lypjes së fëmijëve në lidhje me trafikimin me qëllim shfrytëzimi për punës. Megjithatë, të dhënat e studimit sugjerojnë një reagim të pamjaftueshëm ndaj raportimeve të shumta për "punën e fëmijëve gjithë ditën në rrugë", në mungesë të "institucioneve kompetente" që të ofrojnë "ndërhyrje serioze" ose shërbime. (OSBE, 2011).

Forma të tjera të shfrytëzimit të fëmijëve në rajon që shpesh nuk zbulohen nga nëpunësit, përfshijnë shfrytëzimin seksual. Në BH, për shembull, studimi ka dokumentuar një rritje të trafikimit të fëmijëve për shfrytëzimin për punë ose seksual (lypja e fëmijëve, martesa me detyrim) (Save the children, 2013).

Megjithatë, aktorët përkatës shpesh nuk i kushtojnë vëmendje kësaj forme të trafikimit të qenieve njerëzore në sistem. Siç shpjegon një informator në BH:

> *Për shkak të padijes për problemin dhe format e trafikimit, përveç shfrytëzimit seksual, të vazhduar nga mungesa e vullnetit për të marrë masat e duhura kundër trafikimit ose për shkak të diskriminimit, sistemi nuk reagon si duhet për të parandaluar ose dënuar trafikimin e fëmijëve (Informator i studimit, shkurt 2014).*

Raportet e fundit tregojnë një rritje të rasteve të martesave të detyruara të fëmijëve që përfundojnë me shfrytëzim. Fëmijët rom janë veçanërisht më të pambrojtur ndaj kësaj forme shfrytëzimi GRETA, 2013, BH).

Serbia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë kanë dokumentuar gjithashtu trafikimin e fëmijëve për martesat me detyrim. Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Strategjia Kombëtare 2013-2016 identifikon këtë si një trend të ri, duke u shprehur që viktimat janë veçanërisht të mitura nga 14-17 vjeç, të komunitetit Rom (Strategjia Kombëtare, 2013). Dokumenti shpjegon:

> *Trafikantët ose porositësit e nuseve më shpesh janë nga Serbia ose Republika e Maqedonisë që punojnë përkohësisht në BE. Pas mbërritjes së viktimës në vendin e destinacionit, ajo i nënshtrohet përdhunimit, torturës dhe ndëshkimit fizik nga anëtarët e familjes së bashkëshortit, dhe më pas i nënshtrohet shfrytëzimit për qëllime seksuale dhe punë (Strategjia Kombëtare 2013).*

Nuk është e qartë nëse ky përshkrim paraqet një trend donimues, por është rasti që të dhënat e studimit identifikojnë trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve në rajon si një zonë e shqetësimit dominues dhe në nevojë për kërkim dhe për më shumë reagim.

OJQ-të dhe nëpunësit kanë perceptime të ndryshme për qëllimin dhe mjaftueshmërinë e reagimeve ndaj TP në rajon.

Të dhënat e studimit tregojnë qartë dallimin ndërmjet këndvështrimit të OJQ dhe qeverisë në lidhje me TP në rajon. Ato shprehin mendime të ndryshe në lidhje me shtrirjen e problemit të TP dhe nivelin e reagimit të qeverisë ndaj tij. Informatorët e OJQ-ve në rajon theksojnë rëndësinë e problemit të TP dhe shprehën shqetësimin që qeveritë nuk po i kushtonin mjaftueshëm vëmendje kësaj çështjeje. Në mbështetje të këtij këndvështrimi, një raport shpjegon "*perceptimi* që trafikimi i qenieve njerëzore po venitet si problem" ka çuar në rialokimin e "fondeve të jashtme që më përpara ishin në dispozicion për veprimtaritë trajnuese...tek përparësi të tjera" (GRETA 2013 BH). Një informator ia atribution prioritizimin e mëparshëm të reagimit ndaj TP presionit ndërkombëtar nga Raporti i SHBA për TP, por shton që "nuk ka çështje politike për trafikimin në ditët e sotme", duke

sugjeruar që pa presion politik të jashtëm, qeveritë në rajon nuk ka të ngjarë të prioritizojnë trajtimin e këtij problemi.

Përkundrazi, zyrtarët në rajon shprehnin mendimin që vetë problemi ishte zvogëluar, duke cituar në veçanti rënien e numrit të rasteve të identifikuara. Tipike për një sërë informatorësh qeveritar, njëri sugjeroi "TIP nuk është problem i rëndësishëm...shumica e rasteve që policia i heton si raste TP janë raste të diskutueshme dhe ndjekja e tyre përfundon me akuza të tjera penale. Në shumicën e rasteve, hetimi mbyllet me përfundimin që çështjet e shfrytëzimit për qëllime seksuale janë çështje të prostituimit me pëlqim".

Lloje të shumtë informatorësh vërejnë gjithashtu që sfida të tjera rajonale kishin eklipsuar TP si përparësi. Aktorët rajonale duhet t'i përgjigjen niveleve të larta të papunësisë dhe mungesës së përgjithshme të mundësive; varfërisë; pabarazisë gjinore; dhunës me bazë gjinore; dhe mungesës së politikave dhe institucioneve të mbrojtjes sociale. Ata duhet që të trajtojnë gjithashtu forma në rritje të migracionit të parregullt, sidomos në Kosovë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbi. Padyshim, migracioni i parregullt shpesh përmban raste të TP. Por informatorët e ndjejnë në përgjithësi që nevoja për t'i kushtuar burimet këtyre sfidave shoqërore gjithëpërfshirëse po pengonte aktorët qeveritarë që të fokusoheshin dhe të zhvillonin reagime specifike ndaj TP.

3.2 Identifikimi dhe referimi

Në këtë seksion, trajtojmë kuadrin ekzistues për identifikimin dhe referimin e rasteve (të mundshme) të trafikimit të qenieve njerëzore. Ky seksion është gjerësisht përshkrues dhe jep sfondin për një diskutim të detajuar të boshllëqeve dhe përparësive në proceset e identifikimit dhe referimit që paraqiten më poshtë. Gjithashtu është rasti në të cilin informatorët janë fokusuar pothuajse tërësisht në identifikim gjatë mbledhjes së të dhënave. Seksioni 3.4 përfshin diskutim të mëtejshëm të referimit në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional.

Rajoni ka disa sisteme të ndryshme dhe ndonjëherë që nuk përputhen për identifikimin e rasteve të TP.

Të dhënat e studimit tregojnë që qeveritë dhe institucionet në mbarë Ballkanin Perëndimor kanë nivele të ndryshme të mekanizmave funksionalë për identifikimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore. Ndërsa pothuajse 60 përqind e të intervistuarve raportojnë një përkufizim zyrtar plotësisht funksional të TP në vendin ose rajonin e tyre, vetëm rreth 30 përqind e tyre përmendin linjat telefonike direkte dhe MKR në mbështetje të identifikimit, si të tilla që janë plotësisht funksionale. Në shumë raste, të intervistuarit theksuan mekanizmat kyçe për identifikimin- politikat zyrtare, MKR, standardet kombëtare- si vetëm pjesërisht funksionale (38, 37 dhe 41 përqind, përkatësisht). Këto të dhëna sugjerojnë disa boshllëqe dhe rrugë dhe mënyra të papërshtatshme për të

përcaktuar dhe mbështetur personat që kanë qenë objekt trafikimi të qenieve njerëzore.

Tabela 4: Politikat dhe Praktikat e Identifikimit

	Plotësisht funksionale	Pjesërisht funksionale	Jo funksionale	Nuk janë krijuar	Nuk e di
Politika formale për atë që mund të përcaktojë VT	54.6	38.1	3.1	1.0	3.1
Përkufizimi zyrtar i TP	58.8	29.9	5.2	4.1	2.1
Udhëzime përzgjedhjeje	45.7	35.1	7.4	8.5	3.2
Linja telefonike direkte	31.2	18.6	6.8	19.4	24.1
MKR	51.0	36.5	6.3	2.1	4.2
MNR	31.6	40.8	11.2	6.1	10.2
Standarde kombëtare për trajtimin e VT	47.9	40.6	2.1	4.2	5.2
Mbledhja e reagimit nga VT	27.4	25.3	5.3	23.2	18.9

Burimi: Sondazh i Aktorëve (Vlerësimi i IOM-së për Nevojat në BP, 2014)
Shënime: Tabela tregon përqindjet sipas rreshtave; në çdo rresht shuma është 100 përqind. Të dhënat e munguara nuk janë përfshirë në llogaritjen e përqindjes

Intervista të studimit tregojnë gjithashtu disa mospërputhje dhe boshllëqe në mjetet e identifikimit dhe përcaktimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore. Aktorë të ndryshëm kanë bërë dallimin ndërmjet një rasti të prezumuar të trafikimit, që mund të ketë akses në ndihmën fillestare në pritje të përcaktimit të plotë të statusit dhe një rasti zyrtar të trafikimit, që ka të drejtë për ndihmë afatgjatë. Ata gjithashtu e zbatuan këtë dallim në mënyra të ndryshme: Në Shqipëri, për shembull, ka *Procedura Standarde Pune (SOP) për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit ose viktimave të mundshme*, që mbulojnë të gjitha format e shfrytëzimit dhe trafikimin e brendshëm ose ndërkombëtar. SOP janë përgatitur në vitin 2011 nga Zyra e Anti-Trafikimit të Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Personave. SOP përfshijnë tregues për identifikimin fillestar i cili, i ndjekur nga identifikimi formal nëpërmjet një "Formulari të Intervistës Formale" (bashkëngjitur Marrëveshjes për Mekanizmin Kombëtar të Referimit). Ky pyetësor duhet të përdoret formalisht për të identifikuar raste të trafikimit. Marrëveshja MKR kërkon që të gjithë aktorët e përfshirë në identifikimin formal të përdorin këtë formular (SOP, 2011). Me qëllim rritjen e kapaciteteve të aktorëve të tjerë që luftojnë TP, Ministria e Shëndetit,

me mbështetjen e Njësisë së Anti-Trafikimit dhe IOM, ka shtuar udhëzimet për profesionistët e shëndetit që të dallojnë raste të TP në SOP. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, sektori i shëndetësisë duhet të identifikojë dhe të referojë çdo rast të mundshëm të trafikimit deri tani (GRETA, 2011).

Në BH, autoritetet zbatojnë kritere të ndryshme identifikimi, në varësi të rastit të mundshëm nëse ky i fundit është i huaj apo vendas. Autoriteti kryesor që bën identifikimin fillestar të rasteve të huaja është Shërbimi Shtetëror për Punët e të Huajve dhe Ministria e Shtetit për Sigurinë[13]. Për raste të brendshme, Rregullorja e Mbrojtjes së Viktimave dhe Viktimave-Dëshmitarë të Trafikimit të Qenieve Njerëzore që janë shtetas të BH kërkon që çdo institucion, OJQ, person fizik ose juridik që dyshon se një person është rast i mundshëm trafikimi informon menjëherë Agjencinë e Shtetit për Mbrojtje dhe Informim (SIPA) dhe Prokurorinë.[14] Sipas të njëjtës rregullore, Prokuroria, Agjencia e Shtetit për Mbrojtje dhe Informim ose gjykatat janë përgjegjëse për të bërë identifikimin formal të një rasti trafikimi të brendshëm bazuar në informacionin e mbledhur nga autoritetet, policia dhe prokuroria dhe një "interviste vullnetare" për rastin e mundshëm të trafikimit. Prokuroria, Agjencia e Shtetit për Mbrojtje dhe Informim ose gjykatat fillojnë procesin e identifikimit formal të një rasti trafikimi vetëm kur besojnë që ka prova të mjaftueshme për të filluar një procedim penal.

Për rastet e TP të huaj, *Rregullorja për Viktimat e Huaja* në BH përfshin treguesit e përcaktuar të trafikimit që përfshijnë për shembull vendin dhe kushtet e zbulimit të personit, gjendjen psiko-fizike të personit, mbajtjen e dokumenteve të udhëtimit ose identifikimit, mes të tjerash.[15] Një punonjës përgjegjës i Shërbimit për Çështjet e të Huajve zhvillon një intervistë për rastin e mundshëm që të verifikojë ekzistencën e këtyre treguesve. Të dhënat e studimit sugjerojnë që aktorët përkatës nuk zbatojnë rregullat dhe udhëzimet për procedurat e identifikimit në mënyrë konsistente dhe që identifikimi është për rrjedhojë disi arbitrar. Në fakt, disa informatorë nuk kishin dijeni për rregulla specifike, lista kontrolli ose procedura standarde për identifikimin e rasteve. Kjo ka çuar në një situatë ku raste të mundshme trafikimit mund të intervistohen shumë herë nga organe të ndryshme (GRETA, 2013 BH).

Në Kosovë, SOP (2008) aktuale mundëson mënyra të shumta për identifikimin e rasteve të trafikimit, përfshirë shtetasit, stafin e agjencive të zbatimit të ligjit, shërbimet e imigracionit, vetë viktimat, persona të tjerë të trafikuar, familjen ose të njohur, inspektorë të punës, organizata jo qeveritare ose ndërkombëtare, (vendase ose ndërkombëtare), staf të kujdesit shëndetësor, nëpunës të ambasadave ose konsullatave, staf transporti dhe kështu më radhë. Siç përcaktohet në ligjin për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve

13 Rregullore për mbrojtjen e viktimave të huaja të trafikimit, ("Službeni glasnik BiH", br. 32/02 i 102/09), Ministarstvo sigurnosti, Sarajevë 2004

14 Rregullore për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave-dëshmitarë të trafikimit të qenieve njerëzore që janë shtetas të BH, Këshilli i Ministrave të BH, 2007

15 Rregullore për mbrojtjen e viktimave të huaja të trafikimit - Pravilnik o zaštiti stranaca žrtava trgovine ljudima, ("Službeni glasnik BiH", br. 32/02 i 102/09), Ministarstvo sigurnosti, Sarajevë 2004

njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit[16], "policia, prokuroria, avokati i viktimës dhe qendrat e punës sociale në përputhje me SOP të përgatitura nga autoritetet përkatëse" janë përgjegjëse për të përcaktuar zyrtarisht një rast. Megjithatë, në praktikë, informatorët vërejnë që policia është autoriteti kryesor në identifikimin e rasteve të trafikimit. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2011-2014 (2011) dhe SOP (2008) mundësojnë që inspektorati i punës, rojet kufitare dhe seksionet konsullore të identifikojnë dhe të raportojnë raste të trafikimit. Megjithatë, siç e shpjegon një informator "udhëzime specifike administrative për të zbatuar këto procedura me qëllim që të bëhen operacionale duhet të formulohen dhe të miratohen" – përsëri, konkluzioni i rregullave të shkruara nuk është përkthyer në mekanizma operacionale.

Sipas SOP (2008) të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, njësia e Ministrisë së Brendshme për luftën kundër trafikimit të personave dhe kontrabandimit të migrantëve dhe/ose qendrat e punës sociale (CSW) janë përgjegjëse për identifikimin e rasteve të trafikimit. SOP ngarkon punonjësit kufitarë me detyrën për të informuar njësinë kur dyshojnë për një rast trafikimi. Si thuhet më sipër, këto qendra janë të autorizuara gjithashtu për të identifikuar raste të trafikimit, sidomos mes fëmijëve me të cilët ato punojnë. Nëse një OJQ identifikon një rast të mundshëm, stafi është i autorizuar vetëm që ta referojë personin tek njësia e Ministrisë së Brendshme; vetëm stafi qeveritar është i autorizuar për të filluar procesin formal të identifikimit.

Mali i Zi ka një tjetër variacion në procesin e identifikimit. Këtu, Drejtoria e Policisë është përgjegjëse për identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit. Megjithatë, sipas një informatori të studimit, kriteret që përdor policia për të identifikuar raste të mundshme nuk ndahen në mënyrë transparente me aktorë të tjerë. Gjithashtu, treguesit për identifikimin e hershëm janë zhvilluar në bashkëpunim me OSBE-në, përfshirë treguesit për punonjësit në sektorin e shëndetit. Këta tregues janë prodhuar në formën e një "karte xhepi" e cila është në dispozicion të të gjitha institucioneve që marrin pjesë në zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, përfshirë punonjësit e policisë kufitare" (GRETA, 2012). Pas zbulimit të një rasti të mundshëm të trafikimit të qenieve njerëzore, nëpunësit njoftojnë Departamentin e Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, i cili merr përsipër çështjen. Rasti i mundshëm ka statusin e një "pale të dëmtuar" sipas Kodit të Procedurës Penale dhe konsiderohet si rast i mundshëm i trafikimit. Vetëm pasi gjykata të shpallë trafikantët e akuzuar fajtorë të një vepre penale të TP, rasti i mundshëm përcaktohet si i tillë zyrtarisht.

Në vitin 2012, qeveria e Serbisë krijoi Qendrën për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore me qëllim identifikimin dhe referimin e rasteve (GRETA, 2013 Serbi). Qendra përmban Zyrën për Koordinimin dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, kompetencat të cilat i korrespondojnë pjesërisht atyre të

16 Ligji nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Ligji_kunder_trafikimit-_Anglisht.pdf

ish Agjencisë. Qendra është institucion i pavarur nën juridiksionin e Ministrisë së Punës, Punësimit dhe Politikave Sociale dhe prandaj identifikimi bazohet në qasjen e mbrojtjes sociale. Identifikimi i rasteve të trafikimit fillon nga policia, qendrat e punës sociale, OJQ-të, strehëzat për viktimat e dhunës në familje, qendrat për fëmijët pa kujdes prindëror ose struktura të tjera të rëndësishme. Organi ose personi që haset me një rast të mundshëm trafikimi dërgon informacionin fillestar tek Qendra për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit. Sipas Qendrës, rreth 80 përqind e rasteve të mundshme të trafikimit raportohen nga policia. Kjo konfirmohet nga statistikat kombëtare (73 përqind e identifikimeve bëhet nga policia dhe 23 përqind nga Qendrës e Punës Sociale) (Raporti Vjetor i Serbisë, 2013)

Megjithatë, Serbia nuk ka protokoll zyrtar për të përcaktuar rastet e trafikimit dhe sipas informatorëve të shumtë, "procedura është e paqartë, ndërsa shumë persona të institucioneve nuk kanë dijeni për punën e Agjencisë për Koordinimin e Mbrojtjes së Viktimave të Trafikimit dhe kompetencat e saj". Sipas raporteve (GRETA, 2013, Serbi) dhe informatorëve, Rregullorja për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit në Sistem të Mbrojtjes Sociale u përgatit në maj 2012, por në kohën e këtij vlerësimi nuk është akoma në fuqi. Për shkak të mungesës së udhëzimeve të miratuara zyrtarisht në lidhje me identifikimin, informatorët kyç shprehen që ka disa kritere të brendshme, por këto nuk janë miratuar apo aprovuar zyrtarisht. Këto rregulla aktualisht po shqyrtohen nëpërmjet një projekti të mbështetur nga IOM/SDC dhe udhëzimet që reflektojnë kërkesat kontekstuale pritet që të miratohen zyrtarisht shumë shpejt.

Në disa vende përdoren linjat telefonike direkte për identifikimin e rasteve të trafikimit. Ndërsa ato janë në forma të ndryshme në rajon, informatorët nuk mendojnë që këto linja kanë qenë veçanërisht të efektshme për identifikimin e rasteve. Megjithatë nuk ka pasur të dhëna specifike për raportimin e rasteve në rajon të vetë-raportimeve përmes një linje telefonike direkt, edhe pse shifrat janë të ulëta në të gjitha vendet. Shqipëria është mes vendeve nën-rajonale me një linjë të tillë që quhet linja SOS për të gjitha rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, e cila është në dispozicion 24/7 falas. Në BH, një informator komenton "linjat telefonike për viktimat e trafikimit u krijuan që në fazën e parë të shfaqjes së trafikimit nga OJQ të ndryshme. Megjithatë, këto vareshin nga financim i jashtëm dhe u mbyllën kur mbaroi financimi. Qeveria asnjëherë nuk krijoi një linjë telefonike kombëtare". Një informator theksoi që një OJQ ka një Linjë Ndihme SOS për viktimat e të gjitha krimeve, që është në dispozicion 24/7 dhe falas, ndërsa një tjetër OJQ dhe Ministria e Sigurisë kanë një linjë telefonike direkte nëpërmjet të cilës shtetasit mund të raportojnë veprimtari të dyshimta ose krime, duke ruajtur anonimatin. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka dy linja ndihme që drejtohen nga një OJQ: një numër fiks për thirrje nga jashtë dhe një numër pa pagesë për thirrjet nga vendi. Të dyja janë në punë nga ora 8:00 deri në 20:00. Në Serbi, ekziston një linjë direkte që drejtohet nga një OJQ e cila ndihmon personat në rrezik për TP. Informatorët vërejnë që kjo linjë direkte ka "regjistruar vetëm dy raste të trafikimit të viktimave që arritën të telefononin direkt nga situata e dhunës së rëndë" gjatë tetë viteve të shkuara. Qendra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave të Trafikimit krijoi një linjë telefonike 24-orë për personat në nevojë për ndihmë për TP. Edhe pse në fillim

kjo linjë do të ishte falas, nuk rezultoi të ishte falas. Informatorë të tjerë sugjerojnë që viktimat e trafikimit në rrezik më pak të afërt janë identifikuar përmes kësaj linje. Në Malin e Zi, një OJQ ka vënë në punë një linjë telefonike 24-orë për personat në rrezik trafikimi. Në Kosovë, OSBE ka ndihmuar me fillimin e një linje falas që shërben si pikë kontakti për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.
Edhe pse me shumë ndryshime, të dhënat e studimit sugjerojnë që të gjitha vendet kanë mjetet për identifikimin e rasteve të trafikimit të vend. Informatorët e kuptojnë që procedurave dhe proceseve ekzistuese të identifikimit u mungojnë treguesit kyç të trafikimit, duke i bërë të paplotë, dhe në disa raste të paefektshëm. Këto kritere gjithashtu vuajnë nga dy faktorë shtesë: (1) mekanizmat dhe kriteret e identifikimit nuk janë konsistente dhe e bëjnë të vështirë bashkëpunimin përmes kufijve për identifikimin e rasteve dhe (2) kriteret e identifikimit nuk "ndjekin ritmin me qëndrimet e trafikantëve" dhe aftësinë e trafikantëve për t'u përshtatur menjëherë" në përgjigje ndaj ligjeve dhe politikave të reja, përshtatjet që përparojnë më shpejt sesa masat e aktorëve kundër trafikimit", sipas një informatori (diskutuar më poshtë në Seksionin 3.5) (Brunovskis 2007).

Mekanizmat e identifikimit tregojnë disa dobësi, përfshirë mbështetjen e tepruar tek policia, mospërputhje në përkufizim dhe kufizime institucionale.

Në rajon, policia është aktori kryesor në identifikimin e rasteve të trafikimit. Edhe pse disa aktorë lejojnë që në identifikim të marrin pjesë sektorë të tjerë, kjo nuk ndodh shpesh në praktikë. Në veçanti, informatorët në rajon theksojnë mungesën e vëmendjes nga inspektorët e punës ndaj çështjes së trafikimit (shihni gjetjen vijuese).

Përveç mospërfshirjes së inspektorëve të punës, informatorët vërejnë disa kufizime institucionale për identifikimin e rasteve të TP. Burime të shumta shprehin mendimin që shkeljet e hapura të legjislacioneve të punës, situata të punësimit të parregullt, mashtrimit dhe zhgënjimit nga raste të shfrytëzimit për punë dhe trafikimit për punë të detyruar paraqesin sfida praktike për prokurorët, policët dhe inspektorët e punës në mbarë rajonin. Interpretimet e ndryshme të kuptimit, pengojnë më tej bashkëpunimin ndërkombëtar: për shembull, ajo që në një vend konsiderohet trafikim, në një tjetër është "thjesht" shkelje e legjislacionit të punës. Siç vëren një raport (ICPMD 2013), e drejta ndërkombëtare parashikon orientim të kufizuar në këtë fushë. Për shembull, përkufizimi i trafikimit për punë që përmban Protokolli i Palermos, në shumë vende është përkthyer në legjislacionin kombëtar të tyre, pa shpjegim të mëtejshëm, dhe le vend për interpretim. E njëjta gjë vlen edhe për përkufizimin e punës së detyruar të përkufizuar në Konventës e ILO-s për Punën e Detyruar, 1930 (nr 29).[17]

Një tjetër çështje e rëndësishme e identifikuar nga aktorët është pasoja e ndryshimit të stafit, sidomos në identifikimin e rasteve. Një informator kyç nga

17 Konventa (Nr. 29) në lidhje me Punën e Detyruar, miratuar më 28 qershor 1930 nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në sesionin e saj të katërmbëdhjetë, hyrë në fuqi më 1 maj 1932, në përputhje me nenin 28

BH për shembull vëren që të gjitha agjencitë dhe institucionet të cilat reagojnë ndaj trafikimit kanë marrë udhëzime për identifikimin e rasteve të trafikimit, janë trajnuar për përdorimin e tyre dhe aplikimin dhe tani duhet që t'i përdorin ato. Ristrukturimi i shpeshtë brenda agjencive dhe ndryshimi i stafit ka çuar në ndërprerjen e aplikimit dhe trajnimit në lidhje me këto udhëzime. Po kështu, të dhënat e studimit (informatorët dhe dokumentet) tregojnë që ndryshimi i stafit dhe mos-trajnimi i stafit përbëjnë një pengesë të madhe ndaj identifikimit të vazhdueshëm të rasteve në Shqipëri (KKSKT, 2011).

Mospërfshirja e inspektorëve të punës në procesin e identifikimit dhe përjashtimi i shfrytëzimit për punë nga përkufizimet e TP janë pengesa kryesore për identifikimin e rasteve dhe reagimin e plotë ndaj TP.

Në rajon, policia është aktori kryesor përgjegjës për identifikimin e rasteve të trafikimit. Edhe pse në disa vende identifikimi bëhet nga sektorë të tjerë, në praktikë, shumë pak të tjerë marrin pjesë. Të dhënat e studimit tregojnë që ky është problem i veçantë mes inspektorëve të punës që nuk janë të trajnuar dhe që priren të mos i kushtojnë vëmendje identifikimit të personave që mund të kenë qene objekt trafikimi.

Njëkohësisht, informatorët pranojnë që inspektorët e punës kanë një rol të rëndësishëm në identifikimin e rasteve të trafikimit. Inspektorët e punës kanë aksesin më të rregullt dhe të lehtë në vendet e punës gjerësisht për shkak se "parregullsitë në kontratat e punës të migrantëve përfaqësojnë numrin më të madh të vizitave dhe sanksioneve të inspektimit në raportet vjetore të shumicës së inspektorateve" (OSBE, 2011). Në praktikë, informatorët në rajon vërejnë mungesën e dukshme të inspektorëve të punës në procedurat e identifikimit dhe mungesën e trajnimit dhe kapacitetit mes inspektorateve të punës për të identifikuar raste të trafikimit.

Marrëdhënia sipas përkufizimit ndërmjet trafikimit të personave dhe trafikimit për shfrytëzimin për punë ka paraqitur tjetër pengesë për reagimin ndaj trafikimit në rajon. Ndërsa mes dy termave nuk ka dallim funksional, protokolli i Palermos, i cili në shumë vende është përkthyer në legjislacionin kombëtar të tyre, nuk jep orientim të qartë për mënyrën e të kuptuarit të dallimit apo ngjashmërive mes dy termave (ICMPD, 2013). Burime të shumta shprehin mendimin që shkeljet e dallueshme të legjislacioneve të punës, situata të punësimit të parregullt, mashtrimit dhe zhgënjimit nga raste të shfrytëzimit për punë dhe trafikimit për punë të detyruar paraqesin sfida praktike për prokurorët, policët dhe inspektorët e punës në mbarë rajonin. Përkufizimet e mësipërme të ndryshme operacionale pengojnë bashkëpunimin. Në përgjigje të kësaj, informatorët nuk bëjnë thirrje për një përkufizim të unifikuar në vetvete, por vënë në dukje rëndësinë e përfshirjes së inspektorëve të punës në proceset e identifikimit, forcimin e kapaciteteve të tyre për të dalluar shfrytëzimin dhe ofrimin e orientimit të qartë për mënyrën e reagimit ndaj rasteve të trafikimit dhe shfrytëzimit kur hasen me to.

3.3 Mbështetje dhe shërbime

Në këtë seksion japim gjetjet në lidhje me mbrojtjen dhe ndihmën në rastet e trafikimit. Gjetjet fokusohen në çështje që lindin në mbarë rajonin dhe burime të dhënash të ndryshme dhe me vendndodhje të ndryshme. Ne fokusohemi së pari në ofrimin e përgjithshëm të ndihmës për rastet, ndjekur nga diskutimi i katër çështjeve specifike: mundësia e një periudhe reflektimi; dhënia e në dëmshpërblimit; dallimet në ofrimin e shërbimeve dhe cilësia për grupe të ndryshme.

Ndihma për viktimat është kryesisht me bazë në strehëza dhe organizohet nga OJQ. Asnjë vend nuk ka një strehëz të posaçme për fëmijët ose burrat që kanë qenë objekt trafikimi.

Në rajon, mbështetja ndaj viktimave ka disa karakteristika kryesore- OJQ ofrojnë mbështetje të jashtme në formën e strehëzave dhe vetëm për gratë dhe fëmijët. OJQ, dhe jo qeveria, ofrojnë akses ose referim në pothuajse të gjitha shërbimet që janë në dispozicion për viktimat e trafikimit. Disa strehëza i dedikohen viktimave të trafikimit, ndërsa të tjera mbështetjes për grup më të gjerë të synuar. Fillimisht të financuara nga donatorë të jashtëm me pak përjashtime kryesore, strehëzat janë të ndryshme në llojin e shërbimeve që ofrojnë duke variuar nga akomodimi tek ndihma dhe mbrojtja në shërbime dhe ri-integrimi. Bosnja ofron numrin më të madh të strehëzave, ndërsa Shqipëria ofron gamën me të madhe të shërbimeve. Megjithatë, rajonit i mungon një strehëz vetëm për ofrimin e ndihmës për meshkujt, viktima të trafikimit.

Informatorët në mbarë rajonin raportuan disponueshmërinë e mbështetjes dhe shërbimeve për viktimat e trafikimit nëpërmjet strehëzave të drejtuara nga OJQ. Sipas raportit GRETA 2013 të BH, që në vitin 2010 qeveria ka financuar dy OJQ që të drejtojnë strehëzat për personat që kanë qenë objekt trafikimi dhe dy OJQ të tjera që të ofrojnë ndihmë jashtë strehëzave. Në Shqipëri, ndihma për viktimat ofrohet kryesisht nëpërmjet katër strehëzave të posaçme për viktimat e trafikimit, një e drejtuar nga Shteti dhe tre të tjera nga OJQ. Të gjitha këto ambiente janë pjesë e Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Ndihma ofrohet falas dhe përfshin formimin profesional, ndihmën për të gjetur punë dhe skemën e mikro kredisë që ndihmon viktimat për të filluar ndonjë biznes. Viktimave u jepet mundësia e strehimit edhe pse viktimat për të cilët ka probleme me sigurinë, inkurajohen të hyjnë në Qendrën Kombëtare të Pritjes (QKP) të drejtuar nga shteti, ku niveli i sigurisë është më i lartë. OJQ-të e Serbisë ofrojnë strehim, akomodim, akses në dokumente personale, ndihmë mjekësore dhe psiko-sociale dhe ndihmë juridike, sipas disponueshmërisë së fondeve (Balkan Act Now 2013). Dy strehëza në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë ofrojnë akomodim dhe shërbime të ofruara nga OJQ për viktimat e trafikimit – viktima të brendshme dhe të huaja (Balkan Act Now 2013). Mali i Zi ka një strehëz të specializuar për viktimat e trafikimit, e cila ofron ushqim, veshje, artikuj për higjienën personale dhe medikamente (GRETA

2012). Këto strehëza mbështeten më shumë nga donatorë të huaj, me përjashtim të Shqipërisë, Malit të Zi, dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë që kanë strehëza të cilat të paktën pjesërisht financohen nga shteti. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, shteti ofron gjithashtu grante të vogla, vjetore, për pesë OJQ me qëllim që të mbështesë pjesërisht veprimtaritë e tyre të strehimit.

Periudha e reflektimit dhe lejet e përkohshme të qëndrimit u jepen viktimave, por shpesh vetëm nëse ato bashkëpunojnë me autoritetet.

Pothuajse në gjysmën e vendeve pjesëmarrësve, viktimave të huajave të trafikimit u jepet një periudhë reflektimi dhe leje e përkohshme qëndrimi, gjatë të cilës ata mund të konsiderojnë ngritjen e akuzave kundër trafikantëve. Në shumë raste, qeveritë nxisin viktimat të bashkëpunojnë me autoritetet në hetimin dhe ndjekjen e trafikantëve të tyre përpara se të fitojnë akses në shërbime. Për shembull, Shqipëria jep leje të përkohshme qëndrimi për të gjitha rastet e mundshme të trafikimit për një periudhë nga tre muaj deri në një vit, me mundësi përsëritjeje. Leja jepet pavarësisht vullnetit të tyre për të bashkëpunuar me autoritetet. Ligji përcakton që një i huaj nuk duhet të largohet nga territori përpara se të intervistohet nga policia ose prokurori, të ekzaminohet nga një ekip i përzgjedhjes paraprake, t'i jepet akses në shërbimet sociale dhe t'i jepet mundësia për të kërkuar qëndrim të përkohshëm. Në Malin e Zi, ligji për të huajt jep leje të përkohshme qëndrimi për arsye humanitare për një shtetas të huaj që ka qenë objekt i trafikimit. Leja e qëndrimit jepet për një periudhë nga tre muaj deri në një vit. Ligji nuk kërkon që personat të bashkëpunojnë për hetimin dhe ndjekjen e trafikantëve të tyre për të kërkuar dhënien e lejes së qëndrimit (GRETA, 2012). Në BH, rastet e huaja të trafikimit marrin një periudhë reflektimi 30-ditore përpara kthimit (OSBE, 2012). Nëse përcaktohet një viktimë trafikimi dhe nëse depozitohet një çështje penale, ata kanë të drejtë për leje qëndrimi për arsye humanitare për një periudhë deri në gjashtë muaj për qëllim mbrojtjeje, rekuperimi dhe kthimi në vendin e origjinës. Megjithatë, të dhëna të tjera të studimit, kanë treguar që "në praktikë, leja e përkohshme qëndrimi i jepet vetëm viktimave të trafikimit që identifikohen si të tilla në kuadër të përkufizimit të së drejtës penale" (GRETA, 2013 BH). Me fjalë të tjera, dhënia e lejes së përkohshme të qëndrimit, varet nga fillimi i një procedimi penal për veprën e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbi dhe Kosovë, autoritetet aplikojnë një praktikë më strikte duke nxitur viktimat që të marrin pjesë në hetim dhe ndjekje të trafikantëve të tyre përpara se të kenë një periudhë reflektimi dhe leje qëndrimi. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, për shembull, dhënia e një leje të përkohshme qëndrimi është e kushtëzuar dhe varet nga bashkëpunimi i viktimave me autoritetet (leja jep mundësi për një periudhë reflektimi deri në 60 ditë për raste të huaja dhe 30 ditë për raste vendase, pas të cilës viktimës mund t'i jepet leje e përkohshme qëndrimi për gjashtë muaj; kjo mund të shtyhet në rast të proceseve gjyqësore të vazhdueshme) (Balkan Act Now, 2013). Në Serbi, viktimave të huaja u jepet leje qëndrimi tre mujore pa qenë të detyruara

zyrtarisht që të bashkëpunojnë me agjencitë e zbatimit të ligjit. Megjithatë, në praktikë, periudha e reflektimit dhe rekuperimit rrallë respektohet dhe "në më shumë se një rast, viktimat e trafikimit i nënshtrohen presionit direkt ose indirekt për të dëshmuar në gjykatë" (Balkan Act Now, 2013). Në fakt, informatorët serb vërejnë që ata që kanë qenë objekt trafikimi tani nuk lejohen që të refuzojnë bashkëpunimin me agjenci të zbatimit të ligjit dhe të dëshmojnë në procese gjyqësore. Sipas Procedurave Standarde të Punës (2008) në Kosovë personat që kanë qenë objekt trafikimi duhet t'u ofrohet periudha e reflektimit me qëllim që t'u jepet kohë të marrin veten dhe të stabilizohen përpara se të përcaktohet se çfarë do të bëjnë më pas. Periudha e reflektimit duhet t'i jepet çdo personi që dyshohet se është viktimë e trafikimit, pavarësisht dëshirës së tij për të bashkëpunuar si dëshmitar dhe pavarësisht faktit nëse autorët e veprës penale ndiqen penalisht apo jo. Dhënia e lejes së përkohshme të qëndrimit duhet të vijojë nga periudha e reflektimit. Megjithatë, në praktikë, vetëm ata që dëshmojnë janë pajisur me leje të përkohshme qëndrimi; në të kundërt, ata deportohen.

Kështu, ndërsa në rajon jepet periudha e reflektimit dhe rekuperimit dhe leja e përkohshme e qëndrimit, shumë vende nxisin personat të bashkëpunojnë me autoritetet me qëllim që të kenë këto të drejta. Ky lloj detyrimi nuk respekton standardet e njohura dhe konventat ku janë palë nënshkruese vendet e Ballkanit Perëndimor.[18]

> *Dëmshpërblim është dhënë në pak raste, ose nga trafikantët ose nga shteti, me sa duket për shkak të procedurave komplekse ose jo-funksionale, mungesa e mbështetjes ligjore dhe në disa raste, mos-inkurajimi aktiv nga autoritetet.*

Në rajon, ka pasur pak raste të dokumentuara të viktimave të trafikimit që aktualisht marrin dëmshpërblim ose nga trafikantët ose shteti (i ndryshëm nga dhënia e dëmshpërblimit). Edhe pse të gjitha juridiksionet kodifikojnë dëmshpërblimin e viktimave si praktikë ligjore, të dhënat e studimit identifikojnë pengesa të mëdha për dhënien e tij. Në veçanti, shumë vende tregojnë se kanë procedura jo funksionale dhe tepër komplekse për të kërkuar dëmshpërblim, nuk kanë mbështetje ligjore për viktimat që të kërkojnë dëmshpërblim dhe në disa raste, autoritetet duket se në mënyrë aktive nuk i inkurajojnë viktimat që të kërkojnë dëmshpërblim.

Të dhënat e studimit tregojnë sfida specifike me procedurat e dëmshpërblimit të viktimave dhe mbështetjen në Shqipëri, Bosnjë dhe Serbi. Aktualisht Shqipëria ka disa dispozita ligjore që kodifikojnë të drejtën e viktimave të trafikimit për dëmshpërblim. Megjithatë këto ligje kërkojnë që viktimat të kërkojnë dëmshpërblim pavarësisht procedimit penal kundër trafikantëve; as shteti as OJQ nuk ofron mbështetje për viktimat që të marrin dëmshpërblim. Madje, dhe ndoshta, të dhënat e studimit sugjerojnë që viktimave t'u kërkohet

18 Konventë e Këshillit të Europës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005, nenet 13-14

të financojnë vetë padinë civile dhe ato duhet të paguajnë në shtet një përqind të dëmshpërblimit. Në një rast të fundit, gjykata i dha viktimës së trafikimit 40 000 euro dëmshpërblim, por ajo nuk mund të merrte këto para sepse nuk mund të paguante tarifën gjyqësore.

BH dhe Serbia gjithashtu kanë krijuar pengesa të mëdha për dëmshpërblimin civil për trafikimin. BH i jep viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim nga trafikantët gjatë procedimit penal. Raportet tregojnë që "këto pretendime në praktikë nuk inkurajohen, sepse shqyrtimi i tyre do të vononte dhënien e vendimit për rastin e trafikimit të qenieve njerëzore. Megjithatë, në praktikë, shumë pak viktima e kërkojnë për shkak të zgjatjes së procedimit civil dhe faktit që barra e provës se dëmit bie mbi viktimën. Sipas përfaqësuesve të gjyqësorit, legjislacionit aktual nuk jep mundësitë e mjaftueshme për të vendosur për dëmshpërblimin e viktimave nga autorët në procedim penal. Në Serbi, vendimi i parë që i dha dëmshpërblimin një viktime trafikimi u dha vetëm së fundmi (shkurt 2014). Për të marrë dëmshpërblim, viktima u nxit që të dëshmonte kundër trafikantëve, që e kishin shfrytëzuar seksualisht për disa vjet, në gjykim penal që zgjati katër vjet. I gjithë procesi kërkoi më shumë se shtatë vjet, duke shkaktuar një barrë tepër të madhe mbi viktimën në formën e traumës dhe kohës.[19]

Siç sugjerohet nga këto shembuj, mekanizmat aktual të dëmshpërblimit nuk mbështesin të drejtat e viktimave për të kërkuar dhe për të marrë dëmshpërblim për shfrytëzimin e tyre. Këto procese të paefektshme duket se nuk e kanë inkurajuar viktimën që të kërkojë të drejtat e saj dhe mjetet e nevojshme për t'u zhdëmtuar për shfrytëzimin e tyre.

Rajoni ofron mbështetje dhe shërbime për personat e trafikuar. Cilësia dhe gama e këtyre shërbimeve varion me llojin e trafikimit të përjetuar-të brendshëm, ndërkombëtar dhe sektorin e punës.

Në sondazh, aktorët kanë identifikuar llojet kryesore të mbështetjes dhe shërbimeve në dispozicion për ata që kanë qenë objekt trafikimi në rajon. Këto kryesisht përfshijnë vlerësime të plota ose disi të përshtatshme të riskut (70 përqind), kujdes mjekësor (73 përqind) dhe shërbime psiko-sociale (76 përqind) (Tabela 5).

19 Burimi: Komiteti Holandez i Helsinkit: http://www.nhc.nl/en/news/First_Judgment_Awarding_Compensation_for_A_Victim_of_Trafficking_in_Serbia_Issued_and_Executed.html?id=225

Tabela 5: Shërbimet mbështetëse që ofrohen në Rajon (në përqindje)

	Plotësisht mjaftueshëm	Disi mjaftueshëm	Mjaftueshëm vetëm për disa grupe	Pamjaftue-shëm	Tërësisht pamja -ftueshëm	Nuk e di
Strehëz afatshkurtër	34.7	24.5	20.4	4.1	2.0	14.3
Strehëz ose strehim afatgjatë	30.6	22.8	19.2	6.2	2.1	19.2
Kujdes mjekësor	31.6	41.8	12.2	9.2	0.0	5.1
Shërbime psiko-sociale	41.8	34.7	15.3	3.1	0.0	5.1
Vlerësim i riskut	33.0	37.1	14.4	10.3	1.0	4.1
Mbështetje ligjore (civile ose penale)	27.3	34.0	13.4	12.9	5.7	6.7
Mbështetje punësimi	10.8	32.6	24.0	14.9	2.4	15.3
Kthim dhe/ose riintegrim	28.0	34.2	14.0	6.7	2.6	14.5
Rivendosje ose integrim	18.5	20.5	13.8	15.4	4.1	27.7

Burimi: Sondazh i Aktorëve (Vlerësimi i IOM-së për Nevojat në BP, 2014)
Shënime: Tabela tregon përqindjet sipas rreshtave; në çdo rresht shuma është 100 përqind. Të dhënat e munguara nuk janë përfshirë në llogaritjen e përqindjes.

Është e dukshme që në shumicën e llojeve të mbështetjes, sidomos strehëza afatshkurtër dhe afatgjata dhe mbështetje për punësim, një e pesta deri në një e treta e të intervistuarve i shohin këto shërbime të mjaftueshme vetëm për disa grupe. Aktorët më shpesh kanë identifikuar mbështetjen ligjore (19 përqind), mbështetjen për punësim (17 përqind), dhe rivendosjen ose integrim si të pamjaftueshme ose tërësisht të pamjaftueshme (20 përqind).

E rëndësishme dhe më pak e diskutuar në të dhënat e intervistës dhe dokumente është çështja e marrëdhënies ndërmjet shërbimeve në dispozicion dhe ndikimit në vet-identifikim. 38 përqind e të intervistuarve raportojnë që lloji dhe cilësia e ndihmës i pengon disa persona që ta kërkojnë (Tabela 6).

Tabela 6: Gama dhe cilësia e shërbimeve mbështetëse në dispozicion të VT (në përqindje)

	Jam tërësisht kundër	Kundër	As dakord as kundër	Dakord	Shumë dakord	Nuk e di/ NA
Gamë më e vogël shërbimesh për VT të huaj sesa për VT vendas	14.3	44.9	15.3	17.3	1.0	7.1
Cilësi më e ulët e shërbimeve në dispozicion të VT të huaj sesa VT vendas	18.6	50.5	15.5	6.2	1.0	8.2
Shërbimet e mbështetjes të projektuara për fëmijët VT	6.2	18.6	21.6	42.3	8.2	3.1
Lloji ose cilësia e ndihmës pengon disa VT që ta kërkojnë	6.3	17.9	20.0	35.8	2.1	17.9
Shërbimet e mbështetjes të projektuara për nevojat e VT femra dhe meshkuj	6.3	26.0	18.8	38.5	2.1	8.3

Burimi: Sondazh i Aktorëve (Vlerësimi i IOM-së për Nevojat në BP, 2014)
Shënime: Tabela tregon përqindjet sipas rreshtave; në çdo rresht shuma është 100 përqind. Të dhënat e munguara nuk janë përfshirë në llogaritjen e përqindjes.

Vlerësimi i nevojave gjithashtu ka identifikuar shembuj në rajon të trajtimit të ndryshëm për viktimat e trafikimit. Më shpesh, dhe siç diskutohet, mungon mbështetje për viktimat e trafikimit për punë, viktimat meshkuj, në veçanti. Megjithatë të dhënat e studimit tregojnë që shumica e aktorëve bie dakord ose bie dakord plotësisht që ka shërbime mbështetëse si për meshkuj ashtu edhe për femra (41 përqind). Kjo është një kontradiktë e rëndësishme për t'u vërejtur në përcaktimin e hapave të tjera.

Tabela 7: Gama dhe cilësia e shërbimeve që ofrohen për rastet e trafikimit



Burimi: Sondazh i Aktorëve (Vlerësimi i IOM-së për Nevojat në BP, 2014)

Tabela 7 jep një panoramë të këndvështrimeve të aktorëve për gamën dhe cilësinë e shërbimeve. Të intervistuarit vërejnë që kjo ndryshon sipas organizatës që ofron shërbimet, si edhe llojit të rasteve të identifikuara- fëmijë, gra dhe meshkuj, raste të brendshme ose të jashtme. Kur pyeten për cilësinë e shërbimeve në dispozicion, për shembull, mbi 60 përqind bien dakord ose shumë dakord që cilësia ndryshon sipas organizatës që ofron shërbime për rastin. Mbi 50 përqind vërejnë që ekziston një gamë më e gjerë dhe mbi 40 përqind cilësi më e madhe e shërbimeve në dispozicion të atyre që janë shfrytëzuar në industrinë e seksit sesa të tjerëve në sektorët e punës. Këto të dhëna sugjerojnë një disponueshmëri të ndryshme në gamë dhe cilësi të shërbimeve dhe ndryshimi varet nga organizata që identifikon rastin, që ofron shërbimet dhe/ose lloji i shfrytëzimit.

Të dhënat e intervistës më tej mbështesin variacionet në gamën dhe cilësinë e shërbimeve në dispozicion të qytetarëve kundrejt shtetasve të huaj dhe llojin e agjencisë që identifikon rastin e trafikimit. Kur pyeten për cilësinë dhe gamën e shërbimeve dhe mbështetjes, të intervistuarit nuk bien dakord që gama dhe cilësia e shërbimeve në dispozicion të rasteve të huaja është më e vogël sesa për rastet vendase (Tabela 7). Të dhënat cilësore sugjerojnë që rastet e brendshme kanë akses në më shumë mbështetje sesa të huajat ndërsa në të tjera, ndodh e kundërta. Për shembull, në BH, rastet e huaja nuk fitojnë automatikisht akses në ndihmë sociale ose të drejtën për punë, përfitime këto që i kanë rastet vendase. Si pasojë, rastet e huaja duhet të mbështeten në strehëza dhe shpesh shërbime të kufizuara në strehëza për çdo mbështetje që mund t'ju nevojitet. Madje, në BH viktimat i nënshtrohen të njëjtave rregulla si të gjithë të huajt duke mos ju dhënë mundësinë për "tranzicion të lehtë nga statusi i përkohshëm në qëndrim të

përhershëm dhe duke e vështirësuar riintegrimin e tyre". Kjo inkurajon viktimat për t'u kthyer në vendin e tyre, ku shpesh përballen me të njëjtat kushte që kanë çuar në trafikimin fillestar dhe riskun e trafikimit përsëri ose janë të rrezikuar për dëbim me të mbaruar afati i lejes së përkohshme të qëndrimit (OSBE, 2009). Në Serbi, rastet e huaja nuk mund të kenë akses në ndihmë deri në momentin që marrin leje qëndrimi, procedurë kjo që sipas një informatori është "e gjatë dhe e vështirë dhe...mund të jetë edhe e kushtueshme". Në Kosovë, ndihma për rastet vendore ndryshon sipas bashkisë, sepse nuk ka procedura ose rregulla të standardizuara në mbështetje të kësaj.

Edhe pse në BH, rastet e huaja nuk kanë akses automatikisht në disa shërbime që ofrohen për rastet vendase, disa informatorë mendojnë që ato kanë akses në më shumë ndihmë sesa rastet vendase. Siç shpjegon një informator "viktimat vendase të trafikimit nuk merren shumë seriozisht" ndërsa shumë lloje mbështetjeje janë në dispozicion të rasteve të huaja të trafikimit për shfrytëzim seksual, për të cilin janë krijuar më shumë shërbime mbështetëse për viktimat në BH. Megjithatë në të njëjtën kohë, informatorët vërejnë që "viktimat e trafikimit për shfrytëzimin për punë ose lypje nuk marrin ndonjë lloj ndihme". Kështu, përveç dallimeve në shërbimet në dispozicion për viktimat e huaja kundrejt atyre vendase, variacioni në shërbime shtrihet në llojin e trafikimit.

Të dhënat e studimit sugjerojnë që aksesi në shërbime varion jo vetëm nga lloji i trafikimit dhe vendi, por në disa raste nga institucioni që identifikon rastin. Siç shpjegohet në një raport, shërbimet në dispozicion "synojnë të veprojnë sipas lidhjeve dhe rrjeteve organizative, që përgjithësisht do të thotë se viktimave nuk ju ofrohet gjithmonë gama e plotë e shërbimeve" (ICMPD, 2007). Në Malin e Zi "çdo gjë bëhet në bazë të kontakteve personale" – pra viktimat mund të kenë akses vetëm në ato shërbime ku mund të kenë akses OJQ-të nëpërmjet lidhjeve personale me punonjësit socialë ose mjekët (GRETA, 2012).

Të marra së bashku, të dhënat e studimit sugjerojnë praninë e disa shërbimeve dhe mbështetjeve kryesore, por një panorame më të gjerë të ndryshme ose të pamjaftueshme në dispozicion të viktimave të trafikimit në rajon. Seksioni 3.5 eksploron këndvështrimet e informatorëve për boshllëqet specifike, ndërsa Seksioni 4 raporton prioritetet e aktorëve në lidhje me mënyrën e adresimit të këtyre boshllëqeve.

3.4 Bashkëpunimi mes aktorëve kundër trafikimit

Në këtë seksion, trajtojmë gjetjet e fokusuara tek partneritetet, rrjetet dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve kundër trafikimit në rajon. Këto gjetjet trajtojnë çështje që i përkasin bashkëpunimit formal dhe informal në dhe ndërmjet kufijve në luftën kundër trafikimit të personave përfshirë mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë të referimit. Ato gjithashtu i theksojnë dallimet ndërmjet proceseve të përcaktuara në dokumente dhe reagimet ndaj trafikimit si të operacionalizuara dhe të zbatuara në praktikë.

Pavarësisht shumë proceseve të bashkëpunimit në vend, aktorët nuk shohin zbatimin e këtyre mekanizmave si të plotë ose tërësisht funksional.

Aktorët në rajon kanë krijuar mekanizma- MKR- për të drejtuar bashkëpunimin mes aktorëve qeveritarë dhe jo-qeveritarë në përgjigje të trafikimit. Siç theksohet në Tabelën 4, pothuajse 87 përqind e të intervistuarve e shohin MKR të tyre si pjesërisht ose plotësisht funksional. Megjithatë, në praktikë, këto mekanizma duket se fokusohen pothuajse vetëm në veprimin dhe reagimet ndaj TP për shfrytëzim për qëllime seksuale. Ashtu si me shërbimet e diskutuara më sipër, boshllëqet në bashkëpunim duket se përqendrohen në trafikimin ose forma të tjera të shfrytëzimit për punë, sidomos të dukshme në mungesën e tyre ndërmjet punonjësve të policisë dhe të punës.

Të dhënat e studimit sugjerojnë që vetëm Shqipëria ka një MKR tepër funksional. Shumica e vendeve të tjera kanë raportuar që e kanë krijuar, por nuk zbatojnë, MKR funksional dhe të fuqishëm. Në Shqipëri, autoriteti përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat e trafikimit përbëhet nga përfaqësues të Sektorit të Kufirit dhe Anti-Trafikimit, Drejtoria Konsullore dhe Drejtoria e Shërbimit Social. Autoriteti përgjegjës koordinon procesin e referimit për ndihmën fillestare dhe mbrojtjen dhe rehabilitimin afatgjatë të të gjitha viktimave të trafikimit. Sipas raporteve dhe informatorëve të studimit, në disa fusha, për shembull, në BH dhe Serbi (GRETA, 2013, BH dhe Serbi), përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse janë pjesë gjithashtu e një MKR të gjerë aktiv në nivel komuniteti, që përfshin edhe komitetet rajonale dhe rrjetet lokale të krijuara për të përmirësuar identifikimin, mbrojtjen, ndihmën dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit]. Shumë informatorë përshkruajnë MKR të Shqipërisë si "shembull të mirë dhe funksional. Ka komunikim të mirë me shërbimet sociale, ndërmjet qeverive dhe OJQ-ve." Njëkohësisht, një informator vëren që ndërsa MKR përfaqëson "një dokument shumë të mirë", disa aktorë kyç nuk janë të përfshirë aktualisht në identifikimin dhe ndihmën e rasteve të trafikimit, për shembull, inspektorët e punës dhe stafi i mbrojtjes së fëmijëve.

Në BH, Kosovë, Mal të Zi dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, informatorët vërejnë praninë e MKR, por shprehin shqetësim për mungesën e bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve kyç që sipas tyre duhej të përfshiheshin në trajtimin e TP. Për shembull, në BH, Plani Kombëtar i Veprimit për trafikimin përfshin një kuadër për të hartuar dhe koordinuar politikat dhe veprimet e anti-trafikimit. BH ka krijuar një kuadër institucional të përbërë për të hartuar dhe koordinuar politikat dhe veprimin kundër trafikimit, që përfshin një Koordinator Shteti, një grup shtetëror ndërministror, si edhe një Forcë Goditëse dhe ekipe rajonale monitorimi. Sipas dokumenteve të studimit, koordinatorit i shtetit vepron në nivel strategjik të zbatimit të masave të anti-trafikimit, Forca Goditëse ka më shumë rol operativ në hetimin e rasteve specifike dhe ekipet rajonale të monitorimit (të përbëra nga zyra shtetërore dhe prokurorie, agjenci

të zbatimit të ligjit dhe OJQ), janë aktive për veprimtaritë e anti-trafikimit në nivel vendor (OSBE, 2012). Raporti i GRETA 2013 BH thekson mangësitë në MKR aktual për shkak se organet e zbatimit të ligjit krijojnë pengesa në identifikimin e rasteve dhe aksesin në ndihmë. Madje, burimet dhe kompetencat e Koordinatorit të Shtetit janë të kufizuara në lehtësimin e bashkëpunimit dhe ndarjen e informacionit mes aktorëve kyç. Një informator përshkruan bashkëpunimin ndërmjet agjencive, ndërmjet OJQ-ve dhe agjencive qeveritare si një "rrjet i kontakteve informale" ndërmjet aktorëve që janë përfshirë në trafikim për shumë vjet, dhe jo si një sistem plotësisht funksional bashkëpunimi.

MKR i Kosovës përfshin SOP që përcaktojnë rolin dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve kundër trafikimit, përfshirë ngarkimin e zyrës së Koordinatorit Kombëtar me koordinimin e të gjithë aktorëve. Informatorë të ndryshëm tregojnë që besojnë se duhet të ketë koordinim më të mirë mes aktorëve kryesorë për identifikim dhe referim, sidomos në nivel lokal.

Mali i Zi ka një strukturë MKR që mbështet bashkëpunimin e një sërë aktorësh kyç, por, sipas disa informatorëve, zbatimi i saj ka qenë "i paqëndrueshëm". Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit drejton përpjekjet kombëtare kundër TP. Zyra vepron brenda Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Malit të Zi (direktivë e shtetit dalë në 18.04.2013) dhe është përgjegjëse për koordinimin e veprimtarive të organeve kompetente shtetërore, institucioneve ndërkombëtare dhe OJQ-ve në zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planeve të Veprimit. Zyra zbaton "Marrëveshje Bashkëpunimi" që vepron si mekanizëm kombëtar referimi që përfshin përfaqësuesit e Gjykatës së Lartë, Prokurorisë dhe ministritë përkatëse (të brendshme, të shëndetësisë, të arsimit, të punës dhe mbrojtjes sociale). (Strategjia Kombëtare, 2012). Zyra e Koordinatorit Kombëtar ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me OJQ-të që ofrojnë shërbime për personat të cilët kanë qenë objekt trafikimi (Strategjia Kombëtare, 2012). Si informatorët e qeverisë ashtu edhe ata jo të qeverisë sugjerojnë që ka boshllëqe në funksionin e MKR, si në Kosovë, sidomos në nivel bashkiak. Informatorët njësoj identifikojnë MKR të qartë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë të cilët kanë disa "mangësi operacionale", si mos të kuptuarit e treguesve të trafikimit të përdorur për të identifikuar rastet dhe, ashtu si një Kosovë dhe Mal të Zi, mungesë të zbatimit të MKR në nivel lokal, komuniteti.

Zbatimi së fundi i MKR në Serbi nëpërmjet Agjencisë për Koordinimin e Mbrojtjes së Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore ka treguar mundësi për realizimin e nivelit të lartë të operacionalizimit. Agjencia kontrollon identifikimin e rasteve të trafikimit, konfirmon rastet e identifikimit të trafikimit nga policia, vlerëson nevojat e viktimave dhe koordinon ndihmën për ata. Në vitin 2012, Agjencia u bë Qendër për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore si pjesë e një reforme të vazhdueshme të sistemit serb të mbrojtjes sociale dhe planeve për të përfshirë një strehëz emergjence në funksionin e MKR. Si një strukturë e re e MKR, ajo zhvillon akoma procedura, protokolle dhe standarde pune, por "disa përmirësime janë tashmë të dukshme. Për shembull, e gjithë puna

e qendrës është transparente dhe e dukshme në faqen e saj të internetit, me informacionin e përmuajshëm për numrin e personave të identifikuar si viktima, numrin e personave që nuk janë identifikuar si viktima (viktima të mundshme që u identifikuan fillimisht, por nuk plotësonin kriteret për identifikim përfundimtar) dhe demografinë e tyre" (GRETA, 2013 BH). Kështu, mjetet e koordinimit të reagimit të aktorëve ndaj trafikimit në Serbi janë premtuese.

Ndërsa struktura e re e Serbisë sugjeron mundësinë për MKR të efektshme, shumë informatorë përshkruajnë boshllëqe të rëndësishme në koordinimin e aktorëve dhe agjencive në përgjigje të trafikimit në çdo vend. Të dhënat e sondazhit sugjerojnë nivel të lartë operacionalizimi, ku shumë aktorë kyç përfshihen në identifikimin e rasteve të trafikimit dhe dhënien e mbështetjes së nevojshme. Në zbatimin e tyre duket se MKR dhe mekanizma të tjerë nuk koordinojnë të gjithë aktorët dhe të gjitha nivelet si duhet; kështu sugjerohen boshllëqet kryesore për të siguruar një reagim të plotë dhe funksional ndaj trafikimit (shihni Seksionin 3.5).

Ndërsa janë lidhur një sërë marrëveshjes rajonale dhe dypalëshe kundër trafikimit, shumë prej tyre nuk i lejojnë aktorët përkatës që të mbështeten në rrjete informale për të koordinuar reagimin ndërkufitar ndaj trafikimit.

Në Ballkanin Perëndimor, qeveritë dhe aktorët e tjerë kanë krijuar disa struktura për të koordinuar dhe siguruar bashkëpunimin e efektshëm ndërkufitar në përgjigje të trafikimit. Këto përfshijnë një Mekanizëm Ndërkombëtar Referimi (MNR) si edhe disa marrëveshje për zbatimin e ligjit, sidomos Konventa e Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore e vitit 2008 dhe Qendra e Europës Juglindore për Zbatimin e Ligjit (SELEC) (ICMPD, 2012). Një platformë më e gjerë e bashkëpunimit rajonal në lidhje me TP është Strategjia e BE-së për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, që përfshin bashkëpunimin në fushën e vizave, azilit dhe migracionit.[20]

Një sërë aktorësh rajonalë dhe ndërkombëtarë kanë zhvilluar një MKR për Ballkanin Perëndimor në vitin 2009. Qëllimi i këtij mekanizmi ishte të mbështeste identifikimin e duhur ndërkufitar të rasteve të trafikimit, si edhe të siguronte ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës së duhur. Palët në MKR përfshinin dhjetë qeveri, që morën pjesë në nismë dhe zbatuan parashikimet e projektit e ICMPD (ICMPD, 2012). Siç diskutohet më sipër, të dhënat e sondazhit tregojnë që të intervistuarit besojnë se MKR është plotësisht ose pjesërisht funksional. Megjithatë, të dhëna cilësore në këto vende dhe llojet e informatorëve tregojnë që këto palë në MKR rajonal nuk e shohin atë si funksional. Informatorët vërejnë që ndryshimi i stafit të përfshirë në zhvillimin e zbatimin e MKR ka penguar zbatimin. Siç sugjeron një informator, "duket që shpesh personat dalin në pension ose lëvizin pa njoftuar dhe

20 Udhëzime për Menaxhimin e Integruar të Kufirit në Ballkanin Perëndimor, http://www.eulex-Kosovo.eu/training/police/PoliceTraining/BORDER_BOUNDARY/DOCUMENTS/6.pdf?page=agreements

kështu pikat e kontaktit që janë krijuar, nuk janë më funksionale." Kjo sugjeron që ndërsa palët kyçe kanë rënë dakord për të marrë pjesë në MKR, këtyre proceseve ju mungon institucionalizimi i nevojshëm për të siguruar funksionimin dhe tranzicionin normal përtej stafit të veçantë. Pa institucionalizim, MKR nuk mund të funksionojnë, as të sigurojnë reagim të qëndrueshëm ndaj rasteve të trafikimit në rajon.

Kundrejt këtij sfondi të një marrëveshjeve formale ekzistuese por jo mjaftueshëm të përdorur, aktorëve kyç sidomos OJQ-ve u është dashur të zhvillojnë rrjetet informale të bashkëpunimit për të siguruar reagimin e duhur ndaj rasteve të trafikimit. Informatorët theksuan që ata duhej të bazoheshin në kontaktet e tyre personale dhe partnerët e njohur për të siguruar mbështetje për rastet e trafikimit, sidomos për raste që kërkojnë riatdhesim dhe mbështetje për riintegrim. Në nivel rajonal, informatorë të shumë përmendën ekzistencën e një rrjeti informal bashkëpunimi sidomos ndërmjet OJQ-ve. Këto rrjete informale duket se ishin më të rëndësishme në raste të riatdhesimit dhe mbështetjes për riintegrim. Gjithashtu, ato shkëmbejnë informacion dhe të dhëna për çështje të tjera që zhvillojnë njohuritë dhe kapacitetin kërkimor. Një informator shpjegoi që "bashkëpunimi i OJQ-ve funksionon më mirë në nivel rajonal sesa në nivel kombëtar". Një tjetër informator shpjegoi që "OJQ-të që punojnë për TP kanë marrëdhënie të mira në Ballkan – Fondacioni King Baudouin ka mbështetur forcimin e mbështetjes së viktimave dhe mundësive të tyre për t'u takuar, diskutuar çështjet që ngrihen dhe shkëmbyer praktikat rajonale". Disa informatorë konfirmojnë që OJQ-të e rajonit mblidhen rregullisht dhe zhvillojnë marrëdhënie bashkëpunimi në nivel rajonal që bën të mundur që ato të zhvillojnë llojet e rrjeteve informale të nevojshme për të ndihmuar personat që kanë qenë objekt trafikimi. Bashkëpunimi rajonal i OJQ-ve të përfshira në TP është mbështetur gjithashtu nëpërmjet projekteve të BE-së në vitin 2011-2013. Kjo sugjeron që këto rrjete informale dhe reagime më të plota ndodhin jashtë rrugëve qeveritare. Duket se boshllëqet ndërkufitare mund të jenë më urgjente si ndërmjet qeverive ashtu dhe ndërmjet llojeve të ndryshme të aktorëve (qeveritare kundrejt jo qeveritare).

Në nivel qeveritar shumë vende kanë marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi për zbatimin e ligjit. Megjithatë, ekzistenca e këtyre marrëveshjeve nuk ka siguruar zbatimin e tyre. Për shembull, shumë informatorë shpjegojnë që pavarësisht marrëveshjeve ekzistuese dypalëshe, informacioni për rastet e trafikimit me origjinë nga Ballkani Perëndimor është i vështirë që të sigurohet nëpërmjet rrugëve zyrtare. Në praktikë, kjo sugjeron që ekzistenca e këtyre marrëveshjeve nuk siguron domosdoshmërisht bashkëpunim në nivel operacional.

Gjithashtu ka disa marrëveshje dypalëshe që fokusohen në aspekte ligjore të bashkëpunimit policor të nënshkruara ndërmjet Shqipërisë, Bullgarisë, Kroacisë dhe Bosnjë Hercegovinës me Serbinë në vitin 2010 (Scarabelli, 2014). Konventa e Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (KBP EJL) ka avancuar bashkëpunimin dypalësh nëpërmjet nënshkrimit të një sërë marrëveshjesh

dypalëshe me anëtarët e KBP EJL.[21]Marrëveshjet dypalëshe të zbatimit të ligjit përfshijnë rregullime me Bashkimin Europian, Turqinë, Egjiptin, Federatën Ruse dhe Zvicrën.[22]Gjithashtu për TP ka dhe një sërë marrëveshjesh specifike. Disa nga marrëveshjet më funksionale përfshijnë Dialogut e Partneritetit për Migracionin me Zvicrën. Zvicra ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi për zbatimin e partneriteteve për migracionin me BH, Serbinë dhe Kosovës..[23]

Informatorët shohin që zbatimi i këtyre marrëveshjeve ka qenë jo konsistent dhe shpesh, ato nuk janë plotësisht funksionale. Shembujt përfshijnë dështimin në identifikimin e fëmijëve shqiptar, viktima të trafikimit në Kosovë dhe Greqi, pavarësisht marrëveshjeve dypalëshe.[24]Informatorët në Serbi dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë konfirmuan që marrëveshjet dypalëshe nuk sigurojnë domosdoshmërisht bashkëpunim operacional në terren. Ato vërejnë vështirësinë për të patur akses në informacion për raste të trafikimit dhe proceset e zgjatura dhe të ngadalta administrative përpara se të mund të aksesojnë ndihmën. Ato përmendin incidente ku personat që kanë qenë objekt trafikimi janë riatdhesuar pa u identifikuar në vendet e destinacionit (për shembull, Belgjikë dhe Francë), si raste të TP. Ashtu si me MKR, duket se ndërsa qeveritë dhe OJQ kanë punuar për të zhvilluar MKR dhe marrëveshje dypalëshe, ato nuk janë plotësisht funksionale në rajon. Mungesa e funksionimit ose funksionimi i pakët i mekanizmave formal të ndarjes së informacionit përbën një boshllëk kryesor në sigurimin e identifikimit, mbrojtjes dhe ndihmës për rastet e trafikimit në dhe nëpërmjet rajonit.

3.5 Boshllëqe në identifikim, referim dhe ndihmë

Në këtë seksion, trajtojmë gjetjet në lidhje me boshllëqet e identifikuara në mekanizmat e identifikimit, mekanizmat e referimit, programet e mbrojtjes dhe ndihmës në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjetjet fokusohen në çështje të tërthorta, të dukshme në shumë vende dhe dokumente dhe informatorë të ndryshëm dhe në situata të ndryshme. Këto gjetje nënvizojnë boshllëqet në lidhje me mekanizmat e identifikimit, zbatimin e ligjeve për të mbrojtur personat e trafikuar, shërbimet mbështetëse dhe të riintegrimit dhe bashkëpunimin ndërmjet aktorëve kundër TP.

Rajonit i mungojnë mekanizmat e efektshme për identifikimin e viktimave të trafikimit në mënyrë të saktë dhe në kohë. Ky boshllëk rezulton në uljen e rasteve të identifikimit të llojeve të ndryshme dhe rasteve të trafikimit.

21 Marrëveshje Zbatimit të KBP EJL, https://www.mvr.bg/en/pcc_see/implementation_agreements.htm

22 KE dhe Republika e Shqipërisë nënshkruan Marrëveshje Ripranimi ndërmjet Shqipërisë dhe KE-së në prill 20053 për të pakësuar migracionin e parregullt për në vendet fqinje.

23 Dialogu i Partneritetit për Migracionin, http://www.sdc.admin.ch/en/Home/Themes/Migration/Migration_dialogue_in_Switzerland

24 Marrëveshje për mbrojtjen dhe ndihmën fëmijët viktima të trafikimit nënshkruar në vitin 2006 ndërmjet qeverisë së Shqipërisë dhe qeverisë Greke, hyrë në fuqi pas ratifikimit nga Greqia në vitin 2008

Në mbarë rajonin, dhe sipas të burimeve të të dhënave, boshllëqet kryesore në reagimin ndaj trafikimit të personave lidhen me identifikimin në kohë dhe të saktë të rasteve të trafikimit. Arsyet për këtë problem janë të shumta dhe mund të përmblidhen për të përfshirë probleme me kuadrin ligjor bazë; mungesën e identifikimit proaktiv në vende ku mund të gjendeshin viktimat; mungesën e përfshirjes së të gjithë sektorëve të nevojshëm; mungesën e kapacitetit të aktorëve kyç shpesh të përkeqësuar nga ndryshimet e stafit; dhe në disa vende, mungesën e dukshme të angazhimit politik.

Femrat viktima të trafikuara për shfrytëzim seksual mbeten grupi më i madh i rasteve të identifikuara pavarësisht asaj që pranohet nga aktorët për ekzistencën e formave të tjera të trafikimit. Raportet, të intervistuarit dhe të dhënat e sondazhit të gjitha theksojnë që "viktimat e formave të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore nuk identifikohen si duhet" dhe që këto përfshijnë viktimat meshkuj; viktimat e trafikimit për punë; fëmijët e shfrytëzuar sidomos për lypje dhe martesa të detyruara; dhe viktima vendase të trafikimit.

Raportet ekzistuese të organizatave të përcaktuara në mënyrë specifike për të zhvilluar të kuptuarin e MKR dhe MNR vërejnë që mekanizmat e identifikimit për raste të trafikimit fillimisht u zhvilluan në përgjigje të steriotipit të një gruaje të re, të rritur, të trafikuar me forcë, kërcënim ose shtrëngim për shfrytëzim seksual (OSBE, 2007). Përgjigjet e intervistës në rajon sugjerojnë që edhe pse pranohet se trafikimi përfshin një gamë më të gjerë të qëllimeve përfundimtare, kjo akoma duhet të pasqyrohet ose te proceset e përfshira në identifikimin dhe mbështetjen e rasteve të trafikimit ose në të kuptuarin e këtij fenomeni nga gama e gjerë e aktorëve kyç. Si rezultat dhe pavarësisht që kjo është identifikuar si problem që në 2005, shumë aktorë në përgjigje të trafikimit nuk kanë kërkuar që të identifikojnë forma alternative të trafikimit dhe/ose profile të ndryshme të viktimave, në mënyrë proaktive (Surtees 2005a: 497, 513).

Probleme me kuadrin ligjor bazë.

Ka dallime të mëdha në mënyrën e të kuptuarit të konceptit të trafikimit midis aktorëve, një problem i keqësuar nga mospërputhjet në përkufizimin ligjor të TP në mbarë rajonin. Kjo është më e qartë në BH ku trafikimi i personave është përkufizuar ndryshe në katër juridiksione penale. Në Serbi, qeveria nuk ka miratuar një akt të plotë që të synojë luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, që do të përfshinte masat për të siguruar ndihmë sociale për viktimat e trafikimit dhe burime për rikuperimin e tyre (ASTRA, 2010). Në Shqipëri, sipas informatorëve, Gjykata e Lartë është shprehur që TP nuk përfshin trafikimin e brendshëm.

Edhe në vendet e përshkruara si të tilla që kanë një kuadër të qëndrueshëm ligjor (si ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi), informatorët vërejnë një gamë çështjesh procedurale që kanë penguar zbatimin e duhur të ligjeve, përfshirë mungesën e përgjithshme të të kuptuarit të TP në sistemin e drejtësisë

penale dhe mungesën e njohurive për proceset e duhura që variojnë nga mungesa e "njohurisë për dokumentet që mund të përdoren gjatë hetimit dhe ndëshkimit të këtyre veprave" 9ASTRA, 2011) deri tek mungesa e njohurive/të kuptuarit të të drejtave të viktimave. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2011-2014 të Kosovës vëren që "vështirësitë kanë të bëjnë me këndvështrime të ndryshme, së pari për ta bërë të dallueshëm ndërmjet ligjit për trafikimin e qenieve njerëzore dhe së dyti për të dënuar autorët gjë kjo që ndodh rrallë dhe së treti mungesa e legjislacionit dhe mekanizmit në mbrojtje të dëshmitarëve dhe viktimave".

Mungesa e identifikimit proaktiv në vende ku mund të gjendet raste trafikimi.

Reagimet mes të gjitha burimeve të të dhënave dhe vendeve vërejnë që nëpunësit e qeverive nuk "ndërmarrin masa proaktive për të zbuluar raste të trafikimit të qenieve njerëzore ne vend" dhe kjo të çon në numrin e ulët të rasteve të identifikuara dhe të raportuara të TP, si edhe në dështimin për t'i dhënë mbështetje sociale personave që kanë qenë objekt trafikimi. Për shembull, sipas shumë informatorëve në Serbi dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë "nuk ka person përgjegjës në procedurën e azilit për identifikimin e viktimave të trafikimit, rajon policisë, qendra të pritjes për azil kërkuesit, seksion për azilin". Informatorët gjithashtu kanë sugjeruar që autoritetet nuk identifikojnë rastet e trafikimit mes të deportuarve dhe migrantëve të parregullt; lypësve; personave që punojnë në zonat me drita të kuqe; dhe sektorë të caktuar të punës në ndërtim dhe tekstile.

Mospërfshirja e të gjithë sektorëve të nevojshëm në identifikim.

Në rajon, shumica e rasteve të identifikimit bazohet në efektivitetin e policisë. Informatorët në rajon identifikuan inspektorët e punës si grupin më të munguar në përpjekjet e identifikimit. Gjithashtu, ndërsa ka pasur përpjekje për të përfshirë aktorë të tjerë (për shembull, punonjës social, mësues dhe punonjës nga sektori i shëndetësisë) këto grupe "rrallë ose asnjëherë nuk kanë raportuar një rast".

Mungesa e kapacitetit mes aktorëve kyç të përfshirë në identifikim.

Një çështje e rëndësishme e theksuar në tërësinë e të dhënave është "kapaciteti i ulët i të gjithë njerëzve që mund të vihen në kontakt me personat që kanë qenë objekt trafikimi dhe për t'i identifikuar ata". Në veçanti, siç kanë thënë informatorë të shumtë në Shqipëri dhe BE "profesionistë të ndryshëm duhet të kenë dijeni për trafikimin e qenieve njerëzore dhe të udhëzohen për të dalluar shenjat e hershme ose personin e trafikuar". Në veçanti, nëpunës shtetërore, punonjës të policisë dhe shërbimeve sociale si edhe organizatat e shoqërisë civile, nuk e dinë dhe duhet të trajnohen për "treguesit parësorë dhe dytësorë që përdoren për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit". Në rajon, informatorët

theksuan konfuzionin e veçantë në fushën e prostitucionit si për shembull akuzat ndaj viktimave të trafikuara për krime në lidhje me punën e seksit. Një pengesë e madhe e identifikuar për rritjen e kapacitetit është ndryshimi i stafit të policisë dhe shërbimeve sociale.

Përpjekjet për forcimin e kapaciteteve duhet të trajtojnë interpretimin nga disa aktorë kyç të modeleve të TP si të bazuara në praktikën tradicionale kulturore. Për shembull, informatorët kyç nga BH dhe raporte të shumta kombëtare dhe rajonale shprehin mendimin që mosveprimi nga autoritetet keqësohet nga besimet kulturore që i atribuojnë lypjen dhe martesat e rregulluara traditave zakonore të disa grupeve të pakicave- sidomos romëve- dhe kështu nuk i konsiderojnë këto praktika si shfrytëzuese. Në BH, delegacioni i GRETA u informua që martesat e detyruara të vajzave adoleshente të popullatës Rome Ashkali dhe Egjiptiane shihen "si pjesë e traditës së tyre" dhe prandaj nuk kërkojnë ndërhyrje nga autoritetet publike. Madje, rastet e trafikimit që përfshijnë fëmijët e detyruar që të lypin shpesh i kthehen prokurorëve me argumentin që prindërit e tyre kanë qenë ata që i kanë detyruar të lypin, kështu që kjo konsiderohet si keq-trajtim dhe jo trafikim (GRETA, 2013, BH).

Është e rëndësishme të theksohet që perspektivat kulturore prekin jo vetëm ata që janë përgjegjës për të reaguar ndaj TP, por edhe viktimat, siç tregohet nga citimi i mëposhtëm në një raport në Serbi:

> *Meshkuj serb trafikohen për shfrytëzim për punë, kryesisht në ndërtim në vende të huaja. Për arsye kulturore dhe patriarkale (meshkujt nuk e pranojnë që janë viktimat), mënyrës së shfrytëzimit (shfrytëzim në industrinë e ndërtimit që shpesh përfshin një numër shumë të madh viktimash) dhe procedurave të paqarta të identifikimit, ndodh shpesh që numri i viktimave që identifikohen është shumë më i vogël se numri aktual (Balkan Act Now, 2013).*

Mungesa e vullnetit politik për të pranuar problemin, për të zhvilluar politikat e duhura dhe për të reaguar plotësisht ndaj TP.

Të dhënat e studimit tregojnë mungesë të vullnetit politik për të pranuar dhe reaguar ndaj trafikimit. Kjo mungesë vullneti politik ka krijuar pengesa ndaj zhvillimit të mekanizmave më të efektshme të identifikimit. Tetë të intervistuar nëpërmjet sondazhit online theksojnë në mënyrë specifike "mungesën e angazhimit për të punuar nga ata që janë përgjegjës për identifikimin". Informatorët theksojnë që ka mungesë shtysash për të patur më shumë vëmendje nga qeveritë për identifikimin e viktimave, ndaj kjo do të rezultonte në (1) nevojën për më shumë burime për mbështetje në një mjedis ku financimi i donatorëve ka mbaruar dhe qeveritë përballen me një gamë të gjerë prioritetesh konkurruese (2) më shumë punë për aktorët e zbatimit të ligjit dhe shërbimeve sociale (3) vlerësim nga poshtë lart të madhësisë së problemit të trafikimit në zonë.

Gjithashtu në lidhje me vullnetin politik, shumica e raporteve dhe informatorëve kyç në rajon përmend korrupsionin – në formën e bashkëpunimit të zyrtarëve dhe policisë me trafikantët- si pengesa kryesore në luftën kundër trafikimit:

> *Korrupsioni është ndoshta faktori më i rëndësishëm në shpjegimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Megjithatë, lidhja ndërmjet dy fenomeneve dhe ndikimi aktual i korrupsionit në trafikimin e personave përgjithësisht lihen mënjanë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe masave të anti-trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo mungesë vëmendjeje mund të dobësojë në thelb nismat për të luftuar trafikimin e personave dhe mund të parandalojë përgatitjen e reagimeve sipas nevojave (Balkan Act Now, 2013).*

Këta faktorë janë qartazi të ndërlidhur dhe të marrë së bashku nënvizojnë boshllëqet kryesore në identifikimin e çështjeve në mbarë rajonin, sidomos në lidhje me trafikimin për qëllim të shfrytëzimit për punë.

Shërbime afatgjata riintegrimi mbeten sfidë në rajon.

Mungesa e shërbimeve afatgjatë të riintegrimit për të mbështetur personat që kanë qenë objekt trafikimi pasi largohen nga strehëzat afatshkurtra është paraqitur si boshllëku kryesor në të gjitha burimet e të dhënave. Edhe pse informatorët sugjerojnë që "shërbimet e mbrojtjes dhe ndihmës për personat që kanë qenë objekt trafikimi (të huaj dhe vendas) me të dalë nga strehëza janë zero" dhe tjetër që "nuk ka programe efikase për riintegrimin e viktimave", shumë informatorë në sondazhe dhe intervista theksojnë që çështja kryesore që pengon riintegrimin e efektshëm të personave që kanë qenë objekt trafikimi është mungesa e mbështetjes për punësim. Informatorët dhe të intervistuarit nëpërmjet sondazhit besojnë që duhet të këtë "forma të tjera të riintegrimit ekonomik të tilla që t'i përshtaten kësaj popullate. Mundësia e kufizuar për të patur akses në formimin profesional është një tjetër dobësi e programeve aktuale të riintegrimit".

Njëkohësisht në Shqipëri u vu re që edhe kur rastet mund të gjenin punësim, punët me të ardhura të ulëta nënkuptonin që ata nuk mund të plotësonin nevojat bazë të kostos së jetesës. Kjo nënvizon pikën thelbësore në një raport (Balkan Act Now, 2013) që shumica e viktimave kthehen në të njëjtin vend duke u përballur me të njëjtat probleme që kishin përpara se të trafikoheshin. Në veçanti, mungesa e mundësive ekonomike ka motivuar shumë persona të kapur në rrjetet e trafikimit që të migrojnë me rastin e parë. Situata e tyre përgjithësisht nuk ka ndryshuar pas kthimit dhe madje mund të jetë keqësuar nga kostot e shpenzuara nëpërmjet migracionit të tyre. Kështu riintegrimi afatgjatë sjell sfida për të cilat zgjidhjet e duhura nuk janë identifikuar dhe realizuar. Të menduarit ndryshe mund të kërkohet në këtë fushë për shembull përfshirje më e madhe e sektorit privat në dhënien e mundësive brenda sektorit publik.

Ligjet e hartuara për të mbrojtur personat që kanë qenë objekt trafikimi funksionojnë dhe zbatohen në mënyrë jo konsistente në rajon.

Në mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor, informatorët identifikuan një gamë çështjesh që sugjeronin se viktimat përgjithësisht shërbehen pak nga kuadri aktual ligjor pothuajse i papërdorshëm. Në radhë të parë, kjo lidhet me mënyrën e përkufizimit dhe interpretimit të trafikimit të personave, por në raste të tjera ndodh për shkak të zbatimit të dispozitave ligjore ekzistuese. Për shembull në BH secili nga katër juridiksionet e veçanta penale ka kodin e tij penal; trafikimi i qenieve njerëzore konsiderohet si shkelje e veçantë vetëm në njërin prej tyre. Tre të tjerët mbulojnë vetëm trafikimin për qëllim shfrytëzimi seksual. Madje, ligji i Malit të Zi nuk përmban një përkufizim për viktimën e TP. Raporti i GRETA 2012 përkufizon "një viktimë trafikimi" si "një viktimë të dëmtuar nga aktet e autorëve të veprave penale në fushën e akteve të trafikimit të qenieve njerëzore që mbulohet nga Kodi Penal." Një person përcaktohet si "viktimë trafikimi" ligjërisht vetëm nëse "provohet" në gjykatë sipas nenit 444 ose 445 të Kodit Penal.

Në vende të tjera mungon përkufizimi funksional i trafikimit. Për shembull, në Malin e Zi nuk ka ligj që të përkufizojë një viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore. Një personi i jepet ligjërisht statusi i "të trafikuarit" vetëm në rastet kur gjykata e identifikon dikë si fajtor për trafikimin. Në Kosovë, lypja nuk renditet në përkufizimin e trafikimit të personave, as në lidhje me shfrytëzimin. Edhe kur trafikimi përkufizohet si duhet në ligj, ka pasur raportime të rasteve të trafikimit që janë trajtuar si prostitucion ose konflikte pune në mbarë rajonin.

Siç shihet më sipër, viktimat në BH dhe në Serbi detyrohen që të dëshmojnë. Edhe në Serbi një OJQ ka raportuar raste ku gjyqtarët, pa asnjë shprehje respekti ju drejtohen viktimave me emër, ndërsa njëkohësisht i drejtohen gjithë respekt të tjerëve- të pandehur, prokurorë, avokatë. Raportimi më tej thekson që viktimave ju bëhen pyetje të papërshtatshme për stilin e tyre të jetës dhe arsyet pse kanë zgjedhur këtë stil. Ka pasur raste kur janë përdorur emrat e plotë të viktimave në të gjitha proceset gjyqësore. Analiza ligjore gjithashtu tregoi që në shtatë gjyqe u tregua edhe adresa e banimit të përkohshëm ose të përhershëm të viktimave. Në BH, GRETA u informua për një rast kur emrat e viktimave në mbrojtje të veçantë dolën në shtyp.

Në Shqipëri, duket se ofrohet pak mbrojtje ligjore për personat që kanë qenë objekt trafikimi. Së pari, siç shpjegon një informator "shtyrja e proceseve gjyqësore është një nga faktorët që ka çuar në përfundimin e pasuksesshëm" të ndjekjes penale të çështjeve. Informatorët gjithashtu shprehën shqetësimin për "ekspozimin e viktimave në sallat e gjyqit përpara elementëve kriminale, pa mundësinë për të fshehur dhe mbajtur informacionin". Të tjerë informatorë ngritën shqetësimet për sjelljen e prokurorëve ndaj personave që kanë qenë objekt trafikimi. Siç pyet një informator "Nëse një prokuror që i drejtohet viktimës (të shfrytëzimit seksual) me fjalët "Ti do që ta bësh" çfarë avokati do të jetë ai

për atë?" Kjo sugjeron që informatorët janë të shqetësuar për proceset ligjore të duhura dhe stafin në mbrojtje dhe në shërbim të interesave të atyre që duan të ndjekin rrugën ligjore për trafikimin.

Të dhënat e studimit gjithashtu sugjerojnë zbatimin e pamjaftueshëm të ligjeve të trafikimit që "kemi vetëm në letër, por jo në mënyrë praktike". Shembuj nga përgjigjet përshkruajnë gjithashtu situata si "dhe që atje ku ligjet ishin zbatuar, ishin bërë në mënyrë të tillë që nuk respektonin të drejtat e viktimave ose nuk u shërbenin interesave të tyre, sidomos në lidhje me dëmshpërblimin." Siç thekson ky citim, çështja e dëmshpërblimit u vu re si një boshllëk i veçantë në rajon dhe është tregues i mangësive aktuale të sistemit të drejtësisë penale në rajonin e Ballkanit Perëndimor, sa i përket mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit.

Shumë personave nuk u ofrohen shërbimet dhe mbështetja e mundshme.

Shumë raportime dhe informatorë të intervistave dhe sondazhit online theksojnë që shërbimet ofrohen kryesisht në strehëza dhe kanë si objekt personat që janë trafikuar për qëllim të shfrytëzimit seksual. Kundrejt një këndvështrimi konsensual që trafikimi për qëllim të shfrytëzimit për punë ka qenë në rritje, brenda dhe jashtë rajonit të Ballkanit Perëndimor, viktimat e shfrytëzimit për punë "janë totalisht të lëna mënjanë". Në veçanti, të pyeturit nëpërmjet sondazhit vërejnë mungesën e shërbimeve të specializuara mbështetëse për rastet e meshkujve në nivel kombëtar dhe rajonal. Ky ka qenë shqetësim i veçantë nisur nga fakti që konsiderohen forma të tjera të shfrytëzimit si (1) forma që po zhvillohen dhe (2) forma që shpesh përfshijnë meshkuj të cilëve nuk u ofrohen mjaftueshëm shërbime nga shërbimet mbështetëse që zhvillohen për të plotësuar nevojave e grave të shfrytëzuara në industrinë e seksit. Siç vëren një informator, ndihma në rajon është pothuajse me bazë strehëze, dhe meqë nuk ka të tilla për meshkuj, çdo "mashkull i identifikuar viktimë trafikimi dërgohet në shtëpi".

Shumë të dhëna theksojnë mungesën e mbështetjes dhe shërbimeve për fëmijët viktima të trafikimit në rajon. Informatorë nga Kosova, Serbia, BH, Shqipëria dhe Mali i Zi theksuan mungesën ose mbështetjen e pamjaftueshme të specializuar për fëmijët e trafikuar. Për shembull, ka vetëm pak strehëza në dispozicion për fëmijët e trafikuar, prandaj ata strehohen në strehëza për të rritur, viktima ose strehëza për fëmijë në situata të tjera të vështira, si për shembull fëmijët pa kujdes prindëror.

Të dhënat e studimit më tej tregojnë që fëmijët nuk trajtohen si duhet nga sistemi i drejtësisë penale. Për shembull, në Serbi "të miturit thirren për të dhënë deklarata për një kohë të gjatë, dhe kjo është pengesë e rëndë për rikuperimin e tyre, i pengon që ta lënë pas përvojën e tyre të trafikimit dhe që të ecin përpara" (ASTRA, 2011). Në raste të tjera, kërkesa që punonjësit socialë të caktohen për të ndihmuar fëmijët gjatë procesit ligjor nuk aplikohet në çdo rast.

Një tjetër fushë për shqetësim është situata në lidhje me rastet kur prindërit janë bashkëpunëtorë në trafikimin e fëmijës së tyre. Përgjithësisht prindi ose kujdestari ligjor i një të mituri duhet të japë pëlqimin me shkrim për qëndrimin e fëmijës në strehë dhe procedurat për të hequr këtë kërkesë janë vënë re si në Shqipëri dhe në Serbi sepse janë mjaft të zgjatura.

Mungesa e mbështetjes dhe shërbimeve është vënë re edhe për popullsinë rome, edhe pse mbledhja dhe analizimi i reagimeve ndaj të gjitha pyetjeve dhe burimet e të dhënave sugjerojnë nevojën për të trajtuar çështjet në lidhje me komunitetin rom në një mënyrë të plotë, të tillë që trajton (1) faktorët e vulnerabilitetit që përfshijnë mos-regjistrimin e lindjes, e cila është pengesë për marrjen e ndihmës sociale dhe mjekësore; (2) sjellje kulturore ndaj dhe brenda komunitetit rom që vepron si pengesë për parandalimin e TP, identifikimin e rasteve dhe riintegrimin e suksesshëm. Një informator thekson nevojën për qasje të reja ndaj këtyre çështjeve, duke vërejtur një investim të madh të burimeve të investuara për të zgjidhur ato, por me shumë pak ndikim.

Ka pak sisteme që të sigurojnë se ndihma për personat që kanë qenë objekt trafikimit (1) plotëson standardet minimale dhe (2) konsiderohet e përshtatshme nga vetë personat.

Reagimet për çështjen e sistemeve që veprojnë për të siguruar ndihmë të ofruar nëpërmjet programeve mbështetëse plotësojnë standardet minimale dhe konsiderohen si të përshtatshme nga vetë personat, fokusuar në dy çështje: ekzistenca dhe monitorimi i standardeve minimale për ndihmë dhe shërbime dhe mekanizmat e reagimit të viktimave.

Në lidhje me ekzistencën e standardeve minimale, të dhënat e studimit theksojnë që këto përgjithësisht mungojnë. Në Kosovë për shembull, një studim i fundit për strehëzat vëren që ndërsa plotësohen standardet minimale të kujdesit, cilësia e shërbimeve është vlerësuar mjaftueshëm e pranueshme. Licencimi dhe certifikimi i strehëzave u sugjerua si metodë për të përmirësuar qasjen e përgjithshme ndaj, dhe cilësinë e, ofrimit të shërbimeve. Ky sugjerim po konsiderohet edhe në BH ku qeveria synon të trajtojë mungesën aktuale të standardeve minimale për strehëzat që duan të nënshkruajnë një protokoll me qeverinë për të strehuar viktimat (OSBE, 2009). Shqetësimet për cilësinë e shërbimeve janë shprehur në Serbi, duke u fokusuar në faktin që shërbimet/agjencitë shtetërore të përfshira në mekanizmin kombëtar të referimit nuk janë transparente në punën e tyre dhe që prandaj është e vështirë për aktorët e jashtëm që të monitorojnë cilësinë e ndihmës që u jepet viktimave dhe procesin e ndihmës për viktimat në përgjithësi.

Mekanizmat për të kërkuar reagim nga personat që kanë qenë objekt i trafikimit në lidhje me cilësinë e shërbimeve që marrin janë zhvilluar në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbi dhe Shqipëri. Këto duket se funksionojnë vetëm

në Shqipëri ku ka standarde të shërbimit social për reagimin e viktimave në të gjitha strehëzat, përfshirë ato për viktimat e trafikimit. Burimet e qeverisë raportojnë që në çdo strehëz gjendet një libër për ankesa me një kolonë për zgjidhjet. Është vendosur gjithashtu një kuti për ankesat anonime në çdo strehëz dhe kjo hapet çdo muaj nga një përfaqësues i zyrës së shërbimit social, së bashku me një banor të strehëzës. Të strehuarit plotësojnë edhe një pyetësor çdo tre muaj dhe "marrim ide dhe reagime të jashtëzakonshme". Koalicioni Shqiptar për Strehëzat e Anti-Trafikimit (tre strehëza të OJQ-ve dhe një shtetërore) ka përcaktuar treguesit për mbështetjen dhe riintegrimin e viktimave bazuar në manualin e monitorimit të njohur në nivel ndërkombëtar (Surtees, 2010).

Në Serbi, një informator raportoi që Qendra për Mbrojtjen dhe Ndihmën ndaj Viktimave të Trafikimit ka zhvilluar një rast monitorimi për çdo plan rehabilitimi individual të viktimës, që do të përfshijë reagimin e viktimës etj. Megjithatë, kjo deri tani nuk është realizuar akoma. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, një informator raportoi që të trafikuarve u jepet një formular sapo largohen nga strehëza. Informatori u shpreh që nuk është e qartë nëse ku informacion analizohet më tej dhe nëse përdoret në një mënyrë a në tjetrën.

Vlerësimi i nevojave:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor

4. TAKIM VLERËSIMI

Komponenti i fundit i vlerësimit të nevojave ka të bëjë me një takim të aktorëve, i mbajtur në Shkup, ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë, në maj 2014 (shihni Shtojcën G për numrin e pjesëmarrësve dhe organizatave pjesëmarrëse). Qëllimi i këtij takimi ishte (1) rishikimi dhe diskutimi i gjetjeve paraprake të vlerësimit të nevojave dhe (2) përmirësimi i mëtejshëm i përparësive të aktorëve për trajtimin e boshllëqeve rajonale, nevojave dhe mjeteve me anë të të cilave të zhvillohet një reagim më i qëndrueshëm ndaj trafikimit në format e tij aktuale dhe të shumta. Të gjithë pjesëmarrësit e takimit në fillim rishikuan dhe diskutuan gjetjet paraprake dhe rekomandimet e vlerësimit të nevojave (shihni Shtojcën H për prezantimin e takimit). Më pas ata u ndanë në grupe të vogla pune për të diskutuar dhe prioritizuar rekomandimet. Pas diskutimit në grupe pune, u kthyen përsëri së bashku në grup të madh për të prezantuar dhe diskutuar për mënyrën e përmirësimit dhe prioritizimit të rekomandimeve. Tabela 4.1 dhe 4.2 paraqet rezultatet e këtyre veprimtarive të takimit.

4.1 Prioritizimi nga takimi në grupe të vogla

Aktorët e çdo vendi, me të cilët u bashkuan edhe përfaqësues të organizatave ndërqeveritare dhe donatorë, krijuan gjashtë grupe pune sipas vendeve (Shqipëri, BH, Kosovë, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mal i Zi dhe Serbi). Çdo grupi ju kërkua që të prioritizojë dhe të rendisë të gjitha rekomandimet sipas rendit kronologjik sipas fushës me më shumë rëndësi dhe nevojë për ato. Atyre u kërkua gjithashtu që të diskutojnë dhe përmirësuar fokusin specifik dhe formulimin e 2-3 rekomandimeve që ju caktua secilit grup, sipas nevojës. Pas përfundimit të ushtrimit, çdo grup raportoi përparësitë dhe përmirësimet përpara gjithë grupit. Tabela 8 përmbledh prioritetet që i caktohen çdo rekomandimi.

Tabela 8: Prioritizimi i Rekomandimeve të Grupit të Vogël

Fusha	Rekomandimi	Prioriteti i caktuar
Identifikim	*Konsideroni përfshirjen e një game më të gjerë aktorësh në identifikimin proaktiv të viktimave të trafikimit. Këta aktorë duhet të përfshijnë: inspektorët e punës, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit social dhe mësuesit.* ***Rekomandim i rishikuar**: Rishikoni strukturën ekzistuese në nivel qendror dhe lokal, përfshini, trajnoni, përfshini në mandatin ekzistues, institucionalizoni në sistem, një gamë më të madhe aktorësh në referimin proaktiv të viktimave të mundshme për identifikim: inspektorët e punës, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit social, drejtuesit e komunitetit dhe mësuesit.*	***1***
	Forcimi i aftësive dhe kapacitetit të policisë – dhe aktorëve të tjetër të përfshirë në sistem- për të identifikuar raste të trafikimit, përfshirë kontrollin, intervistimin dhe referimin e rasteve në formën e duhur ***Rekomandim i rishikuar:** Forcimi i aftësive dhe kapaciteteve të qëndrueshme të policisë për zbulimin dhe identifikimin e hershëm* ***Komente**: Konsiderohet prioritet numër një (1) për Shqipërinë, Kosovën, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë*	***1***
	Forcimi i kapaciteteve dhe motivimi i aktorëve jo policorë përgjegjës për identifikimin e viktimave të trafikimit ***Koment**: shmanget përdorimi i termit "aktorë jo policorë"; përfshihet forcimi i motivimit dhe aftësive për identifikim paraprak (të hershëm)*	***2***

Fusha	Rekomandimi	Prioriteti i caktuar
	Ndjekja e një qasjeje proaktive për identifikimin e rasteve të trafikimit: ***a. duke inkurajuar inspektimin e punës në sektorët më të rrezikuar (p.sh bujqësi, hotele dhe qendra argëtimi, ndërtim, fabrika të vogla, peshkim)*** ***b. Duke zhvilluar sisteme për të arritur tek ata të përfshirë në veprimtari me rrezik të madh si lypja, puna shtëpiake dhe puna e seksit*** ***c. Duke realizuar procedura të përzgjedhjes mes migrantëve të paligjshëm, azilkërkuesve dhe të deportuarve*** ***d. Duke zhvilluar metoda të reja për lehtësimin e vetë-identifikimit të viktimave*** ***Rekomandim i rishikuar***: *Ndjekja e një qasjeje proaktive për identifikimin e rasteve të trafikimit duke:* *e. Inkurajuar inspektimin e punës në sektorët më të rrezikuar (p.sh ndërtim, agjenci private punësimi, hotele dhe vende argëtimi, fabrika të vogla)* *f. Zhvilluar sisteme për të arritur tek ata që janë përfshirë në veprimtari me rrezik të madh si lypja, puna shtëpiake dhe puna e seksit, bujqësi, fëmijët e rrugës dhe fëmijët e përfshirë në krime të lehta* *g. Realizuar procedura të përzgjedhjes mes migrantëve të paligjshëm, azilkërkuesve dhe të deportuarve, të kthyerve me marrëveshje ripranimi dhe të miturve të pashoqëruar.* *h. Zhvilluar metoda të reja për lehtësimin e vetë-identifikimit të viktimave* ***Komente***: *Konsiderohet prioritet për Serbinë, BH, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë*	***2***
Mbështetje	***Ofrimi i më shumë shërbimeve për të gjitha viktimat, jo vetëm atyre që kanë qenë objekt i shfrytëzimit seksual. Në veçanti, duhet t'i kushtohet vëmendje alternativave me bazë komunitare/jo me bazë strehëzash për ata persona që nuk duan ose nuk do të përfitojnë nga vendosja në strehëza***[1] ***Rekomandim i rishikuar: Nuk ka rishikim*** ***Komente***: Shërbimet përfshijnë; krijimin e qendrave profesionale, qendrave të zhvillimit profesional dhe karrierës. Shërbime që mundësojnë gjetjen e punës (biznese sociale). Inkurajimi dhe zhvillimi i partneritetit me subjektet e biznesit.	***4***
	Zhvillimi dhe realizimi i shërbimeve të mbështetjes së dedikuar për fëmijët, viktima të trafikimit, të krijuara sipas nevojave të tyre specifike ***Rekomandim i rishikuar: Nuk ka rishikim*** ***Komente***: *Konsiderohet prioritet rajonal*	***3***

Fusha	Rekomandimi	Prioriteti i caktuar
	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve me anë të (1) zbatimit të standardeve dhe certifikimit të organizatave që ofrojnë mbështetje, përfshirë strehim, (2) monitorimit të standardeve të reja dhe ekzistuese dhe (3) mbledhjes dhe përdorimit të duhur të mekanizmave të reagimit të viktimave bazuar në standardet ndërkombëtare ***Rekomandim i rishikuar:****Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve me anë të (1) zhvillimit dhe zbatimit të standardeve dhe certifikimit të organizatave që ofrojnë mbështetje, përfshirë strehim, (2) monitorimit të standardeve të reja dhe ekzistuese dhe (3) mbledhjes dhe përdorimit të duhur të mekanizmave të reagimit të viktimave bazuar në standardet ndërkombëtare* ***Koment****: Respektim i parimit të pjesëmarrjes në planifikimin dhe krijimin e shërbimeve*	***3***
	Dhënia e mbështetjes së qëndrueshme afat-gjatë për të gjitha viktima, përfshirë aksesin në sisteme kombëtare të mbrojtjes sociale dhe shërbime mbështetëse ***Rekomandim i rishikuar:*** *Dhënia e mbështetjes së qëndrueshme afat-gjatë për të gjitha viktimat sidomos fëmijët, përfshirë zhvillimin e kapaciteteve dhe aksesin në sisteme kombëtare të mbrojtjes sociale dhe shërbime mbështetëse*	***4***
Bashkëpunimi	***Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve kombëtarë në përgjigje të trafikimit*** ***Rekomandim i rishikuar:*** *Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit kombëtar dhe ndërkufitar/rajonal që përfshin aktorë të ndryshëm kombëtar në përgjigje të trafikimit* ***Koment****: Bashkëpunimi rajonal është shumë i rëndësishëm për të gjithë përfaqësuesit e BP. Konsiderohet prioritet për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, BH dhe Serbinë*	***1***
	Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet zbatimit të përmirësuar dhe institucionalizimit të MKR rajonal, forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ekipet e përbashkëta hetimore ***Rekomandim i rishikuar: Nuk ka rishikim***	***8***
Drejtësia penale	***Forcimi i kapaciteteve të aktorëve të drejtësisë penale për të mbrojtur viktimat e trafikimit dhe ndjekur trafikantët në plotësinë e ligjit*** ***Rekomandim i rishikuar****:Forcimi i kapaciteteve të aktorëve të drejtësisë penale për të mbrojtur dhe mbështetur viktimat e trafikimit dhe për të ndjekur me efektivitet trafikantët në plotësinë e ligjit*	***7***

Fusha	Rekomandimi	Prioriteti i caktuar
	Forcimi i mbështetjes për viktimat në proceset e drejtësisë penale, përfshirë zbatimin e plotë të periudhës së reflektimit, mbështetjen gjatë procesit ligjor dhe ndihmën për të kërkuar dëmshpërblim ***Rekomandim i rishikuar:*** *Forcimi i mbështetjes për viktimat në proceset e drejtësisë penale, përfshirë respektimin e periudhës së reflektimit dhe motivim të qartë për viktimat që ta përdorin, mbështetjen gjatë procesit ligjor përfshirë kujdestarët ligjorë dhe ndihmën për të kërkuar dëmshpërblim, parashikimin dhe zbatimin e dispozitave për ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve të trafikantëve* ***Koment****: Sigurimi i zbatimit të dispozitave specifike për fëmijët e përfshirë në procesin e drejtësisë penale*	***4***
Qeveria	***Rritja e financimit për programet kundër TP, sidomos për OJQ-të dhe institucionet që mbështesin personat e trafikuar*** ***Rekomandim i rishikuar:****Rritja e financimit për programet kundër TP, sidomos për OJQ-të dhe institucionet që mbështetin personat e trafikuar, sidomos për mbështetjen afatgjatë për integrim* ***Komente****: Sigurimi i financimit të përhershëm për riintegrim (nga fonde të llotarisë or të dëmshpërblimit të viktimave), zhvillimi i mekanizmit të monitorimit për programe afatgjatë të riintegrimit dhe krijimi i skemave të grantit për programe afatgjata të ri-integrimit* *Konsiderohet prioritet nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, BH, Mali i Zi:*	***4***
Qëndrime	***Përfshirja e veprimtarive për të trajtuar qëndrimet të cilat pengojnë reagimin ndaj trafikimit në trajnime përkatëse, fushata ndërgjegjësimi dhe takime për forcimin e aftësive*** ***Rekomandim i rishikuar:*** *Përfshirja e veprimtarive për të trajtuar qëndrimet të cilat pengojnë reagimin ndaj trafikimit në trajnime të specializuara, për të gjithë aktorët e përfshirë në identifikim, ndjekje, ndihmë dhe mbrojtje të viktimave të trafikimit të personave dhe forma të tjera të shfrytëzimi,fushata ndërgjegjësimi (për publikun e gjerë) dhe takime për forcimin e aftësive* ***Komente****: Konsiderohet prioritet për BH, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi; rekomanduar për të përfshirë veprimtari të ndërgjegjësimit në lidhje me shfrytëzimin për punë, ndërgjegjësimin për çështje të lypjes së fëmijëve dhe martesave të fëmijëve në përputhje me praktikat e "ligjeve zakonore"*	***10***

4.2 Prioritizimi dhe përmirësimet në takimin e gjithë grupit

Aktorët e çdo vendi, me të cilët u bashkuan dhe përfaqësues të organizatave ndërqeveritare dhe donatorët renditën rekomandimet sipas rendit kronologjik sipas fushës me më shumë rëndësi dhe nevojë për ato. Tabela 9 përmbledh prioritetet e caktuara për çdo rekomandim nga pjesëmarrësit e takimit dhe shpeshtinë (pra sa herë është zgjedhur çdo prioritet nga pjesëmarrësit) e çdo prioriteti.

Tabela 9: Prioritizimi sipas të gjithë grupit (shpeshtia)

Fusha	Rekomandimi	Prioriteti i caktuar	Shpeshtia (numri i zgjedhjes)
Identifikimi	Të konsiderohet përfshirja e një game më të gjerë aktorësh në identifikimin proaktiv të viktimave të trafikimit. Këta aktorë duhet të përfshijnë: inspektorët e punës, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit social dhe mësuesit.	2	2
	Të forcohen aftësitë dhe kapacitetet e policisë – dhe aktorëve të tjetër të përfshirë në sistem- për të identifikuar raste të trafikimit, përfshirë kontrollin, intervistimin dhe referimin e rasteve në formën e duhur	1	1
		2	1
	Të forcohen kapacitetet dhe motivimi i aktorëve jo policorë përgjegjës për identifikimin e viktimave të trafikimit	2	1
	Të ndiqet një qasjeje proaktive për identifikimin e rasteve të trafikimit: duke inkurajuar inspektimin e punës në sektorët më të rrezikuar (p.sh bujqësi, hotele dhe qendra argëtimi, ndërtim, fabrika të vogla, peshkim) Duke zhvilluar sisteme për të arritur tek ata të përfshirë në veprimtari me rrezik të madh si lypja, puna shtëpiake dhe puna e seksit Duke realizuar procedura të përzgjedhjes mes migrantëve të paligjshëm, azilkërkuesve dhe të deportuarve Duke zhvilluar metoda të reja për lehtësimin e vetë-identifikimit të viktimave	1	1
		1	1

Mbështetja	Të ofrohen më shumë shërbimeve për të gjitha viktimat, jo vetëm atyre që kanë qenë objekt i shfrytëzimit seksual. Në veçanti, duhet t'i kushtohet vëmendje alternativave me bazë komunitare/jo me bazë strehëzash për ata persona që nuk duan ose nuk do të përfitojnë nga vendosja në strehëza[2]	2	1
		4	1
		6	1
	Të zhvillohen dhe realizohen shërbimet e mbështetjes së dedikuar për fëmijët, viktima të trafikimit, të krijuara sipas nevojave të tyre specifike	4	1
		5	1
	Të përmirësohet cilësia e shërbimeve me anë të (1) zbatimit të standardeve dhe certifikimit të organizatave që ofrojnë mbështetje, përfshirë strehim, (2) monitorimit të standardeve të reja dhe ekzistuese dhe (3) mbledhjes dhe përdorimit të duhur të mekanizmave të reagimit të viktimave bazuar në standardet ndërkombëtare	3	1
	Të jepet mbështetje e qëndrueshme afat-gjatë për të gjitha viktimat, përfshirë aksesin në sisteme kombëtare të mbrojtjes sociale dhe shërbime mbështetëse	3	1
		5	1
Bashkëpunimi	Të rritet bashkëpunimi dhe koordinimi mes aktorëve kombëtarë në përgjigje të trafikimit	1	1
		5	1
	Të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar nëpërmjet zbatimit të përmirësuar dhe institucionalizimit të MKR rajonal, forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ekipet e përbashkëta hetimore	1	1
		8	2
Drejtësia penale	Të forcohen kapacitetet e aktorëve të drejtësisë penale për të mbrojtur viktimat e trafikimit dhe ndjekur trafikantët në plotësinë e ligjit	4	1
		7	1
	Të forcohet mbështetja për viktimat në proceset e drejtësisë penale, përfshirë zbatimin e plotë të periudhës së reflektimit, mbështetjen gjatë procesit ligjor dhe ndihmën për të kërkuar dëmshpërblim	4	1
		8	1
Qeveria	Të rritet financimi për programet kundër TP, sidomos për OJQ-të dhe institucionet që mbështesin personat e trafikuar	1	2
		3	1

Qëndrimet	Të përfshihen veprimtari për të trajtuar qëndrimet të cilat pengojnë reagimin ndaj trafikimit në trajnime përkatëse, fushata ndërgjegjësimi dhe takime për forcimin e aftësive	9	1
		10	1
		14	2

Tabela 10 raporton rekomandimet siç janë prioritizuar nga pjesëmarrësit në takimin e aktorëve të përfshirë gjatë diskutimit në grupin e madh. Rekomandimet renditen sipas prioritetit duke filluar me ato me prioritet më të madh dhe për të përfunduar me rekomandimet që kanë më pak përparësi për pjesëmarrësit.

Tabela 10: Rekomandimet e renditura sipas prioritetit

4.3 Komente të pjesëmarrësve në takim

Pas takimit, IOM u dha pjesëmarrësve mundësinë që të japin reagimin e tyre me shkrim në lidhje me projektin e raportit të IOM për Vlerësimin e Nevojave në Ballkanin Perëndimor. Qëllimi i kërkesës për komente me shkrim ishte që të sigurohej se pjesëmarrësit do të (1) rishikonin plotësisht dhe komentonin gjetjet paraprake të vlerësimit të nevojave dhe (2) përmirësonin caktimin e prioritetit dhe rekomandimet për të trajtuar boshllëqet dhe për të patur një reagim më të qëndrueshëm dhe të efektshëm ndaj TP në rajon.

Përfaqësues nga katër prej gjashtë vendeve pjesëmarrëse dhanë komente me shkrim. Edhe pse këto komente nuk ndryshuan gjetjet dhe rekomandimet e bëra nga rishikimi i dokumenteve, intervistat dhe sondazhi, ato mundësuan përmirësimin dhe korrigjimin si edhe informacion të përditësuar për vendimet ligjore dhe të politikave në lidhje me TP. Ky raport pasqyron këto përmirësime dhe korrigjime.

Vlerësimi i nevojave:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në këtë seksion jepen konkluzione për fushat e nevojës që aktorët i identifikuan si të tilla që kanë nevojë për zhvillim me qëllim që të sigurohet reagimi i plotë ndaj trafikimit në Ballkanin Perëndimor. Këto konkluzione ndahen në gjashtë nën-temat e mëposhtme: (I) identifikimi i rasteve të trafikimit; (II) shërbime mbështetjeje dhe riintegrimi; (III) bashkëpunim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; (IV) proces i drejtësisë penale; (V) angazhimi dhe burimet e qeverisë; (VI) reagimi ndaj normave dhe qëndrimeve në lidhje me LP.

Konkluzionet ndiqen nga rekomandime në lidhje me çdo nën-temë. Rekomandimet rrjedhin nga gjetjet e paraqitura në Seksionin 3. Në përputhje me objektivat e vlerësimit të nevojave, rekomandimet fillestare synojnë të trajtojnë boshllëqet kryesore dhe prioritetet e identifikuara në nivel rajonal. Këto rekomandime pasqyrojnë gjithashtu rekomandimet që bëhen më zakonisht nga informatorët dhe të intervistuarit që ju përgjigjën sondazhit. Si të tilla, jo të gjitha rekomandimet do të jenë njësoj të rëndësishme për çdo vend. Kemi përfshirë gjithashtu disa rekomandime shtesë sipas vendit dhe prioritetet për veprim. Gjithsej janë dhënë 15 rekomandime të renditura sipas temës; rendi sipas të cilit jepen rekomandimet nuk pasqyron rëndësinë e tyre.

I. Identifikimi i personave të trafikuar

Siç theksohet në Seksionin 3.5, prioriteti i kudondodhur i identifikuar në vlerësimin e nevojave është nevoja për të përmirësuar identifikimin e rasteve të trafikimit. Siç shpjegon një informator "sigurimi i mekanizmave efektive për identifikimin e besueshëm të viktimave pa dyshim është një nga komponenentët më të ndjeshëm në sistemin e plotë të luftës kundër këtij fenomeni", ai pa dyshim që përbën një çështje kryesore që pjesëmarrësit në studim mendojnë se duhet të përmirësohet në gjithë rajonin.

Aktualisht, të intervistuarit e shohin identifikimin e rasteve si gjerësisht reaktiv dhe të fokusuar tepër në trafikimin për qëllim shfrytëzimi seksual. Synohet që të nxitet nga policia dhe punonjës kufitarë, me raste por jo mjaftueshëm, përfshirja e punonjësve socialë dhe OJQ-ve. Aktorë të tjerë, sidomos inspektorët e punës, raportohet që as nuk përfshihen formalisht në identifikim, as nuk janë aktivë, as

nuk përballen me pengesat për përmbushjen e përgjegjësive të tyre. Sipas të intervistuarve "përfshirja e një numri më të madh aktorësh për identifikimin e viktimave të trafikimit jep më shumë mundësi për t'ju shërbyer atyre në momentin e duhur". Siç e tregon dhe ky citim, të dhënat e studimit tregojnë një këndvështrim të gjerë se gama e aktorëve të përfshirë në identifikimin e rasteve të trafikimit duhet të shtrihet, sidomos për të përfshirë aktorët jo-qeveritarë. Gjithashtu, është shprehur fuqishëm nevoja për "të përmirësuar aftësitë e policisë për të zbatuar me efektivitet SOP dhe Mekanizmin Kombëtar të Referimit" dhe "për të trajnuar më tej inspektorët e punës, punonjësit e shëndetësisë, autoritetet e zbatimit të ligjit, mësuesit dhe punonjësit e shërbimeve sociale për të përmirësuar identifikimin e viktimave dhe për të kuptuar Procedurat Standarde të Punës". Të intervistuarit të sondazhit konsiderojnë trajnimin dhe forcimin e kapaciteteve të aktorëve tradicionalë dhe jo-tradicionalë si një prioritet absolut dhe mënyrë me anë të së cilës mund të përmirësohen proceset dhe procedurat e identifikimit.

Së bashku me shtrirjen e gamës së aktorëve të përfshirë në identifikim dhe përmirësimin e aftësive të tyre përkatëse, të intervistuarit besojnë se për identifikimin duhet të ndiqet një qasje më proaktive. Kjo qasje duhet të përfshijë një gamë metodologjish, në varësi të faktit nëse vendndodhja e atyre që janë në rrezik përbën një vend pune formal, një vend pune informal, ose shtëpi apo vend tjetër si për shembull një pikë kalimi kufitare ose qendër pritjeje/ndalimi për imigracionin. Kjo punë duhet gjithashtu që të decentralizohet dhe të shpërndahet tek komunitetet lokale dhe zonat rurale dhe të mos fokusohet vetëm në kryeqytete. Të intervistuarit duan të shohin procese identifikimi të zhvilluara që përfshijnë rregulla, procedura të qarta, kritere dhe udhëzime për përzgjedhjen e viktimave. Ato gjithashtu mbrojnë përdorimin e teknologjive moderne për të trajtuar pengesat gjuhësore dhe sfida të tjera të mundshme ndaj identifikimit.

Rekomandime specifike për përmirësimin e identifikimit përfshijnë sa më poshtë:

1. ***Të konsiderohet përfshirja e një game më të gjerë aktorësh në identifikimin proaktiv të viktimave të trafikimit. Këta aktorë duhet të përfshijnë: inspektorët e punës, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit social dhe mësuesit***

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- BH: të rritet përfshirja së sektorit të edukimit dhe shëndetësisë në identifikim dhe referim
- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: të rritet roli dhe puna e inspektoratit të punës në identifikim
- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: të lejohen organizatat që punojnë në mënyrë të pavarur nga shteti që të identifikojnë formalisht personat e trafikuar
- Serbi: të inkurajohet përfshirja e shumë agjencive në identifikim duke formalizuar rolin e tyre dhe inputin e OJQ-ve të specializuara dhe duke përfshirë aktorë të tjerë të rëndësishëm si inspektorët e punës, punonjësit socialë dhe stafin shëndetësor

2. ***Të forcohen aftësitë dhe kapacitetet e policisë – dhe aktorëve të tjetër të përfshirë në sistem- për të identifikuar raste të trafikimit, përfshirë kontrollin, intervistimin dhe referimin e rasteve në formën e duhur***

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- Serbi, Mal i Zi: të pajiset stafi në vijë të parë me tregues operacional, udhëzime dhe mjete për t'u përdorur në procesin e identifikimit dhe ato të përditësohen rregullisht për të pasqyruar modalitete të reja të TP
- Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi: të përmirësohen kapacitetet e kontrollit kufitar për të zbuluar dhe identifikuar personat e trafikuar
- Shqipëri: të përmirësohen kapacitetet identifikuese të policisë kufitarë në lidhje me kategori të caktuara të rasteve, si për shembull meshkuj dhe raste të trafikimit të brendshëm
- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: Të gjitha njësitë policore duhet të trajnohen për të identifikuar rastet, jo vetëm njësitë e specializuara që kanë mbulim të kufizuar dhe jo domosdoshmërisht e njohin situatën e komuniteteve lokale

3. ***Të forcohen kapacitetet dhe motivimi i aktorëve jo policorë përgjegjës për identifikimin e viktimave të trafikimit[1]***

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- Shqipëri, BH: të ndërgjegjësohen inspektorët të punës për fenomenin e trafikimit me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre për identifikimin dhe raportimin e rasteve të mundshme
- Mal i Zi: të trajnohen agjencitë për identifikimin e personave të trafikuar sidomos stafi në vijë të parë, përfshirë zyrtarët e zbatimit të ligjit, inspektorët e punës, punonjësit socialë, stafi mjekësor, stafi i institucioneve të veçanta për fëmijë dhe OJQ

4. ***Të ndiqet një qasje proaktive për identifikimin e rasteve të trafikimit:***

   a. ***duke inkurajuar inspektimin e punës në sektorët më** të rrezikuar (p.sh bujqësi, hotele dhe qendra argëtimi, ndërtim, fabrika të vogla, peshkim)***

   b. ***duke zhvilluar sisteme për të arritur tek ata të përfshirë në veprimtari me rrezik të madh si lypja, puna shtëpiake dhe puna e seksit***

   c. ***duke realizuar procedura të përzgjedhjes mes migrantëve të paligjshëm, azilkërkuesve dhe të deportuarve***

   d. ***duke zhvilluar metoda të reja për lehtësimin e vetë-identifikimit të viktimave***

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

1 Pas inputit nga aktorët në takim, ky rekomandim u ndryshua nga "aktorët jo-policor" në "të gjithë aktorët".

- BH: të zhvillohen dhe të zbatohen rregulla dhe procedura të qarta për identifikimin e personave të trafikuar, sidomos rasteve në vend dhe fëmijët e përfshirë në lypje
- Mal i Zi: të prezantohet një liste kontrolli për të identifikuar raste të mundshme trafikimi gjatë sistemit të aplikimit për vizë dhe të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme treguesit për të pasqyruar natyrën e ndryshueshme të TP
- Mal i Zi: të sigurohet që nëpunës të zbatimit të ligjit, punonjësit social, inspektorët e punës dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm do të ndjekin një qasje më proaktive për identifikimin dhe të rritet punës së tyre në terren
- Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: të forcohen kapacitetet për identifikimin e personave të trafikuar, mes migrantëve të parregullt
- Serbi: të përcaktohen treguesit për identifikimin e fëmijëve dhe të rriturve, viktima, në të gjitha fazat e TP

II. Mbështetja dhe shërbime riintegrimi për personat e trafikuar

Vlerësimi i nevojave identifikoi disa probleme në lidhje me gamën e shërbimeve mbështetëse dhe sidomos ri-integruese që ofrohen. Lloje të ndryshme të të dhënave të studimit vërejnë që shërbimet ofrohen më shumë në strehëza dhe për raste të trafikimit për qëllim shfrytëzimi seksual. Standardet minimale për strehëza dhe shërbime të tjera mbështetëse për viktima nuk kanë vepruar në mënyrë rutinë dhe nuk janë monitoruar në mbarë rajonin, ndërsa vetëm Shqipëria kërkon në mënyrë sistematike reagim nga personat që kanë qenë objekt trafikimi në lidhje me rëndësinë dhe cilësinë e shërbimeve që ju ofrohen atyre.

Duke reflektuar shqetësimet e shprehura në lidhje me proceset e identifikimit, të intervistuarit konsiderojnë që shumë lloj rastesh mbeten të patrajtuara, ose të keq trajtuara, nga shërbimet ekzistuese. Në mënyrë akute, mes tyre, shqetësim i madh u shpreh në të paktën pesë vende për mbështetje të specializuar të pamjaftueshme për fëmijët e trafikuar. Meshkujt janë gjithashtu një grup kyç për të cilin nuk ofrohen shërbime, dhe në shumë raste, ndonjë shërbim i tillë. Ndërsa disa të intervistuar vërejnë që nuk ka strehëza në rajon për meshkujt, të tjerët shohin që ky problem pasqyron mungesën e përgjithshme të shërbimeve për të gjitha rastet e trafikimit.

Të intervistuarit vunë theksin në veçanti tek boshllëqet në mbështetje për riintegrim afatgjatë, sidomos mungesa ndonjëherë e plotë e shërbimeve në mbështetje të punësimit, trajnimit dhe për të siguruar pavarësi afatgjatë ekonomike. Lokaliteteve gjithashtu u mungojnë lidhjet ndërmjet shërbimeve mbështetëse dhe shërbimeve të tjera ekzistuese sociale midis komuniteteve. Kjo është njësoj si vënia e viktimave në të njëjtën situatë që i ka vënë në rrezik trafikimi, një faktor kyç në trafikim që shpesh shfaqet tërësisht i munguar dhe të intervistuarit duan që ai të ri-shihet.

Bazuar në boshllëqet e identifikuara në mbështetjen për rikuperim dhe riintegrim të personave të trafikuar, rekomandime specifike përfshijnë sa më poshtë:

5. ***Të ofrohen më shumë shërbimeve për të gjitha viktimat, jo vetëm atyre që kanë qenë objekt i shfrytëzimit seksual***

6. ***Të ofrohen më shumë alternativa me bazë komunitare/jo me bazë strehëzash për ata persona që nuk duan ose nuk do të përfitojnë nga vendosja në strehëza***

7. ***Të zhvillohen dhe realizohen shërbimet e mbështetjes së dedikuar për fëmijët, viktima të trafikimit, të krijuara sipas nevojave të tyre specifike***

Kjo përfshin krijimin e programeve të specializuara për ri-integrimin e fëmijëve, ofrimin e mbështetjes së duhur për familjet birësuese sipas nevojës dhe përmirësimin e kapaciteteve të punëmarrësve në institucione të kujdesit për fëmijët.

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- Shqipëri: të sensibilizohen donatorët për rëndësinë e granteve dhe mbledhjes së fondeve për riintegrim
- BH: të përfshihet mbrojtja së fëmijëve në dokumente strategjike dhe udhëzime/protokolle administrative
- Kosovë: të konsiderohet ndarja e kostove në lidhje me kujdesin, ndihmën dhe riintegrimin e viktimave mes ministrive dhe agjencive qeveritare me përgjegjësi për t'ju përgjigjur trafikimit
- Mal i Zi, Serbi: të zhvillohen ose të përmirësohen programe të specializuara për dhënien e ndihmës për fëmijët, viktima të trafikimit nga identifikimi deri në ri-integrim
- Mal i Zi: të lehtësohet ri-integrimi i viktimave të trafikimit në shoqëri dhe të shmanget ri-trafikimi duket ju dhënë atyre formim profesional dhe akses në tregun e punës
- Serbi: të ofrohet trajnim për familjet birësuese dhe të sensibilizohen punëmarrësit e institucioneve të kujdesit për fëmijët në lidhje me nevojat dhe trajtimin e duhur të klientëve të tyre

8. ***Të përmirësohet cilësia e shërbimeve me anë të (1) zbatimit të standardeve dhe certifikimit të organizatave që ofrojnë mbështetje, përfshirë strehim, (2) monitorimit të standardeve të reja dhe ekzistuese dhe (3) mbledhjes dhe përdorimit të duhur të mekanizmave të reagimit të viktimave bazuar në standardet ndërkombëtare***

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- BH: të zhvillohen rregulla dhe procedura të standardizuara për të ndihmuar personat e trafikuar në vend
- BH: të përmirësohet dhe forcohet ndihma dhe mbrojtja afatgjatë (cilësi dhe sasi)

- BH, Kosovë: të prezantohet certifikimi dhe licencimi i strehëzave
- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: të përmirësohet cilësia e përgjithshme të ndihmës dhe të sigurohet ofrimi i shërbimeve thelbësore falas "Falas do të thotë falas. Jo vetëm falas në letër"
- Mal i Zi: të sigurohen kushtet e duhura dhe të përshtatshme për nevojat e veçanta në strehëza për personat e trafikuar
- Serbi: të prezantohen procedurave të reagimit për të monitoruar ndihmën që i jepet personave të trafikuar pas kthimit të tyre në vendin e origjinës

9. ***Të jepet mbështetje e qëndrueshme afat-gjatë për të gjitha viktimat, përfshirë aksesin në sisteme kombëtare të mbrojtjes sociale dhe shërbime mbështetëse***

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- BH, Kosovë, Serbi: të krijohen sisteme dhe mekanizma për të siguruar që njerëzit të ndihmohen në procesin afatgjatë të rehabilitimit dhe riintegrimit
- Mal i Zi: të lehtësohet riintegrimi i personave të trafikuar dhe të shmanget ritrafikimi duke u dhënë atyre mundësi formimi profesional dhe akses në tregun e punës

III. Bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Siç detajohet në Sekionin 3.4, të dhënat e studimit sugjerojnë që ndërsa në rajon janë zhvilluar disa forma të strukturës së bashkëpunimit kombëtar, vetëm Shqipëria ka një MKR tepër funksional dhe madje edhe këtu, jo të gjitha palët janë të përfshira në mënyrë aktive. Forcimi i bashkëpunimit ndër-sektorial dhe ndërinstitucional për të gjitha përpjekjet kundër trafikimit u identifikua si përparësi në rajon, me theks të veçantë në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet nëpunësve të zbatimit të ligjit dhe aktorëve të tjerë.

Të intervistuarit theksuan çështje të ngjashme në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërkufitar, duke përmendur që edhe pse ekzistonin mekanizma, ato nuk ishin gjithmonë plotësisht funksionale. Të intervistuarit në veçanti theksuan nevojën për "të shkëmbyer informacion bazuar në MKR me vendet e origjinës dhe destinacionit". Rekomandimet specifike në lidhje me bashkëpunimin dhe koordinimin mes aktorëve përfshijnë:

10. ***Të rritet bashkëpunimi dhe koordinimi mes aktorëve kombëtarë në përgjigje të trafikimit***

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- BH, Kosovë: të përmirësohet koordinimi mes aktorëve kyç të përfshirë në identifikim dhe referim
- Ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë: të qartësohen rolet drejtuese

dhe përgjegjësitë specifike të çdo aktori në MKR
- Mal i Zi: të prezantohet një mekanizëm kombëtar referimi operacional dhe të identifikohen rolet dhe procedurat për të gjithë stafin e linjës së parë që mund të kontaktojë personat e trafikuar
- Serbi: të rregullohet dhe formalizohet pozicioni i Koordinatorit Kombëtar

11. ***Të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar nëpërmjet zbatimit të përmirësuar dhe institucionalizimit të MKR rajonal, forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ekipet e përbashkëta hetimore***

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- BH, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia: të forcohen variantet aktuale dhe të mëparshme të MKR
- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: të qartësohen SOP për shkëmbimin e informacioni në nivel ndërkombëtar dhe ndarjen e praktikave të mira ekzistuese në këtë fushë

IV. Procese të drejtësisë penale

Në mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor, të intervistuarit identifikojnë një gamë çështjesh në lidhje me trajtimin me shërbimeve të personave të trafikuar sipas kuadrit ligjor, dhe mënyrën e zbatimit të tij në çdo vend. Të dhënat e studimit theksojnë mënyrën sesi (1) zbatimi i ligjeve të rëndësishme është kontradiktor; (2) viktimat shpesh nuk mbështeten si duhet gjatë proceseve ligjore dhe në disa raste, trajtohen keq nga aktorët e drejtësisë penale; dhe (3) proceset ligjore nuk japin dëmshpërblim për viktimat. Rekomandimet specifike në lidhje me sektorin e drejtësisë penale përfshijnë:

12. ***Të forcohen kapacitetet e aktorëve të drejtësisë penale për të mbrojtur viktimat e trafikimit dhe ndjekur trafikantët në plotësinë e ligjit***

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- BH, Mal i Zi: të përmirësohen njohuritë dhe të ndërgjegjësohen gjyqtarët, prokurorët, hetuesit dhe avokatët për ekzistencën, shenjat dhe të drejtat e viktimave
- BH, Mal i Zi: të ofrohet trajnim për të gjithë profesionistët përgjegjës për dhënien e ndihmës dhe të merren masa mbrojtëse për personat e trafikuar

13. ***Të forcohet mbështetja për viktimat në proceset e drejtësisë penale, përfshirë zbatimin e plotë të periudhës së reflektimit, mbështetjen gjatë procesit ligjor dhe ndihmën për të kërkuar dëmshpërblim***

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- Shqipëri, Serbi: të prezantohen nene specifike në kodin e procedurës penale për dëmshpërblimin e viktimave dhe të përcaktohet fondi shtetëror

për kompensimin e personave që kanë qenë objekt trafikimi
- Mal i Zi: të zbatohen masa shtesë për të siguruar informimin, mbrojtjen dhe ndihmën e duhur të personave të trafikuar gjatë hetimit, fazës para gjykimit dhe gjykimit
- Serbi: të merren masat e duhura në mbrojtje të viktimave dhe të trajnohen anëtarët e Njësisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve për mënyrën e të punuarit dhe mbështetjen e tyre

V. Angazhimi i qeverisë dhe alokimi i burimeve

Të dhëna të sondazhit dhe të intervistave theksojnë nevojën "për rritje të vullnetit politik dhe angazhimit të qeverive" dhe sidomos rritje të financimit për OJQ-të dhe institucionet që mbështesin personat e trafikuar. Ato vërejnë që shumica e ndihmës financiare për të mbështetur viktimat deri tani është dhënë nga donatorë të huaj, edhe kur qeveria ka marrë angazhimin për të siguruar këtë financim. Ata theksojnë që "ajo që nevojitet është angazhimi i autoriteteve të Ballkanit Perëndimor, të pa kushtëzuara nga ndonjë angazhim i ardhshëm dy/tre/apo shumë palësh me natyrë politike apo tjetër" për t'i dhënë fund trafikimit. Rekomandime specifike në lidhje me angazhimin e qeverisë përfshijnë:

14. Të rritet financimi për programet kundër TP, sidomos për OJQ-të dhe institucionet që mbështesin personat e trafikuar

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- Shqipëri: të sigurohen fonde të mjaftueshme shtetërore për të siguruar cilësinë e shërbimeve
- BH: të përmirësohet aksesi dhe disbursimi i fondeve nën "buxhetin e ndërhyrjes" për të mbuluar ndihmën afatshkurtër dhe mbrojtjen për rastet e trafikimit
- Kosovë: të identifikohen mënyra për të ndarë koston në lidhje me kujdesin, ndihmën dhe riintegrimin e personave ndërmjet ministrive dhe agjencive qeveritare me interes/përgjegjësi për të luftuar TP
- Kosovë: të rritet mbështetja financiare për OJQ që ofrojnë strehëza dhe shërbime për viktimat, duke përdorur alokimin e buxhetit ose kontributet në natyrë (toka, ambiente etj)
- Kosovë: të prezantohet koncepti i sipërmarrjeve sociale për të mundësuar që OJQ-të të marrin fonde nga qeveria për veprimtari që gjenerojnë të ardhura me synim punësimin për sektorët e marxhinalizuar dhe/ose të pafavorizuar të komunitetit
- Kosovë: të caktohet një këshilltar për të lehtësuar realizimin dhe menaxhimin e Fondeve për Ndihmën për Gjurmim dhe Rimëkëmbje për personat që kanë qenë objekt trafikimit
- Mal i Zi: të garantohet që të gjitha palët nënshkruese të Memorandumit të Bashkëpunimit përmbushin përgjegjësitë e tyre për ofrimin e ndihmës financiare për komunitet në rrezik
- Kosovë: të nxirren udhëzime administrative që të mundësojnë kontribute

bamirësie nga biznese private, të përjashtuara nga tatimet, në ndihmë të OJQ-ve që ofrojnë strehëza dhe shërbime për viktimat
- Serbi: të garantohet më shumë vullnet politik në luftën kundër TP duke përcaktuar alokimin e buxhetit

Të dhëna të sondazhit dhe të intervistave theksojnë nevojën "për rritje të vullnetit politik dhe angazhimit të qeverive" dhe sidomos rritje të financimit për OJQ-të dhe institucionet që mbështesin personat e trafikuar. Ato vërejnë që shumica e ndihmës financiare për të mbështetur viktimat deri tani është dhënë nga donatorë të huaj, edhe kur qeveria ka marrë angazhimin për të siguruar këtë financim. Ata theksojnë që "ajo që nevojitet është angazhimi i autoriteteve të Ballkanit Perëndimor, të pa kushtëzuara nga ndonjë angazhim i ardhshëm dy/tre/apo shumë palësh me natyrë politike apo tjetër" për t'i dhënë fund trafikimit. Rekomandime specifike në lidhje me angazhimin e qeverisë përfshijnë:

15. Të rritet financimi për programet kundër TP, sidomos për OJQ-të dhe institucionet që mbështesin personat e trafikuar

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- Shqipëri: të sigurohen fonde të mjaftueshme shtetërore për të siguruar cilësinë e shërbimeve
- BH: të përmirësohet aksesi dhe disbursimi i fondeve nën "buxhetin e ndërhyrjes" për të mbuluar ndihmën afatshkurtër dhe mbrojtjen për rastet e trafikimit
- Kosovë: të identifikohen mënyra për të ndarë koston në lidhje me kujdesin, ndihmën dhe riintegrimin e personave ndërmjet ministrive dhe agjencive qeveritare me interes/përgjegjësi për të luftuar TP
- Kosovë: të rritet mbështetja financiare për OJQ që ofrojnë strehëza dhe shërbime për viktimat, duke përdorur alokimin e buxhetit ose kontributet në natyrë (toka, ambiente etj)
- Kosovë: të prezantohet koncepti i sipërmarrjeve sociale për të mundësuar që OJQ-të të marrin fonde nga qeveria për veprimtari që gjenerojnë të ardhura me synim punësimin për sektorët e marxhinalizuar dhe/ose të pafavorizuar të komunitetit
- Kosovë: të caktohet një këshilltar për të lehtësuar realizimin dhe menaxhimin e Fondeve për Ndihmën për Gjurmim dhe Rimëkëmbje për personat që kanë qenë objekt trafikimit
- Mal i Zi: të garantohet që të gjitha palët nënshkruese të Memorandumit të Bashkëpunimit përmbushin përgjegjësitë e tyre për ofrimin e ndihmës financiare për komunitet në rrezik
- Kosovë: të nxirren udhëzime administrative që të mundësojnë kontribute bamirësie nga biznese private, të përjashtuara nga tatimet, në ndihmë të OJQ-ve që ofrojnë strehëza dhe shërbime për viktimat
- Serbi: të garantohet më shumë vullnet politik në luftën kundër TP duke përcaktuar alokimin e buxhetit

VI. Qëndrime që pengojnë reagimin ndaj trafikimit të personave

Vlerësimi i nevojave ngre disa probleme në lidhje me qëndrimet që duket se pengojnë zhvillimin dhe zbatimin e reagimeve të efektshme ndaj TP. Këto qëndrime janë gjetur në lidhje me:

- Motivimin për të identifikuar raste të trafikimit, siç tregohet nga citimi "kanë kapacitetet, por nuk u intereson"
- Tendenca e disa aktorëve kyç për të konsideruar disa forma të trafikimit si praktikë kulturore, kryesisht lypjen nga fëmijët dhe martesat e detyruara
- Damka dhe diskriminimi në komunitete kundër viktimave të trafikimit për shfrytëzim për qëllime seksuale
- Fakti që aktorët kyç dhe viktimat e trafikimit për shfrytëzimin për qëllime pune nuk e shohin këtë përvojë si rast trafikimi
- Dështim i raportuar i qeverive të rajonit për të alokuar buxhet të mjaftueshëm për trafikimin e personave, edhe kur e kanë marrë angazhimin për të luftuar këtë fenomen

Trajtimi i qëndrimeve dhe normave shoqërore është një fushë tepër delikate dhe kërkon angazhim afatgjatë për zhvillimin e alternativave, faktorëve që çojnë në Hezitimin e financuesve të jashtëm sidomos në mbështetje të programeve që trajtojnë këto çështje. Megjithatë, është e vështirë të shihet sesi mund të arrihet progres pa trajtuar disa nga këto pengesa. Rekomandimi specifik përfshin sa më poshtë:

- Të përfshihen veprimtari për të trajtuar qëndrimet të cilat pengojnë reagimin ndaj trafikimit në trajnime përkatëse, fushata ndërgjegjësimi dhe takime për forcimin e aftësive[2]

Përfshirja e veprimtarive që nxjerrin dhe trajtojnë qëndrimet negative dhe stereotipet e personave që kanë qenë objekt trafikimi nuk kërkon nivel të lartë burimesh. Burime të rëndësishme janë shpenzuar tashmë për veprimtari ndërgjegjësimi pa ndonjë ndikim apo efekte të provuara. Informatorët do të donin që të shikonin burimet e shpenzuara për fushata që mund të trajtojnë llojet e qëndrimeve negative për viktimat si migrantët e parregullt ose kriminelët të cilat pengojnë zbatimin e plotë të reagimit të efektshëm ndaj trafikimit. Konsideratë mund t'i jepet përfshirjes së ekspertizës së duhur të komunikimit dhe riorientimit të përpjekjeve në fushata që shkojnë përtej thjesht përkufizimit të trafikimit. Fushatat duhet të fokusohen në përpjekje më të mëdha për të përmirësuar të kuptuarin kulturor të TP, për të rregulluar qëndrimet negative ndaj personave që kanë qenë objekt i TP dhe për të ulur tolerancën për praktikat që kanë çuar në TP, ose që kanë kontribuar për TP.

2 Ky rekomandim u rishikua pas komenteve që u morën në dhe pas takimit të aktorëve.

Rekomandime mbështetëse sipas vendeve përfshijnë:

- Shqipëri: të ndërgjegjësohen viktimat/të kuptojnë që ato janë viktima të një krimi dhe që nuk kanë faj për atë që ju ka ndodhur
- Shqipëri, BH: të trajtohet dhe të përmirësohet qëndrimi i policisë kufitare, gjyqtarëve, dhe prokurorëve ndaj personave që kanë qenë objekt trafikimi
- Mal i Zi: të përfshihen module trajnimi me qëllim ndryshimin e qëndrimeve negative dhe paragjykimeve në lidhje me viktimat e trafikimit

Vlerësimi i nevojave:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor

REFERENCA

Shqipëri, Marrëveshje Bashkëpunimi

2012 Mekanizmi shqiptar i referimit për identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit të personave, Tiranë

Shqipëri, Ministria e Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave,

2011 Procedurat Standarde të Punës (SOP) për identifikimin dhe referimin e Viktimave të Trafikimit, Tiranë

Shqipëri, Koalicioni Shqiptar për strehëzat e anti-trafikimit (KKSA)

2011 Raport për kontributin e KKSA në identifikimin dhe ndihmën për viktimat e trafikimit, Tetor 2009 – Shtator 2010, Tiranë

Shqipëri, Ministria e Brendshme

2011 Plani Kombëtar i Veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe plani kombëtar i veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtja e fëmijëve, viktima të trafikimit, 2011-2013, Tiranë

Shqipëri, Ministria e Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave

2011 Procedura Standarde të Punës për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, Tiranë

2012 Raport për planin kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të personave, Janar- Dhjetor 2012, Tiranë

Shqipëri, Koalicioni Kombëtar për Strehëzat e Anti-trafikimit (KKSA)

2010 Kontributi i KKSA për identifikimin dhe ndihmën për viktimat e trafikimit, Tiranë

Balkan Act Now (projekt i financuar nga BE)

2013 Strategjia e Zbatimit 2013-2014, dokument rajonal

2013 Analiza e Situatës së Trafikimit të Qenieve Njerëzore, dokument rajonal

Bosnjë-Hercegovina, Këshilli i Ministrave

2012 Strategjia në fushën e migracionit dhe azilit dhe Plani i Veprimit për periudhën 2012-2015, Sarajevë

2013 Strategjia për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Bosnjë Hercegovinë dhe Plani i Veprimit, 2013-2015, Sarajevë

Bosnjë-Hercegovina, Koordinatori i Shtetit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm në Bosnjë Hercegovinë

2012 Raporti për statusin e trafikimit të qenieve njerëzore në Bosnjë Hercegovinë dhe raporti për zbatimin e planit të veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Bosnjë Hercegovinë për vitin 2012, Sarajevë

Këshilli i Europës, Sekretariati i Këshillit të Europës, Konventa për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA dhe Komiteti i Palëve) Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Çështjeve Ligjore

2011 Raport në lidhje me zbatimin nga Shqipëria të (GRETA) Konventës së Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Strasburg

2012 Raport në lidhje me zbatimin nga Mali i Zi të (GRETA) Konventës së Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Strasburg

2013 Raport në lidhje me zbatimin nga Serbia të (GRETA) Konventës së Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Strasburg

2013 Raport në lidhje me zbatimin nga Bosnjë Hercegovina të (GRETA) Konventës së Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Strasburg

Kroaci, Razbor

2012 RAPORT I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në raste të trafikimit në Europën Juglindore (TRM-II), Zagreb, Përgatitur nga: ICMPD,
Zbatuar nga:Razbor Ltd., Zagreb , Vlerësues: Ivana Novoselec dhe Andrijana Parić

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Program rajonal për Mbrojtjen Sociale dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore

2012 Dimensioni Social i Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor, Shkup, Maqedoni

Komisioni Europian

2013 Progres Raporti 2013 për Shqipërinë, Bruksel

2013 Progres Raporti 2013 për Serbinë, Bruksel

2013 Progres Raporti 2013 për Maqedoninë, Bruksel

2013 EUROSTAT, Trafikimi i Qenieve Njerëzore, Botimi 2012, KS-RA-09-001-EN-C

Metodologji dhe dokumente pune ISSN 1977-0375

FRONTEX, Agjencia Europiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian

2013 Analiza Vjetore e Riskut në Ballkanin Perëndimor, Njësia e Analizës së Riskut, Varshavë

2013 FRAN, tremujore, Prill-Qershor 2013, Njësia e Analizës së Riskut, Varshavë

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

2004 Modele dhe trende të ndryshueshme të trafikimit të personave në rajonin e Ballkanit- Vlerësim i kryer në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë,

Provincën e Kosovës, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Moldavisë, ISBN 92-9068-205-1

© 2004 Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)

2011 Të dhëna të rasteve për trafikimin e personave: shifra dhe trende botërore, Gjenevë

Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit

2007 Dëgjimi i viktimave, përvojat e identifikimit, kthimit dhe ndihmës në Europën Juglindore, Vjenë

2012 Rruga përpara për përcaktimin e një mekanizmi referimi ndërkombëtar efektiv- Raport bazuar në përvojat e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore në Europën Juglindore, Vjenë ISBN:978-3-900411-76-3

2013 Forcimi i Kapaciteteve për të luftuar trafikimin për shfrytëzimin e punës – Përshkallëzimi i luftës kundër trafikimit për shfrytëzimin e punës

Kosovë, Koalicioni Kosovar i Strehëzave

2011 Strategjia dhe Plani i Veprimit të Koalicionit Kosovar të Strehëzave, Prishtinë

Kosovë, Ministria e Brendshme

2011 Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2011-2014, Prishtinë

Kosovë, Ministria e Brendshme

2008 Procedurat Standarde të Punës (SOP) për viktimat e trafikimit në Kosovë, Prishtinë Gjendet në: https://antitrafikimi.rks-gov.net/CMS_EN/Images/SOPKosovo.pdf

2011 Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Kosovë, gjendet në: https://antitrafikimi.rks-gov.net

Maqedoni, Ministria e Brendshme

2013 Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migracionit të paligjshëm në Republikën e Maqedonisë, 2013-2016, Shkup

Maqedonia, Komisioni Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

2010 Procedurat Standarde të Punës për trajtimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, Shkup

Qendra Rajonale MARRI

2012 Dokument i MARRI-t për Migracionin, Shkup

Mali i Zi, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

2012 Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2012-2018

ODIHR dhe Këshilli i Europës

2009 Rishikim i Legjislacionit në Lidhje me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Bosnjë Hercegovinë, OSBE

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE)

2009 Trafikimi i qenieve njerëzore dhe përgjigja e sistemit vendor të drejtësisë penale,

2011 Trafikimi i qenieve njerëzore për qëllim të shfrytëzimit në punës, Sarajevë

2012 Raport nga Përfaqësuesja e Posaçme dhe Koordinatorja e OSBE-së për Luftën Kundër trafikimit të Qenieve Njerëzore, pas vizitës së saj në Bosnjë Hercegovinë, 12-14 qershori 2012

UNICEF, Terres Des Hommes

2006 Masa për të parandaluar trafikimin e fëmijëve në Europën Juglindore, Vlerësim Paraprak (Shqipëri, Moldavi dhe Kosovë)

Serbi, Qeveria e Serbisë

2006 Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 05 nr:021-10196/2006Beograd, 7 dhjetor 2006.

2013 Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2013-2018 (projekt propozim)

2013 Projekt Plan veprimi për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2013-2014 (projekt propozim)

Serbi, Kryqi i Kuq

2011 Studim për mësimet e nxjerra, Programi Anti-Trafikimit në Serbi 2009-2011 zbatuar nga Kryqi i Kuq i Serbisë, Partneritet i Kryqit të Kuq mes Kryqit të Kuq të Serbisë, Kryqit të Kuq të Danimarkës dhe Kryqit të Kuq të Norvegjisë, Beograd

Serbi, ASTRA- Veprim Anti-Trafikimit

2011 TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE NË REPUBLIKËN E SERBISË, Raport për periudhën 2000-2010, Beograd

Serbi, Dr Dostic, S. dhe Gocic, S.

2013 TIP in Serbia as a criminal phenomenon (TP në Serbi si një fenomen kriminal), revista Bezbednost, e gjeni në http://prezentacije.mup.gov.rs/upravazaobrazovanje/aktuelno/Bezbednost%203-2013.pdf

UNODC

2012 Raport për Trafikimin Global në lidhje me Trafikimin e Personave, © Kombet e Bashkuara, Dhjetor 2012. Të gjitha të drejtat të rezervuara. ISBN: 978-92-1-130309-4, e-ISBN: 978-92-1-055896-9, Publikim i Kombeve të Bashkuara, Sales No. E.13.IV.1

Departamenti Amerikan i Shtetit

2013 Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Trafikimin e Personave http://ëëë.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/2013/?utm_source=Subscribers&utm_campaign=35f27bd04cTrafficking_Bulletin_Issue_9_July_20137_22_2013&utm_medium=email&utm_term=0_1002a3b355-35f27bd04c-92744149

Brunovskis, A. dhe Surtees, S,

2007 Leaving the past behind? When victims decline assistance. (Lënia pas e së shkuarës? Kur viktimat refuzojnë ndihmë) NEXUS (Vienë) & Fafo (Oslo)

Limanowska, B

2004 Trafficking in Human Beings in South East Europe (Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Europën Juglindore), Publikuar nga: UNICEF, UNOHCHR dhe OSBE/ODIHR2004

Preskill, H. and N. Jones

2009 A Practical Guide for Engaging Stakeholders in Developing Evaluation Questions. (Udhërrëfyes praktik për Përfshirjen e Aktorëve në Zhvillimin e Pyetjeve të Vlerësimit) Princeton, NJ: Robert Wood Johnson Foundation

Scarabelli, D.

2014 Cleaning the Balkan Route: Elements of Police Cooperation in Serbia (Pastrimi i rrugës së Ballkanit: Elemente të Bashkëpunimit Policor në Serbi), Gjendet në: http://cenaa.org/analysis/cleaning-the-balkan-route-elements-of-police-cooperation-in-serbia/

Surtees, R.

2010 Monitoring anti-trafficking re/integration programmes. A manual, (Monitorimi i programeve të antitrafikimit/integrimit. Manual) Fondacioni The King Baudouin, Bruksel

Pati R., Policing across borders (Policimi përmes kufijve)

2013 Combating human trafficking through transnational law enforcement cooperation: the case of SEE, (Lufta kundër trafikimit të Qenieve Njerëzore nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar të agjencive të zbatimit të ligjeve) faqe 89-122, Springer New York, Print ISBN 978-1-4419-9544-5

SHTOJCAVE

Zhvillimi i Kapaciteteve për Menaxhimin e Migracionit

Shtojca A
Termat e Referencës (ToR)

Konsultent/ë që do të kryejnë Studimin për Vlerësimin e Nevojave:
Situata Rajonale e Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor

Nr i Njoftimit të Vendit Vakant:	N/A
Vendndodhja e Pozicionit:	Shkup ose me bazë në vendin e tyre
Titulli i Pozicionit:	Studiues (dy pozicione)[1]
Lloji i Emërimit:	Konsulent afatshkurtër
Mbulimi i studimit:	Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Kosova e administruar nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia
Kohëzgjatja:	7 muaj
Afati i aplikimit:	10 shtator 2013

1. INFORMACION PREZANTUES

Për shkak të vendndodhjes gjeografike dhe situatës ekonomike relative të rajonit krahasuar me fqinjët e tij të Bashkimit Europian, vendet[2] e Ballkanit Perëndimor (BP) kanë histori si vende origjine, tranziti dhe destinacioni për viktimat e trafikut të qenieve njerëzore (VT). Ndërsa kufijtë aktualë të Bashkimit Europian janë shtrirë duke përfshirë vende që janë në rajonin e BP dhe në kufi me rajonin e BP, fluksi migrator i parregullt është zhvendosur gjithashtu, ndaj për rrjedhojë shumë vende të PB po hasen me hyrjen e migrantëve të parregullt, si edhe migrantëve që vijnë nga vende të reja origjine. Këto flukse të reja migratore kontribuojnë në vulnerabilitetin e disa grupeve si edhe mund të paraqesin një farë risku për sigurinë. Në këtë drejtim, është rritur shqetësimi që VT as nuk janë identifikuar si duhet, as nuk i janë referuar agjencive kombëtare brenda rajonit. Për rrjedhojë, shkalla e situatës së trafikimit të qenieve njerëzor mund të jetë tepër e nën-përfaqësuar nga vendet e rajonit dhe kështu të mos jetë prioritizuar si duhet nga qeveritë dhe donatorët. Në përfundim, shumë vende të BP kanë filluar procesin e përafrimit të kuadrit të tyre ligjor për të plotësuar kërkesat e Bashkimit Europian dhe pavarësisht faktit që ato të gjitha janë në nivele të ndryshme progresi, nevojitet stimulim dhe mbështetje nga jashtë për të kapur ritmin e standardeve dhe kërkesave të BE-së. Për shkak të betejës afatgjatë me trafikimin e personave (TP), hyrja në rajon e migrantëve që vijnë nga jashtë rajonit dhe zbatimi i legjislacionit të ri kundër trafikimit (KT), nevoja për një analizë gjithëpërfshirëse të situatës të TP është kritike për të vlerësuar nevojat aktuale në rajon.

2. OBJEKTIVI I STUDIMIT

Objektivi kryesor i studimit është që të gjenerojë provat e nevojshme për të përmirësuar legjislacionin aktual dhe programet që trajtojnë çështjen e Trafikimit të Personave (TP) në Ballkanin Perëndimor. Projekti konsiston në një vlerësim të nevojave të mekanizmave ekzistuese të KT në rajon dhe vlerëson situatën aktuale të TP sidomos **për identifikimin dhe referimin e viktimave (të mundshme) të trafikimit të qenieve njerëzore** me qëllim që të përcaktojë:

1. Cilat janë aspektet e përpjekjeve KT në mbarë rajonin që duhet të trajtohen urgjentisht dhe
2. Mundësitë për bashkëpunimin rajonal për çështje të KT

Për të realizuar plotësisht studimin, ekipi kërkimor do të punojë nga afër me përfaqësues të IOM-it në misionet e synuara si edhe me zyrën e Koordinatorit të Anti-trafikimit në BE, GRETA të KE, USAID dhe J/TIP.

---

[1] IOM kërkon njëekip kërkimor që të kryejë vlerësimin e nevojave. Ekipi kërkimor do të përfshijë dy studiues: një udhëheqës dhe një mbështetës. Studiuesi udhëheqës do të ndihmojë dhe do të mbështesë studiuesin udhëheqës në zbatimin e të gjitha veprimtarive dhe do të kontribuojë në mënyrë aktive për arritjen e objektivave të studimit.

[2] Për qëllim të këtij propozimi, rajoni i Ballkanit Perëndimor përfshin: Shqipërinë, Bosnjë Hercegovinën, Kosovën e administruar nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë. Kroacia nuk përfshihet në këtë propozim sepse vendi është bërë së fundimi Shtet Anëtar i Bashkimit Europian.

3. DETYRAT

3.1 Studiuesi udhëheqës (individ ose subjekt)

a. Zhvillon **metodologjinë e duhur të kërkimit** për të arritur objektivin e shprehur në Pjesën 2 dhe rezultatet e përcaktuara në Pjesën 4;
b. Kryen **rishikimin** e legjislacionit aktual, strategjive/plan veprimeve të qeverisë, politikave dhe programeve kyçe të rëndësishme për KT, dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit rajonal në lidhje me çështje të KT, me fokus identifikimin dhe referimin e viktimave (të mundshme) të trafikimit të qenieve njerëzore.
c. Kryen **analizën krahasuese** të statistikave lokale/kombëtare/qeveritare në lidhje me VT të identifikuara me statistika nga burime të jashtme, përfshirë ato të mbledhura nga Institucionet Europian dhe Shtetet Anëtare të BE-në në lidhje me VT të identifikuara nga ose që kanë kaluar tranzit në rajonin e BP; sidomos në lidhje me mekanizmat e referimit (p.sh Mekanizmi Ndërkombëtar i Referimit) nga SHA të BE-së në vendet e BP.
d. Zhvillon dhe kryen **sondazhe sasiore dhe cilësore** drejtuar grupeve të synuara specifike (p.sh zyrtarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe përfituesve të programeve ekzistuese) me qëllim identifikimin dhe përfitimin e VT.
e. Zhvillon **intervista të detajuara** me nëpunës, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë me VT dhe VT të identifikuar përfitues aktualë dhe të mundshëm. Metodat e autorizimit do të përdoren për të përfshirë aktorë të interesuar në identifikimin dhe shënjestrimin e boshllëqeve dhe sfidave më të rëndësishme dhe thelbësore që duhet të trajtohen, si edhe pikat e forta dhe asetet e pranuara.
f. Përfshin të gjitha detyrat e sipërpërmendura në përgatitjen e një **Raporti Studimi** (në anglisht) që bën një prezantim të të gjitha të dhënave cilësore dhe sasiore dhe analizë të tyre, përfshirë rekomandimet. Raporti duhet të jenë në përputhje me Udhëzimet e IOM për Publikimet.
g. Paraqet gjetjet e studimit tek të gjithë aktorët e interesuar dhe politik-bërësit në një **takim rajonal vlerësimi.**

3.2 Studiuesi mbështetës

a. Është pjesë e Ekipit Kërkimor dhe mbështet zbatimin e metodologjisë së zhvilluar nga Studiuesi Udhëheqës.
b. Mbështet Studiuesin Udhëheqës në analizimin e sondazheve cilësore dhe sasiore që janë kryer
c. Mbështet Studiuesin Udhëheqës në kryerjen e intervistave të detajuara me nëpunës, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë me VT dhe përfitues VT të identifikuar, aktual dhe të mundshëm, siç është rënë dakord me Studiuesin Udhëheqës
d. Bashkëpunon me misionet e IOM-it në terren dhe me homologët e rëndësishëm me qëllim që të mbështesë zbatimin e metodologjisë së kërkimit
e. Ndihmon Studiuesin Udhëheqës për përfundimin e Raportit të Studimit, sidomos rishikimin dhe redaktimin.

4. REZULTATET E PRITSHME

Kryerja e detyrave të mësipërme do të çojë në **rezultatet** e mëposhtme:

a. **Raport Studimi gjithëpërfshirës** që analizon mekanizmat ekzistues KT që përdor çdo vend dhe tregon nevojat dhe mundësitë për bashkëpunim rajonal për t'u përfshirë në veprimtaritë KT. Raporti do të përmbajë gjithashtu një paraqitje të ndryshimeve të fundit në tendencat e TP në rajon. Fokusi i raportit janë sfidat, boshllëqet dhe sugjerimet që lidhen me përmirësimin e identifikimit dhe referimit të viktimave (të mundshme) të trafikimit të qenieve njerëzore.
b. **Një listë me rekomandime** për politik-bërësit që të trajtojnë nevojat dhe boshllëqet në përpjekjet për KT të identifikuara nga studimi, si edhe fushat në të cilat mund të zhvillohen kapacitetet lokale dhe rajonale për t'u përfshirë më mirë në përpjekjet KT.
c. Prezantimi i një raporti përfundimtar gjithëpërfshirës dhe lista e rekomandimeve për aktorët e interesuar dhe politik-bërësit në një takim rajonal vlerësimi të fokusuar në përfshirjen e aktorëve të interesuar dhe politik-bërësve dhe autorizimi për veprime të mëtejshme KT.

Këto rezultate të projektit duhet të shërbejnë si bazë për projekte të ardhshme në KT në rajon dhe të mundësojnë financim nga donatorë që kanë investuar më përpara në rajon. Identifikimi i qartë i problemeve të vazhdueshme dhe zhvillimi i trendeve të reja në TP do të shërbejnë si platformë prej të cilës mund të propozohen projekte të reja si edhe fushat në të cilat IOM mund të ndihmojë më tej me forcimin e kapaciteteve.

5. PERIUDHA KOHORE E KONSULTIMIT

7 muaj: Tetor 2013- Prill 2014

6. AFATI KOHOR, ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Një plan i detajuar punë që tregon çdo veprimtari, personin/personat përgjegjës dhe afatin kohor të nevojshëm për realizim.

Veprimtaria	Pala përgjegjëse	Periudha kohore						
		Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5	Muaji 6	Muaji 7
Rishikim i legjislacionit aktual, strategjive dhe planeve të veprimit të qeverisë dhe dokumenteve dhe raporteve të tjera të rëndësishme	Studiuesi udhëheqës dhe mbështetës							
Krahasim statistikor ndërmjet të dhënave me burim lokal dhe jashtë rajonal në lidhje me VT të identifikuara	Studiuesi udhëheqës dhe mbështetës							
Zhvillimi dhe rishikimi i sondazheve të shpërndara tek qeveria, shoqëria civile, përfituesit, VT	Studiuesi udhëheqës dhe mbështetës dhe IOM							
Intervistim i detajuar i personave kyç të identifikuar nëpërmjet sondazheve	Studiuesi udhëheqës dhe mbështetës dhe IOM							
Pjesëmarrja dhe raportimi në aktivitete të rëndësishme rajonale të përfaqësuesve të qeverisë	IOM; Studiuesi udhëheqës dhe mbështetës	Sipas rastit- rregullisht						
Pjesëmarrja në aktivitetet e shoqërisë civile, aktivitete koordinimi OJQ/Qeveri dhe koalicioni të OJQ-ve	IOM; Studiuesi udhëheqës dhe mbështetës	Sipas rastit- rregullisht						
Analizimi i të dhënave dhe përpilimi i rekomandimeve përfundimtare	IOM; Studiuesi udhëheqës dhe mbështetës							
Shkrimi dhe finalizimi i Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve	IOM; Studiuesi udhëheqës dhe mbështetës							
Organizimi i një takimi rajonal vlerësimi	IOM; partnerë të projektit, pjesëmarrja e Studiuesit udhëheqës							

7. KUALIFIKIMET E KËRKUARA

7.1 Studiuesi udhëheqës (individ ose subjekt)

Studiuesi udhëheqës/konsultenti pritet që të ketë kompetencat dhe ekspertizën e mëposhtme:

7.1.1 Eksperiencë

- Të paktën 5 vjet përvojë përkatëse kërkimore, sidomos në çështje kundër trafikimit në Europën juglindore, lindore dhe Azinë qendrore; përvoja e mëparshme e ngjashme në Ballkanin Perëndimor do të konsiderohet avantazh;
- Aftësi shumë të mira hartimi. Publikime të mëparshme për trafikimin e qenieve njerëzore/migracionin;
- Përvojë të gjerë analitike dhe kërkimore.

7.1.2 Edukimi

- Diplomë universitare/pasuniversitare, sidomos në shkencat sociale, specializimi në çështje të migracionit ose trajnim i njëjtë do të konsiderohet aset

7.1.3 Kompetenca dhe aftësi

- të kuptojë shumë mirë problemin e studimit si edhe programet/politikat ndërkombëtare dhe rajonale;
- të ketë njohuri për kontekstin lokal në lidhje me problemin e studimit;
- të ketë njohuri për literaturën akademike dhe kërkimore për këtë çështje ose të jetë i aftë të nxjerrë ekspertizën nga të tjerët;
- të jetë përditësuar me zhvillimet për problemin e studimit dhe proceset ekzistuese të rëndësishme kundër trafikimit në nivel global dhe rajonal;
- të jetë i aftë të kuptojë qëllimet dhe modalitetet/ metodologjinë e kërkimit;
- të ketë aftësi shumë të mira intervistimi dhe dëgjimi;
- të flasë dhe të shkruajë shumë mirë anglisht;
- Microsoft Office

7.1.4 Cilësi personale dhe kërkesa të tjera

- Objektiv dhe analitik
- të shtyrë nga rezultati
- me ndjenjë e fortë angazhimi
- të efektshëm
- i aftë për punën nën presionin e kohës
- me historik të provuar të dorëzimit në kohë
- aftësi të mira ndërpersonale
- sensitiv ndaj kulturës. Aftësia për të punuar me efektivitet dhe në harmoni në ekip dhe me kolegë nga kultura të ndryshme dhe formime profesionale të ndryshme

7.2 Studiues mbështetës

Studiuesi mbështetës/konsultenti pritet që të ketë kompetencat dhe ekspertizën e mëposhtme:

7.2.1 Përvoja

- Të paktën 5 vjet përvojë përkatëse kërkimore, sidomos në çështje kundër trafikimit në Europën juglindore, lindore dhe Azinë qendrore; përvoja e mëparshme e ngjashme në Ballkanin Perëndimor do të konsiderohet avantazh;
- Aftësi shumë të mira hartimi. Publikime të mëparshme për trafikimin e qenieve njerëzore/migracionin;

7.2.2 Edukimi

- Diplomë universitare/pasuniversitare, sidomos në shkencat sociale, specializimi në çështje të migracionit ose trajnim të njëjtë do të konsiderohet aset

7.2.3 Kompetenca dhe aftësi

- të kuptojë shumë mirë problemin e studimit si edhe programet/politikat ndërkombëtare dhe rajonale;
- të ketë njohuri për kontekstin lokal në lidhje me problemin e studimit;
- të ketë njohuri për literaturën akademike dhe kërkimore për këtë çështje ose të jetë i aftë të nxjerrë ekspertizën nga të tjerët;
- të jetë përditësuar me zhvillimet për problemin e studimit dhe proceset ekzistuese të rëndësishme kundër trafikimit në nivel global dhe rajonal;
- të jetë i aftë të kuptojë qëllimet dhe modalitetet/ metodologjinë e kërkimit;
- të ketë aftësi shumë të mira intervistimi dhe dëgjimi;
- të flasë dhe të shkruajë shumë mirë anglisht;
- Microsoft Office

7.2.4 Cilësi personale dhe kërkesa të tjera

- Objektiv dhe analitik
- të shtyrë nga rezultati
- me ndjenjë e fortë angazhimi
- të efektshëm
- i aftë për punën nën presionin e kohës
- me historik të provuar të dorëzimit në kohë
- aftësi të mira ndërpersonale
- sensitiv ndaj kulturës. Aftësia për të punuar me efektivitet dhe në harmoni në ekip dhe me kolegë nga kultura të ndryshme dhe formime profesionale të ndryshme

8. RREGULLORJA E RAPORTIMIT

Është thelbësore që aplikanti t'i japë IOM raporte për progresin e detyrës së studimit. Në propozimin e studimit të hartuar nga aplikanti, qëllimi dhe koha e raportit të progresit duhet të përcaktohet qartë.

9. MARRËVESHJA E KONFIDENCIALITETIT

Studiuesi individual i organizatës së konsultencës nuk lejohet që të përdorë të dhënat e mbledhura, gjetjet e raportuara, kontributet për draftin dhe raportet përfundimtare për të vijuar me një kërkim/studim personal.

10. PROCEDURA E APLIKIMIT

Kandidatët e interesuar janë të lutur që të paraqesin CV dhe një letër përcjellëse me postë elektronike me subjektin "Studimi për Anti-Trafikimin në Ballkanin Perëndimor", në adresën e mëposhtme të postës elektronike: iomskopje@iom.int dhe në kopje tek rovienna@iom.int

Afati përfundimtar: 10 shtator 2011, ora 17:30 CET (Ora Europiane Qendrore)

Shënime:

- IOM inkurajon aplikime nga aplikante të kualifikuara femra

- Konsulenca i nënshtrohet rekrutimit lokal
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen nga IOM pas marrjes së CV-së dhe letrës përcjellëse të tyre

Vlerësimi i Nevojave për Situatën Rajonale të Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor

Shtojca B:

Mekanizmat e IOM për Identifikimin dhe Përfshirjen e Aktorëve të Ballkanit Perëndimor

I. Hyrje

Qëllimi i vlerësimit të nevojave është që të përcaktojë boshllëkun që ekziston ndërmjet "asaj që është aktualisht dhe asaj që nevojitet, tani dhe në të ardhmen" (Miller dhe Osinski 2002). Vlerësimi i nevojave ka të bëjë me përdorimin e një tërësie sistematike procedurash që ndihmon në përcaktimin e "përparësive bazuar në nevoja" për të patur vendimmarrje të informuar që synon përmirësimin e proceseve organizative, alokimin e burimeve dhe/ose trajtimin në mënyrë më të efektshme të një problemi. Vlerësimi i nevojave mund të mendohet si një "proces i kujdesshëm" për të përcaktuar (1) burimet aktuale që ekzistojnë për të trajtuar një problem specifik, (2) burimet e nevojshme për të dhënë përgjigje më të efektshme ose rezultate më të mira për problemin, dhe/ose (3) mënyrën e aplikimit të informacionit të mësuar për të identifikuar alternativat dhe për të marrë vendime për atë që duhet të bëhet (Watkins et al 2012).

Një komponent kyç i vlerësimit të nevojave është përfshirja e aktorëve të interesuar. Aktorët e interesuar janë ata individë ose organizata që kanë një lloj investimi, përvoje ose njohurie për një problem, çështje ose institucion (marrë nga CDC 2012). Shembuj të aktorëve të interesuar përfshijnë stafin e programit që punon direkt për një çështje ose me një popullsi specifike, staf administrativ dhe mbikëqyrës, staf nga institucione partnere që punojnë me të njëjtat grupe ose pjesëmarrës ose çështje, donatorë dhe mbështetës financiarë të programeve dhe institucioneve, studiues dhe vlerësues, ekspertë të pavarur, me njohuri specifike të një problemi ose çështjeje. Aktorët e interesuar në çdo program, nismë ose çështje do të varen nga ai/ajo që punon direkt në ose me programin ose çështjen dhe që pozicionohen më mirë për të patur ndikim. Ashtu si ata që përfshihen për trajtimin e një programi ose problemi, ata janë gjithashtu persona ose institucione që janë në pozicionin më të mirë për të përdorur rezultatet e vlerësimit të çështjes ose problemit në mënyrë domethënëse. Identifikimi i aktorëve të duhur për t'u përfshirë dhe angazhuar në proces është thelbësor për të kryer çdo lloj vlerësimi domethënës.

Qëllimi i përfshirjes të aktorëve të interesuar në një vlerësim është rritja e rëndësisë së rezultateve ose gjetjeve dhe forcimi i pronësisë ndaj tyre. Për shkak të pozicionit të tyre të privilegjuar si ekspertë dhe atyre që punojnë direkt me një çështje në një farë mënyrë, kontributi i aktorëve të interesuar në hartimin, qëndrimin ose përmbajtjen e një vlerësimi mund të ndihmojë në rritjen e specifikës dhe përshtatshmërisë së gjetjeve. Gjithashtu ka më shumë mundësi që të ndihmojë për të siguruar që gjetjet të mund të zbatohen në jetën reale dhe të vihen shpejt në punë për të përmirësuar programet ose për të zgjidhur problemet në mënyrë më të efektshme. Madje, mund të ndihmojë gjithashtu që këto gjetje të pasqyrojnë nevojat dhe vlerat e vetë aktorëve të interesuar. Kur aktorët përfshihen në një vlerësim, ka më shumë mundësi që gjetjet të konsiderohen si rezultat i punës së tyre. Gjithashtu ka më shumë mundësi që ata t'i shohin ato në harmoni me këndvështrimet e tyre për një çështje ose problem. Në përfundim, përfshirja e aktorëve të interesuar ndihmon në nxjerrjen e gjetjeve që janë "më të dobishme, më të rëndësishme dhe të besueshme" (Preskill dhe Jones, 2009).

Vlerësimi i Nevojave i IOM-it kundër trafikimit në Ballkanin Perëndimor Mekanizmi i Përfshirjes së Aktorëve

Më poshtë jepen dy mekanizma të krijuara për të mbështetur përfshirjen e aktorëve në Vlerësimin e Nevojave të Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) për Situatën Rajonale Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor. Mekanizmi i parë synon të ndihmojë IOM që të identifikojë një grup të rëndësishëm dhe të qëndrueshëm aktorësh për t'u përfshirë në vlerësimin e nevojave. Mekanizmi i dytë synon që të ndihmojë IOM që të përcaktojë rolet e duhura të aktorëve në vlerësimin e nevojave.

II. Matrica e përfshirjes së aktorëve

Siç sugjerohet, një komponent thelbësor i vlerësimit të nevojave është identifikimi i një grupi aktorësh që të përfshihen në proces. Shtojca A i jep IOM-it Mekanizmin I. Matrica e Përfshirjes së Aktorëve. Ai është krijuar që të ndihmojë IOM-in të identifikojë aktorët kyç që reagojnë ndaj trafikimit në Ballkanin Perëndimor, me qëllim që këta aktorë të përfshihen në vlerësimin e nevojave. Mekanizmi do të ndihmojë gjithashtu IOM-i të përcaktojë mënyrën e përfshirjes së aktorëve në vlerësimin e nevojave dhe të identifikojë burimet që mund të sjellin për studimin këta aktorë. Ai përmban hapësira për të përcaktuar se kush mund të mbështesë ose t'i rezistojë punës dhe arsyeve për këto pozicione. Meqë jo të gjithë aktorët mund të përfshihen dhe një numër i madh aktorësh mund të pengojnë dhe kompromentojnë procesin, ky mekanizëm do të ndihmojë IOM-in që të prioritizojë një grup më të mirë aktorësh që të përfshihen në vlerësimin e nevojave (Watkins et al 2012). IOM-i mund të përdorë këtë mekanizëm që të zhvillojë grupin e aktorëve që planifikon të përfshijë në vlerësimin e nevojave në mënyrë sistematike dhe të strukturuar (dhe jo të rastësishme apo sipas rastit). Ai mund të mbështesë IOM-in për zhvillimin e grupit të aktorëve më të rëndësishëm për të trajtuar pyetjet e studimit që udhëheqin vlerësimin e nevojave.

III. Plani i përfshirjes së aktorëve

Pasi IOM të identifikojë aktorët e duhur, është e rëndësishme që të përcaktojë sesi dëshiron të përfshijë aktorët në vlerësimin e nevojave. Shtojca B. i jep IOM Mekanizmin II. Plani i Përfshirjes së Aktorëve, i krijuar për të ndihmuar IOM-in që të zhvillojë një metodë të planifikuar dhe të strukturuar për përfshirjen në mënyrë më të mirë të aktorëve në vlerësimin e nevojave. Për shembull, IOM mund të përcaktojë rolet për çdo aktor dhe të përcaktojë specifikat për përfshirjen e tyre në çdo aktivitet në procesin e vlerësimit të nevojave. Ai mund të ndihmojë IOM-in gjithashtu që të ndjekë përfshirjen e aktorëve gjatë gjithë procesit, të sigurojë përfshirjen e aktorëve dhe të ndjekë nëse konstaton që aktorët nuk janë përfshirë. Qëllimi i tij është që të nxisë IOM-in të konsiderojë përfshirjen e aktorëve gjatë gjithë procesit të vlerësimit të nevojave për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me çështjen/problemin dhe studimin, si edhe për të inkurajuar përdorimin e gjetjeve dhe rezultateve të tij (Watkins et al 2012; Salentine dhe Johnson 2011).

Përpara fillimit të projektit, ekipi i studimit ka diskutuar me IOM-in qasje dhe mënyra të ndryshme për përfshirjen e aktorëve. TOR për vlerësimin e nevojave sugjerojnë përfshirjen e aktorëve në sondazhe, intervista dhe grupe pune me aktorët. Për këtë projekt ne mendojmë përfshirjen e aktorëve (të paktën) në katër pikat e mëposhtme në kohë:

1. Angazhimi i IOM-it me aktorët përpara fillimit të vlerësimit të nevojave, si motivim për vlerësimin e nevojave (përpara përfshirjes së ekipit kërkimor)
2. Angazhimi i ekipit kërkimor me një grup gjithëpërfshirës aktorësh nëpërmjet sondazhit të vlerësimit të nevojave për të identifikuar përparësitë dhe perspektivat mbi burimet ekzistuese dhe të nevojshme për t'iu përgjigjur një tërësie të fokusuar aspektesh të trafikimit të qenieve njerëzore në rajon

3. Angazhimi i ekipit kërkimor me një grup aktorësh kryesorë nëpërmjet telefonit dhe intervistave në terren për të mbledhur informacion për këndvështrimet e tyre në lidhje me burimet ekzistuese dhe boshllëqet si edhe mënyrën më të mirë për të trajtuar boshllëqet në lidhje me aspektet kyçe të reagimeve ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në rajon
4. Diskutimi i ekipit kërkimor dhe IOM-it me aktorët në një takim pune rajonal për të rishikuar, rishqyrtuar dhe prioritizuar gjetjet e kërkimit për nevojat parësore me qëllim që t'i përgjigjen në mënyrë më të efektshme aspekteve të përzgjedhura të trafikimit të qenieve njerëzore në rajon.

Ne kemi përfshirë tre momente angazhimi për ekipin kërkimor në Memorandumin Metodologjik për këtë vlerësim të nevojave. Ndërsa nuk është e mundur që të shtrihet më tej fusha e nevojave aktuale, IOM mund të përdorë Mekanizmin II. që të ndihmojë në vlerësim nëse kanë qenë mjaftueshëm sistematikë në përcaktimin e mënyrës së përfshirjes të aktorëve në vlerësimin e nevojave si edhe në aplikimin e rezultateve të vlerësimit të nevojave në proces.

IV. Hapat e ardhshëm

Ekipi kërkimor parashikon që IOM të plotësojë Mekanizmin I për të identifikuar një grup optimal dhe të fokusuar aktorësh për t'u përfshirë në sondazh dhe intervistim. Ne kemi përgatitur një format që IOM ta përdorë për t'i dhënë ekipit kërkimor rezultatet e këtij ushtrimi. Ai përmban emra, role dhe të dhëna kontakti. Pasi IOM t'i japë ekipit kërkimor këtë informacion në formatin e plotësuar, ne do ta përdorim që të programojmë sondazhin dhe të organizojmë logjistikën për intervistimin e aktorëve.

Referenca

CDC (2012) "Engaging Stakeholders" (Përfshirja e aktorëve) nga Prezantim i Programit të Vlerësimit të Programeve të Shëndetit Publik. Zyra e Drejtorit për të Programit, Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve1600 Clifton RdMailstop: D-37. May 2012

Miller, Janice A. dhe Diana M. Osinski (2002) "Training Needs Assessment." (Vlerësim i nevojave për trajnim) Dokument i Shoqërisë për menaxhimin e Burimeve Njerëzore. www.shrm.org/Research/Articles/Articles/Pages /CMS_000445.aspx

Preskill, Hallie dhe Nathalie Jones (2009) A Practical Guide for Engaging Stakeholders in Developing Evaluation Questions (Guidë praktike për përfshirjen e Aktorëve në Zhvillimin e Pyetjeve të Vlerësimit). Princeton, NJ: Robert Wood Johnson Foundation

Salentine, Shannon and Alan Johnston (2011) *Tools for Data Demand and Use in the Health Sector: Stakeholder Engagement Tool*.Measure Evaluation Manual. (*Mekanizma për Kërkimin dhe Përdorimin e të dhënave në sektorin shëndetësor: Mekanizmi i Përfshirjes së Aktorëve.* Manual i Vlerësimit të Masave) Chapel Hill, NC: Carolina Population Center, Universiteti i Karolinës së Veriut.

Watkins, Ryan, Maurya West Meiers, Yusra Laila Visser (2012) A Guide to Assessing Needs A Guide to Assessing Needs Essential Tools for Collecting Information, Making Decisions, and Achieving Development Results. (Guidë për Vlerësimin e Nevojave: Mekanizma thelbësore për Mbledhjen e Informacionit, Marrjen e Vendimeve dhe Arritjen e Rezultateve të Zhvillimit) Washington DC: Banka ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim ose Banka Botërore.

Aneksi A.

MEKANIZMI I.

Matrica e Analizimit të Aktorëve[1]

Çështja: Reagimi ndaj trafikimit të personave (TP) në Ballkanin Perëndimor

Aktiviteti: Vlerësimi i Nevojave të Situatës Rajonale të Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor

Data: Dhjetor 2013

Emri i organizatës, grupit apo individit të interesuar	**Përshkrimi i aktorit të interesuar** (qëllimi parësor, përkatësia, financimi, rajonal/kombëtar/lokal)	**Roli i mundshëm në çështje apo aktivitet** (interes në aktivitet; shkallë e mundshme përfshirjeje)	**Fushat e specializimit**(mbështetje për viktimat, drejtësi penale, politika penale, etj.)	**Niveli i angazhimit/ burimet në dispozicion** (Staf, vullnetarë, fonde, ndikim)	**Kufizime** (Kufizime: mungesa e fondeve, stafit, vullnetit, pengesa të tjera)
Sektori donator (ndihmë dypalëshe qeveritare, fondacione, filantropi)					
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
Sektori qeveritar					
1.					
2.					
3.					
4.					

[1]Marrë nga Salentine, Shannon dhe Alan Johnston (2011) *Tools for Data Demand and Use in the Health Sector: Stakeholder Engagement Tool.*Measure Evaluation Manual. (*Mekanizma për Kërkimin dhe Përdorimin e të dhënave në sektorin shëndetësor: Mekanizmi i Përfshirjes së Aktorëve*. Manual i Vlerësimit të Masave) Chapel Hill, NC: Carolina Population Center, Universiteti i Karolinës së Veriut

Vlerësimi i Nevojave i IOM-it kundër trafikimit në Ballkanin Perëndimor Mekanizmi i Përfshirjes së Aktorëve

Emri i organizatës, grupit apo individit të interesuar	**Përshkrimi i aktorit të interesuar** (qëllimi parësor, përkatësia, financimi, rajonal/kombëtar/lokal)	**Roli i mundshëm në çështje apo aktivitet** (interes në aktivitet; shkallë e mundshme përfshirjeje)	**Fushat e specializimit**(mbështetje për viktimat, drejtësi penale, politika penale, etj.)	**Niveli i angazhimit/ burimet në dispozicion** (Staf, vullnetarë, fonde, ndikim)	**Kufizime** (Kufizime: mungesa e fondeve, stafit, vullnetit, pengesa të tjera)
5.					
6.					
Sektori i shoqërisë civile (organizatë me bazë komunitare, organizata jo qeveritare)					
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
Organizata ndërkombëtare/Agjenci shumëpalëshe (qeveritare dhe jo-qeveritare)					
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
Sektori privat					
1.					
2.					
3.					

Aneksi B.

MEKANIZMI II.

Plani i Përfshirjes së Aktorëve[2]

Çështja: Reagimi ndaj trafikimit të personave (TP) në Ballkanin Perëndimor

Aktiviteti: Vlerësimi i Nevojave të Situatës Rajonale të Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor

Data: Dhjetor 2013

Emri i organizatës, grupit apo individit të interesuar	**Roli i mundshëm në vlerësim**	**Strategjia e përfshirjes** **Strategjia e ndjekjes së vijueshmërisë** Si do të përfshini këtë aktor në vlerësim?	**Strategjia e ndjekjes së vijueshmërisë** Planet për reagim ose përfshirje të vazhdueshme
Sektori donator (ndihmë dypalëshe qeveritare, fondacione, filantropi)			
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
Sektori qeveritar			
1.			
2.			
3.			
4.			

[2] Marrë nga Salentine, Shannon dhe Alan Johnston (2011) *Tools for Data Demand and Use in the Health Sector: Stakeholder Engagement Tool*. Measure Evaluation Manual. (*Mekanizma për Kërkimin dhe Përdorimin e të dhënave në sektorin shëndetësor: Mekanizmi i Përfshirjes së Aktorëve*. Manual i Vlerësimit të Masave) Chapel Hill, NC: Carolina Population Center, Universiteti i Karolinës së Veriut.

Vlerësimi i Nevojave i IOM-it kundër trafikimit në Ballkanin Perëndimor Mekanizmi i Përfshirjes së Aktorëve

Emri i organizatës, grupit apo individit të interesuar	**Roli i mundshëm në vlerësim**	**Strategjia e përfshirjes** **Strategjia e ndjekjes së vijueshmërisë** Si do të përfshini këtë aktor në vlerësim?	**Strategjia e ndjekjes së vijueshmërisë** Planet për reagim ose përfshirje të vazhdueshme
5.			
6.			
Sektori i shoqërisë civile (organizatë me bazë komunitare, organizata jo qeveritare)			
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
Organizatat ndërkombëtare /Agjenci shumëpalëshe (qeveritare dhe joqeveritare)			
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
Sektori privat			
1.			
2.			

Vlerësimi i Nevojave për Situatën Rajonale të Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor

Shtojca B:

Mekanizmat e IOM për Identifikimin dhe Përfshirjen e Aktorëve të Ballkanit Perëndimor

I. Hyrje

Qëllimi i vlerësimit të nevojave është që të përcaktojë boshllëkun që ekziston ndërmjet "asaj që është aktualisht dhe asaj që nevojitet, tani dhe në të ardhmen" (Miller dhe Osinski 2002). Vlerësimi i nevojave ka të bëjë me përdorimin e një tërësie sistematike procedurash që ndihmon në përcaktimin e "përparësive bazuar në nevoja" për të patur vendimmarrje të informuar që synon përmirësimin e proceseve organizative, alokimin e burimeve dhe/ose trajtimin në mënyrë më të efektshme të një problemi. Vlerësimi i nevojave mund të mendohet si një "proces i kujdesshëm" për të përcaktuar (1) burimet aktuale që ekzistojnë për të trajtuar një problem specifik, (2) burimet e nevojshme për të dhënë përgjigje më të efektshme ose rezultate më të mira për problemin, dhe/ose (3) mënyrën e aplikimit të informacionit të mësuar për të identifikuar alternativat dhe për të marrë vendime për atë që duhet të bëhet (Watkins et al 2012).

Një komponent kyç i vlerësimit të nevojave është përfshirja e aktorëve të interesuar. Aktorët e interesuar janë ata individë ose organizata që kanë një lloj investimi, përvoje ose njohurie për një problem, çështje ose institucion (marrë nga CDC 2012). Shembuj të aktorëve të interesuar përfshijnë stafin e programit që punon direkt për një çështje ose me një popullsi specifike, staf administrativ dhe mbikëqyrës, staf nga institucione partnere që punojnë me të njëjtat grupe ose pjesëmarrës ose çështje, donatorë dhe mbështetës financiarë të programeve dhe institucioneve, studiues dhe vlerësues, ekspertë të pavarur, me njohuri specifike të një problemi ose çështjeje. Aktorët e interesuar në çdo program, nismë ose çështje do të varen nga ai/ajo që punon direkt në ose me programin ose çështjen dhe që pozicionohen më mirë për të patur ndikim. Ashtu si ata që përfshihen për trajtimin e një programi ose problemi, ata janë gjithashtu persona ose institucione që janë në pozicionin më të mirë për të përdorur rezultatet e vlerësimit të çështjes ose problemit në mënyrë domethënëse. Identifikimi i aktorëve të duhur për t'u përfshirë dhe angazhuar në proces është thelbësor për të kryer çdo lloj vlerësimi domethënës.

Qëllimi i përfshirjes të aktorëve të interesuar në një vlerësim është rritja e rëndësisë së rezultateve ose gjetjeve dhe forcimi i pronësisë ndaj tyre. Për shkak të pozicionit të tyre të privilegjuar si ekspertë dhe atyre që punojnë direkt me një çështje në një farë mënyrë, kontributi i aktorëve të interesuar në hartimin, qëndrimin ose përmbajtjen e një vlerësimi mund të ndihmojë në rritjen e specifikës dhe përshtatshmërisë së gjetjeve. Gjithashtu ka më shumë mundësi që të ndihmojë për të siguruar që gjetjet të mund të zbatohen në jetën reale dhe të vihen shpejt në punë për të përmirësuar programet ose për të zgjidhur problemet në mënyrë më të efektshme. Madje, mund të ndihmojë gjithashtu që këto gjetje të pasqyrojnë nevojat dhe vlerat e vetë aktorëve të interesuar. Kur aktorët përfshihen në një vlerësim, ka më shumë mundësi që gjetjet të konsiderohen si rezultat i punës së tyre. Gjithashtu ka më shumë mundësi që ata t'i shohin ato në harmoni me këndvështrimet e tyre për një çështje ose problem. Në përfundim, përfshirja e aktorëve të interesuar ndihmon në nxjerrjen e gjetjeve që janë "më të dobishme, më të rëndësishme dhe të besueshme" (Preskill dhe Jones, 2009).

Mekanizmat e IOM për Identifikimin dhe Përfshirjen e Aktorëve të Ballkanit Perëndimor

Shtojca C:

Lista e Dokumenteve të Shqyrtuara (43 dokumente)

Shqipëri, Marrëveshje Bashkëpunimi

2012 Mekanizmi shqiptar i referimit për identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit të personave, Tiranë

Shqipëri, Ministria e Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave,

2011 Procedurat Standarde të Punës (SOP) për identifikimin dhe referimin e Viktimave të Trafikimit, Tiranë

Shqipëri, Koalicioni Shqiptar për strehëzat e anti-trafikimit (KKSAT)

2011 Raport për kontributin e KKSAT në identifikimin dhe ndihmën për viktimat e trafikimit, Tetor 2009 – Shtator 2010, Tiranë

Këshilli i Europës, Sekretariati i Këshillit të Europës, Konventa për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA dhe Komiteti i Palëve) Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Çështjeve Ligjore

2011 Raport në lidhje me zbatimin nga Shqipëria të (GRETA) Konventës së Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Strasburg

2013 Raport në lidhje me zbatimin nga Bosnjë Hercegovina të (GRETA) Konventës së Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Strasburg

2013 Raport në lidhje me zbatimin nga Serbia të (GRETA) Konventës së Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Strasburg

2012 Raport në lidhje me zbatimin nga Mali i Zi të (GRETA) Konventës së Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Strasburg

Komisioni Europian

2013 Progres Raporti 2013 për Shqipërinë, Bruksel

2013 Progres Raporti 2013 për Serbinë, Bruksel

2013 Progres Raporti 2013 për Maqedoninë, Bruksel

2013 EUROSTAT, Trafikimi i Qenieve Njerëzore, Botimi 2012, KS-RA-09-001-EN-C Metodologji dhe dokumente pune ISSN 1977-0375

Shqipëri, Ministria e Brendshme

2011 Plani Kombëtar i Veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe plani kombëtar i veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtja e fëmijëve, viktima të trafikimit, 2011-2013, Tiranë

Shqipëri, Ministria e Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave

2012 Raport për planin kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të personave, Janar- Dhjetor 2012, Tiranë

2011 Procedura Standarde të Punës për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, Tiranë

Shqipëri, Koalicioni Kombëtar për Strehëzat e Anti-trafikimit (KKSA)

2010 Kontributi i KKSA për identifikimin dhe ndihmën për viktimat e trafikimit, Tiranë

ODIHR dhe Këshilli i Europës
2009 Rishikim i Legjislacionit në Lidhje me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Bosnjë Hercegovinë, OSBE

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE)
2009 Trafikimi i qenieve njerëzore dhe përgjigja e sistemit vendor të drejtësisë penale,
2011 Trafikimi i qenieve njerëzore për qëllim të shfrytëzimit në punës, Sarajevë
2012 Raport nga Përfaqësuesja e Posaçme dhe Koordinatorja e OSBE-së për Luftën Kundër trafikimit të Qenieve Njerëzore, pas vizitës së saj në Bosnjë Hercegovinë, 12-14 qershori 2012

Bosnjë-Hercegovina, Këshilli i Ministrave
2013 Strategjia për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Bosnjë Hercegovinë dhe Plani i Veprimit, 2013-2015, Sarajevë
2012 Strategjia në fushën e migracionit dhe azilit dhe Plani i Veprimit për periudhën 2012-2015, Sarajevë

Bosnjë-Hercegovina, Koordinatori i Shtetit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm në Bosnjë Hercegovinë
2012 Raporti për statusin e trafikimit të qenieve njerëzore në Bosnjë Hercegovinë dhe raporti për zbatimin e planit të veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Bosnjë Hercegovinë për vitin 2012, Sarajevë

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
2011 Të dhëna të rasteve për trafikimin e personave: shifra dhe trende botërore, Gjenevë
2004 Modele dhe trende të ndryshueshme të trafikimit të personave në rajonin e Ballkanit- Vlerësim i kryer në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Provincën e Kosovës, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Moldavisë, ISBN 92-9068-205-1
© 2004 Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)

Departamenti Amerikan i Shtetit
2013 Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Trafikimin e Personavehttp://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/2013/?utm_source=Subscribers&utm_campaign=35f27bd04cTrafficking_Bulletin_Issue_9_July_20137_22_2013&utm_medium=email&utm_term=0_1002a3b355-35f27bd04c-92744149

Kroaci, Razbor
2012 RAPORT I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në raste të trafikimit në Europën Juglindore (TRM-II), Zagreb, Përgatitur nga: ICMPD, Zbatuar nga:Razbor Ltd., Zagreb , Vlerësues: Ivana Novoselec dhe Andrijana Parić

Kosovë, Koalicioni Kosovar i Strehëzave
2011 Strategjia dhe Plani i Veprimit të Koalicionit Kosovar të Strehëzave, Prishtinë

Kosovë, Ministria e Brendshme
2011 Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2011-2014, Prishtinë

Maqedoni, Ministria e Brendshme
2013 Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migracionit të paligjshëm në Republikën e Maqedonisë, 2013-2016, Shkup

Maqedonia, Komisioni Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
2010 Procedurat Standarde të Punës për trajtimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, Shkup

Balkan Act Now (projekt i financuar nga BE)
2013 Strategjia e Zbatimit 2013-2014, dokument rajonal
2013 Analiza e Situatës së Trafikimit të Qenieve Njerëzore, dokument rajonal

Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit
2012 Rruga përpara për përcaktimin e një mekanizmi referimi ndërkombëtar efektiv- Raport bazuar në përvojat e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore në Europën Juglindore, Vjenë ISBN:978-3-900411-76-3
2007 Dëgjimi i viktimave, përvojat e identifikimit, kthimit dhe ndihmës në Europën Juglindore, Vjenë
2013 Forcimi i Kapaciteteve për të luftuar trafikimin për shfrytëzimin e punës – Përshkallëzimi i luftës kundër trafikimit për shfrytëzimin e punës

UNICEF, Terres Des Hommes
2006 Masa për të parandaluar trafikimin e fëmijëve në Europën Juglindore, Vlerësim Paraprak (Shqipëri, Moldavi dhe Kosovë)

Roza Pati, Policimi përmes kufijve
2013 Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar për zbatimin e ligjit, rasti i Europës Juglindore, faqe 89-122, Springer New York Print ISBN 978-1-4419-9544-5

Qendra Rajonale MARRI
2012 Dokument i MARRI-t për Migracionin, Shkup

UNODC
2012 Raport për Trafikimin Global në lidhje me Trafikimin e Personave, © Kombet e Bashkuara, Dhjetor 2012. Të gjitha të drejtat të rezervuara. ISBN: 978-92-1-130309-4, e-ISBN: 978-92-1-055896-9, Publikim i Kombeve të Bashkuara, Sales No. E.13.IV.1

FRONTEX, Agjencia Europiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian
2013 Analiza Vjetore e Riskut në Ballkanin Perëndimor, Njësia e Analizës së Riskut, Varshavë
2013 FRAN, tremujore, Prill-Qershor 2013, Njësia e Analizës së Riskut, Varshavë

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Program rajonal për Mbrojtjen Sociale dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore

2012 Dimensioni Social i Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor, Shkup, Maqedoni

Scarabelli, D.

2014 Cleaning the Balkan Route: Elements of Police Cooperation in Serbia (Pastrimi i Rrugës Ballkanike: Elementë të Bashkëpunimit Policor në Serbi), e gjeni në: http://cenaa.org/analysis/cleaning-the-balkan-route-elements-of-police-cooperation-in-serbia/

Serbi, Qeveria e Serbisë
2006 Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 05 nr:021-10196/2006Beograd, 7 dhjetor 2006.
2013 Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2013-2018 (projekt propozim)
2013 Projekt Plan veprimi për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2013-2014 (projekt propozim)

Serbi, Kryqi i Kuq
2011 Studim për mësimet e nxjerra, Programi Anti-Trafikimit në Serbi 2009-2011 zbatuar nga Kryqi i Kuq i Serbisë, Partneritet i Kryqit të Kuq mes Kryqit të Kuq të Serbisë, Kryqit të Kuq të Danimarkës dhe Kryqit të Kuq të Norvegjisë, Beograd

Serbi, ASTRA- Veprim Anti-Trafikimit
2011 TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE NË REPUBLIKËN E SERBISË, Raport për periudhën 2000-2010, Beograd

Serbi, Dr Dostic, S. dhe Gocic, S.
2013 TIP in Serbia as a criminal phenomenon (TP në Serbi si një fenomen kriminal), revista Bezbednost, e gjeni në http://prezentacije.mup.gov.rs/upravazaobrazovanje/aktuelno/Bezbednost%203-2013.pdf

Mali i Zi, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
2012 Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2012-2018

Limanowska, B
2004 Trafficking in Human Beings in South East Europe (Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Europën Juglindore), Publikuar nga: UNICEF, UNOHCHR dhe OSBE/ODIHR2004

Brunovskis, A. dhe Surtees, S,
2007 Leaving the past behind? When victims decline assistance. (Lënia pas e së shkuarës? Kur viktimat refuzojnë ndihmë) NEXUS (Vienë) & Fafo (Oslo)

Surtees, R.
2010 Monitoring anti-trafficking re/integration programmes. A manual, (Monitorimi i programeve të antitrafikimit/integrimit. Manual) Fondacioni The King Baudouin, Bruksel

Vlerësimi i Nevojave për Situatën Rajonale të Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor

Shtojca D:

Guida e Intervistës

ORGANIZATA E TË INTERVISTUARIT: _____

EMRI I TË INTERVISTUARIT: _____

TITULLI I TË INTERVISTUARIT: _____

ANËTAR I EKIPIT KËRKIMOR: _____ **DATA:** _____

PREZANTIM DHE MIRATIM I INFORMUAR

Faleminderit që na dhatë nga koha juaj për të biseduar me ne sot. Si pjesë e vlerësimit të nevojave për IOM-in, po zhvillojmë intervista me aktorët kyç rajonalë dhe ekspertë për të mësuar në lidhje me situatën aktuale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe reagimet ndaj kësaj situate në rajonin e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë (BH), Kosovë nën administrimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (Kosovë), ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia).

Qëllimi i bisedës tonë sot është të mësojmë për mendimin tuaj në lidhje me situatën e trafikimit të qenieve njerëzore dhe reagimet ndaj kësaj në vend dhe në mbarë rajonin. Kjo intervistë nuk do të zgjasë më shumë se 60 minuta. Unë do të mbaj shënime gjatë bisedës në mënyrë që të përfshijmë mendimet tuaja në vlerësimin e nevojave dhe të përfaqësojmë me saktësi informacionin që na jepni.

Përgjigjet tuaja do të mbahen të fshehta dhe shënimet e diskutimit nuk do të ndahen me asnjë jashtë ekipit të vlerësimit të nevojave. Çdo informacion që na jepni do të kombinohet me informacionin e mbledhur nga burime të tjera dhe nuk do t'ju atribuohet juve në asnjë raportim apo komunikim me IOM.

Meqë është vlerësim i nevojave, ju inkurajojmë që të jeni sa më të sinqertë që të jetë e mundur në lidhje me mendimin tuaj për (1) situatën aktuale të trafikimit të qenieve njerëzore në rajon, (2) reagimin operacional rajonal dhe kombëtar ndaj kësaj situate, dhe (3) nevojat e prioritizuara për të mbështetur reagime më të efektshme. Kjo do të na japë mundësinë që të përfshijmë mendimet tuaja dhe t'i japim IOM-it informacion tepër të rëndësishëm dhe të saktë si pasojë e këtij projekti.

Dua të theksoj që nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara për këto pyetje. Meqë keni pranuar vullnetarisht që të merrni pjesë në këtë studim, ju kërkojmë që t'ju përgjigjeni pyetjeve me përgjigje që janë të vërteta për ju ose për organizatën tuaj.

- A i kuptoni parametrat e bisedës sonë?
- A keni ndonjë pyetje për momentin?

I. HYRJE

Do të doja të filloja duke ju pyetur për sfondin tuaj dhe punën në lidhje me reagimin ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, me qëllim që të orientojmë bisedën.

1. Cili është titulli juaj zyrtar? Cilat janë në përgjithësi përgjegjësitë tuaja kryesore?

2. Cili aspekt i punës tuaj ka të bëjë me reagimin ndaj trafikimit të qenieve njerëzore?

II. PANORAMA AKTUALE E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Tani do të doja t'ju kërkoja mendimin në lidhje me situatën aktuale të trafikimit të qenieve njerëzore në [VEND] dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor – nëse mendoni që është çështje kyç dhe nëse po, çfarë forme merr në rajon.

3. A mendoni se trafikimi dhe shfrytëzimi i migrantëve janë probleme domethënëse në [VENDIN] dhe/ose rajon?
   - Pse po ose pse jo?

4. Cilat janë disa nga rrugët kryesore të trafikimit në rajon, përfshirë vendet e burimit, tranzitit dhe destinacionit?

5. Cilat mënyra ose modele rekrutimi keni vënë re? Si kapen njerëzit në trafikim?

6. Cilat industri kyçe janë të përfshira, pra për çfarë lloj shfrytëzimi në punë trafikohen njerëzit, nëpërmjet dhe/ose për në rajon?

7. Cilët janë disa nga llojet e individëve ose grupeve të përfshirë në kryerjen e trafikimit të njerëzve? Pra, cilët janë trafikantët?

8. A ka ndryshuar me kohën ndonjë nga këto komponentë- pra rrugët, rekrutimi, industritë, cilët janë trafikantët?

   - Nëse po, si kanë ndryshuar?
   - Në çfarë periudhe kanë ndryshuar?
   - Gjatë cilës periudhe kanë ndryshuar?
   - Cilat janë disa nga arsyet për këto ndryshime?

III. Burime të anti-trafikimit

Temat tona të ardhshme fokusohen në kuadrin ligjor dhe të politikave në [VEND] dhe çdo mekanizëm rajonal dypalësh apo ndërkombëtar për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit për punë dhe për t'i referuar ata në shërbimet e mbrojtjes dhe ndihmës sociale që mund të kenë nevojë ose dëshirë.

Identifikimi

9. Në [VENDI], si vihen në dijeni të nëpunësve ose organizatave që mund të ofrojnë asistencë, personat që mund të kenë pasur përvojë me trafikimin ose shfrytëzimin?

   - Cilat janë disa mënyra të zakonshme për identifikimin e personave?

   - Për shembull, nga policia, rojet kufitare, inspektorët e punës, konsullatat, etj?

10. Cilat organizata kanë autoritet për të përcaktuar zyrtarisht një person si viktimë të trafikimit?

   - Cilat kritere përdoren për të identifikuar viktimat? A përdoren lista kontrolli?

- A e kualifikon ky përcaktim personin që të ketë të drejta për shërbimet e mbrojtjes ose asistencës sociale? Lejes së qëndrimit? Lejes së punës?
- A u kërkohet personave të identifikuar në këtë mënyrë që të kthehen në vendin e tyre të origjinës?

11. Cilat mënyra ekzistojnë që viktimat të "vetë-identifikohen" (psh linja direkte telefonike, postera ose reklama të tjera, identifikimi i organizatave për t'u kontaktuar)?
    - Ku ndodhen këto mënyra?
    - Për shembull, në [VENDI], vendet dominues të origjinës për imigrantët për në [VENDIN] dhe/ose vendet për ku shtetasit e [VENDIT] migrojnë rregullisht?

12. Cilat rrjete **kombëtare** referimi për identifikimin dhe referimin e personave të trafikuar dhe migrantët e shfrytëzuar ekzistojnë në [VEND]?
    - Cilat institucione qeveritare janë të përfshira?
    - Institucione ndërkombëtare dhe jo-qeveritare?
    - Sa funksionale janë ato, pra a ka politika ose procedura zyrtare që i përcaktojnë ato? Memorandume Mirëkuptimi? Të përcaktuara në letër, por të papërdorura etj? Sa aktive janë ato?
    - A ekziston një mekanizëm rajonal referimi për identifikimin dhe referimin e personave të trafikuar dhe migrantët e shfrytëzuar? Nëse jo, pse jo? Cilat parakushte janë të nevojshme për të përcaktuar një mekanizëm të tillë?

13. Cilat janë disa nga pengesat kryesore për zhvillimin e mënyrave më të efektshme për të identifikuar dhe referuar personat që kanë qenë objekt trafikimi ose shfrytëzimi migrantësh në [VEND]? Në rajon?

Mbrojtje dhe Asistencë

Grupi tjetër i pyetjeve fokusohet në institucionet dhe sistemet që ofrojnë shërbime mbrojtjeje dhe asistence për personat që kanë qenë objekt trafikimi ose shfrytëzimi në [VEND] dhe në rajon.

14. A keni dijeni për ndonjë organizatë ose institucion që ofron mbrojtje dhe/ose shërbime asistence për migrantët e shfrytëzuar në [VEND]?
    - Çfarë lloj shërbimesh mbrojtjeje ofrojnë ato?
    - Çfarë lloj asistence ofrojnë ato?
    - Ekzaktësisht: strehë, ndihmë mjekësore, psiko-sociale, vend pune, formim profesional, terapi rekuperimi, mbështetje ligjore, ndihmë për kthimin dhe riintegrimin.

    Si është mbulimi i këtyre organizatave d.m.th a kanë VT akses në shërbime pavarësisht zonës ku identifikohen?

15. Si kontaktojnë këto organizata personat që kanë nevojë për shërbimet e tyre?
    - A ka rregulla ose procedura specifike që përcaktojnë sesi personat në nevojë marrin këto shërbime?
    - A ka kufizime ose pengesa për personat në nevojë që të marrin këto shërbime?

16. A ka shërbime në dispozicion që të ndihmojnë personat që nuk janë përcaktuar zyrtarisht si të trafikuar?
    - Nëse po, çfarë mekanizmash janë këto?
    - Si kanë akses në këto shërbime personat në nevojë?
    - Cilat organizata ofrojnë shërbime për personat në nevojë që nuk janë përcaktuar zyrtarisht si të trafikuar, nëse janë të ndryshme nga ato që përmenden më përpara?

17. A mendoni që burimet dhe mbështetja në dispozicion është e mjaftueshme për të plotësuar nevojat e personave që kanë qenë objekt shfrytëzimi?
    - Nëse jo, cila lloj mbështetjeje mungon?
    - A mendoni që ndonjë nga këto burime nuk ka shumë lidhje me to? Pra, janë në dispozicion, por nuk përdoren shpesh? A janë të ndryshme nga ajo që kërkojnë persona në nevojë për ndihmë?

18. A ekzistojnë sisteme për të siguruar që ndihma që ofrohet nga këto programe të plotësojë nevojat e tyre? Për shembull, standarde, mekanizmi i reagimit të viktimave, reagimi i koordinuar i komunitetit, protokolle të përbashkëta, ndarja e reagimit në punë dhe përvoja, etj?
    - A ka elemente të këtyre sistemeve që ju mendoni se mund të pengojnë ose të mos inkurajojnë afrimin e migrantëve të shfrytëzuar për të marrë ndihmë?
    - Nëse po, çfarë mendoni se duhet të bëhet për të inkurajuar njerëzit në nevojë që të kërkojnë ndihmë?
    - Çfarë duhet bërë për të zhvilluar ose dhënë mbrojtjen dhe ndihmë më të përshtatshme për migrantët e shfrytëzuar?
    - Sipas jush, a janë subjekt ri-viktimizimi VT të identifikuara?
    - Nëse po, në çfarë mënyrë? Çfarë mund të bëhet për të shmangur përsëritjen e viktimizimit?

Partneritetet

19. A ekzistojnë rrjete ose partneritete **dypalëshe ose ndërkombëtare** në rajon, të cilat bashkëpunojnë për identifikimin, referimin, mbrojtjen ose ndihmën për të trafikuarit dhe migrantët e shfrytëzuar?
    - Nëse po, cilat institucione dhe organizata janë të përfshira në to?
    - Sa funksionale janë?
    - Sa aktive dhe të efektshme janë?
    - Sa të qëndrueshme janë? Në çfarë mënyre janë të qëndrueshme ose jo të qëndrueshme?

IV. Boshllëqe në Burimet e Anti-Trafikimit

Pjesa tjetër e pyetjeve fokusohet në identifikimin e boshllëqeve në burime për t'ju përgjigjur trafikimit në [VEND] dhe rajon.

20. Sipas jush, cilat janë burimet e munguara ose të nevojshme për të **identifikuar** personat që kanë përvojë trafikimi dhe shfrytëzimi në (VEND) ose rajon?

21. Sipas jush, cilat janë boshllëqet në mekanizmat e referimit, pra mënyrat e lidhjes së njerëzve me ndonjë shërbim apo asistencë që mund t'ju nevojitet?

22. A ka ndonjë nevojë ose boshllëk dhe llojet e ndihmës në dispozicion? Nëse po, çfarë lloj ndihme dhe shërbimi nevojitet?
    - Sa e lehtë/e vështirë është që njerëzit të kenë akses në shërbimet dhe mbështetjen që ofrohet?
    - A ka ndonjë pengesë për personat që të marrin mbështetjen e nevojshme? Nëse po, cilat janë ato?

    Hulumtim: Dallimet ndërmjet shërbimeve që ofrohen për viktimat e shfrytëzimit seksual, shfrytëzimit për punë ose formave të tjera të shfrytëzimit në migracion të cilat nuk afrohen me përkufizimet dominuese.

V. Nevojat sipas përparësive

Grupi i mëposhtëm i pyetjeve fokusohet në identifikimin e përparësive dhe procesit për vendosjen e përparësive në (VEND) në nivel kombëtar dhe lokal.

23. Mes boshllëqeve dhe nevojave për burime me qëllim luftën kundër trafikimit, të cilat ju i përmendët, cilat mendoni se janë përparësi për [VENDIN] dhe rajonin?
    - Pra, kë identifikim, referim apo shërbim dhe mekanizëm ndihme të munguar apo cilat burime do të donit që të shikonit fillimisht të zhvilluara (sa më shpejt)?
    - Pse mendoni që burimet që keni identifikuar duhet të zhvillohen të parat?

V. Rekomandimet parësore

Grupi tjetër i pyetjeve do të fokusohet në rekomandimin parësor bazuar në përparësitë e identifikuara nga seksioni i mëparshëm

24. A keni rekomandime të tjera për trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin e migrantëve në mënyrë më të efektshme në [VEND] dhe rajon?

Shumë faleminderit për kohën dhe kontributin. Është shumë i çmuar për vlerësimin.

Vlerësimi i Nevojave i IOM-it për Situatën Rajonale të Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor

Shtojca E:

Sondazh i Aktorëve të Përfshirë

Përfundimtar

Shkurt 2014

Udhëzime të Sondazhit

Një ekip i pavarur kërkimor po punon me organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në kryerjen e një vlerësimi të nevojave të boshllëqeve në përgjigje të trafikimit të qenieve njerëzore në rajonin e Ballkanit Perëndimor përfshirë Shqipërinë, Bosnjë Hercegovinën (BH), Kosovën[1], Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë.

Qëllimi i këtij vlerësimi nevojash është mbledhja dhe analizimi i pikëpamjeve të aktorëve të interesuar për situatën aktuale të trafikimit si edhe mekanizmat në dispozicion për t'u përgjigjur ndaj saj, me fokus të veçantë në identifikimin e boshllëqeve dhe nevojave rajonale sa i përket identifikimit, referimit, ndihmës dhe mbështetjes për personat e trafikuar.

Një komponent thelbësor i vlerësimit është përfshirja e aktorëve. Ky sondazh bën të mundur që ekipi kërkimor të pyesë dhe të përfshijë këndvështrimet e aktorëve kyç rajonalë me qëllim që të krijohet panorama e situatës së trafikimit dhe përparësive kyçe në përgjigje të saj. Kjo përfshin aktorët që janë intervistuar si pjesë e këtij vlerësimi. Edhe nëse keni marrë pjesë në një intervistë, do të donim t'ju kërkonim që të plotësonit këtë sondazh.

Ju ftojmë që të merrni pjesë në këtë sondazh në internet. Përgjigjet tuaja do të mbahen të fshehta dhe nuk do të ndahen me IOM, aktorë të tjerë apo këdo tjetër jashtë ekipit kërkimor të pavarur. Çdo informacion që na jepni do të kombinohet me informacionin e mbledhur nga përgjigje të tjera të sondazhit dhe nuk do t'ju atribuohet juve në asnjë raportim apo komunikim me IOM ose aktorë të tjerë. Ju inkurajojmë që të jeni sa më të sinqertë që të jetë e mundur në mënyrë që ne të jemi në gjendje që t'i japim IOM-it informacion, rekomandime dhe përparësi sa më të sakta dhe të dobishme që të jetë e nevojshme.

Nëse klikoni linkun më poshtë ose nëse e kopjoni në motorin tuaj të kërkimit do të hyni në faqen e parë të pyetësorit online.

[insert link]
Ju lutemi që t'i përgjigjeni pyetjeve sa më mirë. Për disa pyetje, ju jepet alternativa "nuk e di" dhe/ose "nuk vlen". Nëse nuk keni dijeni për një çështje ose pyetje të caktuar që lidhet me një

---

[1]Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

çështje me të cilën nuk merreni në pozicionin tuaj, zgjidhni alternativën përkatëse. Gjithashtu mund ta lini pyetjen pa përgjigje.

Sondazhi duhet të zgjasë rreth 15 deri në 20 minuta që të përfundojë. Ju lutemi që ta plotësoni këtë pyetësor tani, ose sa më shpejt që të jetë e mundur. E vlerësojmë shumë pjesëmarrjen tuaj.

Pas pak do të merrni një email nga IOM me një variant të përkthyer të pyetësorit. Megjithatë, pyetësori online duhet që të plotësohet në Anglisht.

Nëse keni komente ose pyetje për sondazhin ose doni që të përgjigjeni në një mënyrë, ju lutemi që të na dërgoni email në natconsult6448@gmail.com.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

SEKSIONI A: PUNA AKTUALE

Në këtë seksion, duam të mësojmë për ju, pozicionin tuaj aktual dhe punën tuaj.

A1. Si do ta përshkruanit pozicionin tuaj (*Ju lutem të zgjidhni vetëm një*)

- ❍ Nëpunës shtetëror në fushën e drejtësisë penale/zbatimit të ligjit
- ❍ Nëpunës shtetëror në fushën e mbështetjes për viktimat e trafikuara
- ❍ Nëpunës shtetëror në fushën e mbrojtjes sociale dhe/ose kujdesit shëndetësor (jo specifikisht trafikim)
- ❍ Nëpunës shtetëror - tjetër
- ❍ Punonjës OJQ-je nga agjencia e mbështetjes së viktimave
- ❍ Punonjës OJQ – tjetër
- ❍ Gjyqtar
- ❍ Prokuror
- ❍ Punonjës policie
- ❍ Roje kufitare
- ❍ Staf i IOM-it
- ❍ Staf i OKB ose organizatë tjetër shumëkombëshe
- ❍ Staf i një agjencie ndërkombëtare zhvillimi
- ❍ Konsultent/ekspert i pavarur kundër trafikimit
- ❍ Tjetër (ju lutemi të specifikoni) _____

A2. Prej sa kohësh jeni punësuar nga organizata aktuale?

- ❍ Më pak se një vit
- ❍ 1 deri në 2.9 vjet
- ❍ 3 deri në 4.9 vjet
- ❍ Më shumë se 5 vjet

A3. Prej sa kohësh punoni për çështje kundër trafikimit?

- ❍ Më pak se një vit
- ❍ 1 deri në 2.9 vjet
- ❍ 3 deri në 4.9 vjet
- ❍ Më shumë se 5 vjet

SEKSIONI B: KARAKTERISTIKA PERSONALE

B1. Në cilën grup-moshë bëni pjesë?

- ❍ 18-34
- ❍ 35-49
- ❍ 50-64
- ❍ 65 vjeç ose më shumë

B2. A jeni:

- ❍ Mashkull
- ❍ Femër

B3. Në cilin vend ose me cilin vend punoni? (Ju lutemi të zgjidhni vetëm një)

- ❍ Shqipëri

- ❍ Bosnjë Hercegovinë
- ❍ Kosovë
- ❍ Maqedoni
- ❍ Mal i Zi
- ❍ Serbi
- ❍ Rajon i Ballkanit Perëndimor (më shumë se një vend të BP)
- ❍ Global

SEKSIONI C: INDENTIFIKIMI I VIKTIMËS DHE MBËSHTETJA

Në këtë seksion, do të donim t'ju pyesnim për mënyrën e identifikimit të viktimave të trafikimit në vendin tuaj ose në rajonin e Ballkanit Perëndimor të cilën ju e njihni.

C1. Ju lutemi të lexoni pohimet e mëposhtme në lidhje me mekanizmat e identifikimit të viktimave në vendin tuaj ose në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ju lutemi të klikoni në rrethin që pasqyron më mirë mendimin tuaj për ekzistencën dhe funksionimin e këtyre mekanizmave.

	I krijuar dhe plotësisht funksional	**I krijuar dhe pjesërisht funksional**	**I krijuar, por jo funksional**	**Nuk është krijuar**	**Nuk e di**
a) Politika/udhëzime formale që përshkruajnë agjencitë të cilat kanë autoritet për të përcaktuar zyrtarisht një person si viktimë trafikimi	❍	❍	❍	❍	❍
b) Përkufizimi zyrtar i një viktime trafikimi (në ligj dhe/ose politikë/udhëzim)	❍	❍	❍	❍	❍
c) Udhëzime zyrtare për identifikimin e viktimave të trafikimit	❍	❍	❍	❍	❍
d) Linjë e dedikuar telefonike emergjence vetëm për anti-trafikimin (qeveritare)	❍	❍	❍	❍	❍
e) Linjë e dedikuar telefonike emergjence vetëm për anti-trafikimin (jo-qeveritare)	❍	❍	❍	❍	❍
f) Linjë telefonike që mund të përdoret për të raportuar raste të TP	❍	❍	❍	❍	❍

	I krijuar dhe plotësisht funksional	I krijuar dhe pjesërisht funksional	I krijuar, por jo funksional	Nuk është krijuar	Nuk e di
(qeveritare)					
g) Linjë telefonike që mund të përdoret për të raportuar raste të TP (jo-qeveritare)	❍	❍	❍	❍	❍
h) Mekanizma referimi vendore ose kombëtare (MRK) ose marrëveshje të tjera bashkëpunimi ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve dhe/ose autoriteteve për referimin e çështjeve të trafikimit tek shërbimet ose autoritetet e duhura	❍	❍	❍	❍	❍
i) Mekanizmi ndërkombëtar (ndërkufitar) i referimit (MRN) ose marrëveshje të tjera bashkëpunimi ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve dhe/ose autoriteteve nga shtete të ndryshme për referimin e çështjeve të trafikimit tek shërbimet ose autoritetet e duhura	❍	❍	❍	❍	❍
j) Standarde kombëtare për trajtimin e viktimave të trafikimit	❍	❍	❍	❍	❍
k) Mekanizma formale për të marrë reagimin e viktimave për përshtatshmërinë dhe dobinë e shërbimeve në dispozicion (p.sh formularë vlerësimi me shkrim, diskutime në grup etj)	❍	❍	❍	❍	❍

C2. Ju lutemi të lexoni pohimet e mëposhtme në lidhje me mjaftueshmërinë e shërbimeve për mbështetjen e viktimave (pra aftësinë për të plotësuar nevoja specifike) në vendin tuaj ose në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

- **Ju lutemi të klikoni rrethin që përshkruan më mirë në çfarë mase jeni dakord apo jo me çdo pohim**

	Plotësisht e mjaftueshme	**Disi e mjaftueshme**	**E mjaftueshme vetëm për disa popullata**	**E pamjaftueshme**	**Tërësisht e pamjaftueshme**	**Nuk e di/ Nuk vlen**
a) Strehëza afatshkurta (<30 ditë)	❍	❍	❍	❍	❍	❍
b) Strehëza afatgjata (>30 ditë)	❍	❍	❍	❍	❍	❍
c) Forma të tjera të akomodimit afatgjatë (si shtëpi të përbashkëta, apartamente private)	❍	❍	❍	❍	❍	❍
d) Kujdes shëndetësor (përfshirë shëndetin fizik, trajtim për abuzimin me substanca)	❍	❍	❍	❍	❍	❍
e) Shërbime psiko-sociale (psikologjike)	❍	❍	❍	❍	❍	❍
f) Vlerësim i riskut (përcaktimi i rrezikut ose kërcënimit të hasur dhe mbrojtja/siguria e nevojshme)	❍	❍	❍	❍	❍	❍
g) Mbështetje ligjore – penale (gjatë hetimit dhe ndjekjes)	❍	❍	❍	❍	❍	❍
h) Mbështetje ligjore- civile (gjykim civil dhe padi civile për shpërblim)	❍	❍	❍	❍	❍	❍
i) Terapi rekuperimi	❍	❍	❍	❍	❍	❍
j) Trajnim në punë	❍	❍	❍	❍	❍	❍
k) Gjetje e vendit të punës	❍	❍	❍	❍	❍	❍
l) Mbështetje për t'u kthyer në vendin e origjinës	❍	❍	❍	❍	❍	❍
m) Mbështetje për rivendosje në një vend/zonë të tretë	❍	❍	❍	❍	❍	❍

	Plotësisht e mjaftueshme	**Disi e mjaftueshme**	**E mjaftueshme vetëm për disa popullata**	**E pamjaftueshme**	**Tërësisht e pamjaftueshme**	**Nuk e di/ Nuk vlen**
n) Mbështetje për ri-integrim në zonën/vendin e origjinës	❍	❍	❍	❍	❍	❍
o) Mbështetje për integrim në zonën/vendin e destinacionit	❍	❍	❍	❍	❍	❍

C2.a. Ju lutemi që të komentoni përgjigjet tuaja për C2. A ka shërbime mbështetëse që mungojnë plotësisht në vendin tuaj dhe/ose rajonin e Ballkanit Perëndimor? Në çfarë mënyrë mungojnë ato që i keni shënuar si "të pamjaftueshme" ose "plotësisht të pamjaftueshme"? Nëse zgjidhni "të mjaftueshme vetëm për disa popullata", cilave popullata u ofrohet shërbimi në fjalë? Cilat përjashtohen? Ju lutemi të shtjelloni në mënyra të tjera që mund të ndihmojnë për specifikimin e përgjigjeve tuaja (vetëm anglisht) (500 karaktere)

C3. Ju lutemi të lexoni pohimet e mëposhtme në lidhje me situatën aktuale kundër trafikimit dhe shërbimet që janë aktualisht në dispozicion në vendin tuaj ose në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

- **Ju lutemi të klikoni kutinë që përshkruan më mirë masën në të cilën jeni dakord apo jo me çdo pohim**
- **Nëse nuk keni dijeni për një aktivitet, ju lutemi që të zgjidhni "nuk e di/nuk vlen"**

	Plotësisht kundër	**Kundër**	**As kundër as dakord**	**Dakord**	**Tepër dakord**	**Nuk e di/Nuk vlen**
a) Profili tipik i viktimave <u>të identifikuara</u> të trafikimit është përfaqësues i <u>të gjitha</u> viktimave në vendin tim	❍	❍	❍	❍	❍	❍
b) **Gama** e shërbimeve në dispozicion të një viktime trafikimi varet nga organizata që e identifikon atë	❍	❍	❍	❍	❍	❍
c) **Cilësia** e shërbimeve në dispozicion të një viktime trafikimi varet nga organizata që e identifikon atë	❍	❍	❍	❍	❍	❍
d) **Gama** e shërbimeve në dispozicion të një viktime trafikimi varet nga organizata që e ndihmon atë	❍	❍	❍	❍	❍	❍
e) **Cilësia** e shërbimeve në dispozicion të një viktime trafikimi varet nga organizata që e ndihmon atë	❍	❍	❍	❍	❍	❍
f) **Gama** e shërbimeve në dispozicion të viktimave të trafikimit për qëllime seksuale është më e madhe se ajo për viktimat e formave të tjera të trafikimit	❍	❍	❍	❍	❍	❍
g) **Cilësia** e shërbimeve në dispozicion të viktimave të trafikimit për qëllime seksuale është më e madhe se ajo për viktimat e formave të tjera të trafikimit	❍	❍	❍	❍	❍	❍

C4. Ju lutemi që të lexoni pohimet e mëposhtme në lidhje me shërbimet kundër trafikimit në vendin tuaj ose në rajonin e Ballkanit Perëndimor

- **Ju lutemi të klikoni kutinë që përshkruan më mirë masën në të cilën jeni dakord apo jo me çdo pohim**
- **Nëse nuk keni dijeni për një aktivitet, ju lutemi që të zgjidhni "nuk e di/nuk vlen"**

a) Viktimat **e huaja** të trafikimit kanë akses në një gamë më të vogël shërbimesh sesa viktimat kombëtare të trafikimit	❍	❍	❍	❍	❍	❍
b) Viktimat **e huaja** të trafikimit kanë akses në shërbime me **cilësi** më të ulët sesa viktimat kombëtare të trafikimit	❍	❍	❍	❍	❍	❍
c) Shërbimet mbështetëse për viktimat e trafikimit ofrohen sipas nevojave specifike të **fëmijëve**	❍	❍	❍	❍	❍	❍
d) Disa viktima nuk lejohen që të paraqiten për shkak të llojit ose cilësisë së ndihmës që ofrohet (p.sh kthim i detyrueshëm në vendin e origjinës)	❍	❍	❍	❍	❍	❍
e) Shërbimet mbështetëse për viktimat e trafikimit ofrohen sipas nevojave specifike të**VT meshkuj dhe femra**	❍	❍	❍	❍	❍	❍

C5. Ju lutemi të përshkruani çdo pengesë për (1) identifikimin e viktimave të trafikimit dhe (2) ofrimin e shërbimeve të duhura që shihni në vendin tuaj ose në rajonin e Ballkanit Perëndimor. (vetëm anglisht) (500 karaktere)

SEKSIONI D: BOSHLLËQE NË IDENTIFIKIMIN DHE MBËSHTETJEN E VIKTIMAVE

Nisur nga përgjigjet tuaja në Seksionin C, do të donim t'ju pyesnim për boshllëqet kyçe në veprimtaritë ose burimet që nevojiten për t'u përgjigjur me më shumë efektivitet ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në vendin tuaj ose rajonin e Ballkanit Perëndimor

D1. Ju lutemi të përshkruani cilat mendoni se janë boshllëqet parësore në përgjigjen më të efektshme ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në vendin tuaj dhe/ose rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ju lutemi që të përfshini arsyet pse këto boshllëqe janë më të rëndësishme për të trajtuar trafikimin në mënyrë më të efektshme në vendin tuaj ose në rajon. (vetëm anglisht) (500 karaktere).

SEKSIONI E: PËRPARËSITË MË TË MËDHA PËR VEPRIM

Në këtë seksion, do të donim t'ju kërkonim që të prioritizoni hapat e ardhshëm që mendoni se duhet të hidhen për t'ju përgjigjur më efektivisht trafikimit të qenieve njerëzore në vendin tuaj ose në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

E1. Ky seksion përmban një listë me reagime të mundshme ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ju lutemi që të përzgjidhni ato që mendoni se janë TRE PËRPARËSITË KRYESORE mes këtyre reagimeve.

	Zgjidhni 3

a) Përmirësimi i kuadrit ligjor për të kapur dhe ndjekur autorët e trafikimit të personave (p.sh. shtrirja ose qartësimi i përkufizimit të trafikimit, përmirësimi i dispozitave në lidhje me konfiskimin e aseteve)	❍
b) Forcimi i hetimit të rasteve të trafikimit (p.sh përmirësimi i aftësive të punonjësve të policisë, krijimi ose forcimi i njësive të posaçme)	❍
c) Forcimi i ndjekjes së çështjeve të trafikimit (p.sh përmirësimi i bashkëpunimit me gjyqësorin, gjurmimi i shpejtë i çështjeve të trafikimit, dhënia e anomatit për viktimat-dëshmitarë, mbledhja e informacionit ndërkufitar, përmirësimi i sistemit të sekuestrimit të aseteve të fituara në mënyrë të paligjshme nga trafikantët dhe dëmshpërblimi i viktimave)	❍
d) Përmirësimi dhe/ose realizimi i plotë i proceseve për identifikimin e viktimave (p.sh përgatitja e udhëzimeve për rishikim, zgjerimi i listës së agjencive me kompetenca për të identifikuar viktimat, shkëmbimi i informacionit në vend ose përtej kufijve në mënyrë më të efektshme, krijimi/përmirësimi i një linje direkte telefonike, garantimi i funksionimit të MM, trajnimi i punonjësve të policisë, inspektorëve të punës, rojeve kufitare, punonjësve të shëndetësisë dhe të tjerëve që përballen me migrantë/popullata të pambrojtura etj)	❍
e) Shtrirja e **gamës** së shërbimeve në dispozicion të viktimave të trafikimit (p.sh dhënia e mundësive për të marrë leje qëndrimi, mbështetje për paditë civile, ofrimi i vendeve të punës dhe trajnimit, etj)	❍
f) Shtrirja e **mbulimit** të shërbimeve ekzistuese për viktimat e trafikimit (p.sh aksesi në shërbime nuk varet nga seksi i viktimës, kombësia, lloji i trafikimit apo agjencia identifikuese)	❍
g) Shtrirja e **mbulimit** të shërbimeve për të lejuar që migrantë të brendshëm dhe të jashtëm që kanë qenë objekt shfrytëzimi të marrin shërbimet e kërkuara, përfshirë mbrojtje dhe ndihmë (edhe pse nuk identifikohen formalisht si viktima të trafikimit)	❍
h) Përmirësimi i **cilësisë** së shërbimeve për viktimat e trafikimit (p.sh garantimi që ato t'u afrohen nevojave të identifikuara dhe të kërkuara nga vetë viktimat)	❍
i) Zhvillimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit dhe/ose zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese ndërmjet organizatave tëanti-trafikimit **brenda vendit**	❍
j) Zhvillimi ose përmirësimi i **bashkëpunimit ndërkufitar** dhe/ose zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit për trafikimin (p.sh marrëveshje me **vende** të tjera)	❍

k) Përparësi tjetër (Ju lutem specifikoni)_____ _____	❍

E2. Ju lutemi të shpjegoni pse zgjodhët tre përparësitë në përgjigjet tuaja në E1. Pse janë këto përparësitë më të rëndësishme për ju? Sa e mundur është që të zbatohen? Cilat burime ekzistojnë për zbatimin e tyre? (Vetëm anglisht) (500 karaktere)

Nëse jeni i kënaqur me përgjigjet tuaja, ju lutemi që të klikoni butonin "Dërgo"

Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj.

Dërgo

Vlerësimi i Nevojave për Situatën Rajonale të Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor

Shtojca F:

Kodi dhe Fjalori Analitik

Më poshtë do të gjeni disa tabela ku renditen të gjitha kodet që përdoren për të organizuar, strukturuar dhe analizuar të dhënat cilësore (dokumente dhe intervista) të mbledhura si pjesë e Vlerësimit të Nevojave të Situatës Rajonale të Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor. Tabela gjithashtu tregojnë fjalorin e kodeve, pra, përkufizimin e çdo kodi.

Qëllimi i këtyre kodeve është që të menaxhohen, organizohen dhe analizohen të gjitha të dhënat cilësore duke përdorur software QDAS- analizimi i të dhënave cilësore. Qëllimi i fjalorit të kodeve është që të orientojë dhe të japë kodim konsistent të të dhënave cilësore për stafin e kërkimit, dokumentet e studimit dhe intervistat e zbardhura. Fjalorit i kodeve ofron gjithashtu trasnparencë në lidhje me mënyrën e kodimit të të dhënave dhe mbështet qasjen e bazuar tek ekipi për kodimin, ku dy ose më shumë anëtarë të ekipit që ndodhen në vende të shpërndara kodojnë të dhënat cilësore. Përdorimi i disa koduesve mundëson që të mbështesim kodim më të besueshëm dhe të vlefshëm dhe përbën një mjet më të efektshëm për kodimin e vëllimit të të dhënave të përfshira në vlerësimin e nevojave (MacQueen, et al 2008). Përkufizimet që gjenden nëfjalorin e kodeve mbështesin aplikimin sistematik dhe konsistent të kodeve. Të marra së bashku, kodet dhe fjalori i tyre do të sigurojnë analizë të plotë, të strukturuar dhe sistematike të të dhënave cilësore të studimit.

- Vetëm për përdorim të brendshëm, që të orientojë fazën e parë të analizimit të të dhënave cilësore.

I. Panorama Aktuale e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (Memo e brendshme, tema: TRENDINË TP)

1. Cilat trende, forca, faktorë ose modalitete të reja të TP janë shfaqur në rajonin e Ballkanit Perëndimor?

Kodi	Përkufizim
Trafikim	Trende ose modele që të intervistuarit i identifikojnë si rrugët parësore të trafikimit nga, në dhe/ose përmes rajonit (kush, kur, nga kush, për çfarë qëllimi, si, etj)
Migracion	Trende ose modele të migracionit, migracion i parregullt, migracion i brendshëm (p.sh kush, kur, për çfarë qëllimi, si, nga kush, etj)
Industri/Formë shfrytëzimi	Trende ose modele të nxjerrjes së parave, punës ose kapitalit tjetër njerëzor nëpërmjet shtrëngimit, kërcënimit ose abuzimit që të intervistuarit i identifikojnë si të zakonshme në rajon (ose një vend në rajon), përfshirë industritë.
Përkufizim i TP	Variacione në mënyrën sesi të intervistuarit artikulojnë atë që mendojnë se ata se çfarë janë TP, çfarë konsiderohet TP, dhe/ose në cilat rrethana njerëzit që kanë migruar dhe kanë qenë objekt shfrytëzimi duhet të konsiderohen si "të trafikuar"

II. Përcaktimi i Burimeve të Anti-trafikimit (Memo e brendshme, tema: BURIME EKZISTUESE – LIGJORE, POLITIKASH, INSTITUCIONALE, PARTNERITETI)

2. Cili është kuadri ligjor dhe i politikave për identifikimin dhe referimin e personave që mund të kenë qenë objekt i shfrytëzimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore?

3. Cilat institucione ofrojnë aktualisht mbrojtje dhe ndihmë për ata që kanë qenë objekt trafikimi në rajon dhe/ose nga vendi?

4. Cilat lloj partneritete, rrjete dhe bashkëpunime mes aktorëve të anti-trafikimit ekzistojnë në rajon dhe/ose nga vendi?

Kodi	Përkufizim
Ligje dhe politika	Legjislacione zyrtare, procese ligjore, rregulla ligjore, praktika ose procedura të shkruara që përcaktojnë 1) si të identifikohen, përcaktohen/emërohen dhe/ose referohen personat që kanë qenë objekt trafikimi ose shfrytëzimi në migracion (brenda ose jashtë) dhe/ose (2) kush e ka këtë autoritet. Përfshin udhëzimet për rishikim
Identifiko/procese identifikimi	Procedura, procese dhe mekanizma specifike për të identifikuar viktimat e trafikimit, përfshirë linjat direkte telefonike, kontrollin e p.sh. migrantëve të deportuar, strukturave të referencës për punonjësit e shëndetësisë, mësuesit
Refero/procese dhe mekanizma referimi	Mekanizma formale ose informale për referimin e viktimave ndërmjet shërbimeve, si për shembull mekanizma kombëtare referimi, marrëveshje ndërkufitare
Rrjete/partneritete/bashkëpunim, mekanizëm formal bashkëpunimi	Rrjete/partneritete formale ose informale të përfshira në dhënien e ndihmës për viktimat e TP, si në vend ashtu dhe ndërmjet vendeve, përfshirë MM. Bashkëpunimi bazuar në aktivitete ndërmjet agjencive që punojnë për identifikimin dhe mbështetjen e viktimave
Institucion qeveritar	Çdo organ qeveritar, ministri ose organizatë zyrtare që ofron shërbime mbrojtjeje ose ndihme apo mbështetje për personat që kanë qenë objekt trafikimi ose shfrytëzimi në migracion (si brenda ashtu edhe jashtë)
Institucion OJQ	Çdo OJQ, ose organizatë ndërqeveritare që ofron shërbime mbështetjeje ose ndihme apo mbrojtjeje për personat që kanë qenë objekt trafikimi ose shfrytëzimi në migracion (si brenda ashtu edhe jashtë)
Institucion Ndërqeveritar	Çdo organizatë ndërqeveritare, dypalëshe ose shumëpalëshe që ofron shërbime/mbështetje për personat që kanë qenë objekt trafikimi ose shfrytëzimi në migracion (si brenda ashtu edhe jashtë, të rritur dhe fëmijë)
Ndihmë ligjore dhe mbrojtje	Mbështetje/ndihmë ligjore gjatë proceseve penale, proceseve civile, përfshirë vlerësimin e riskut ose shërbime mbrojtëse në dispozicion të personave që kanë qenë objekt trafikimi ose shfrytëzimi në migracion (si brenda ashtu edhe jashtë).
Shërbime në mbështetje të viktimave	Çdo lloj strehimi/akomodimi, kujdesi shëndetësor, shërbime të shëndetit mendor, periudhë reflektimi, leje pune/qëndrimi, formim profesional/kërkim pune, mbështetje financiare/fonde të mirëqenies sociale
Mekanizmat e kthimit dhe	Kërkesa për kthim, ndihmë për udhëtimin, mbështetje për

Kodi	Përkufizim
riintegrimit	riintegrim (strehim, kujdes mjekësor, ndihmë punësimi, mbrojtje etj.) dhe/ose monitorim i sigurisë dhe riintegrimit në dispozicion të personave që kanë qenë objekt trafikimi ose shfrytëzimi në migracion (si brenda ashtu edhe jashtë)
Shërbime të veçanta për fëmijët	Shërbime/procese/mbrojtje e veçantë në dispozicion për fëmijët e viktimave të trafikimit
Shërbime për personat jo të trafikuar	Kodim i veçantë i ndonjërës dhe të gjitha shërbimeve dhe mekanizmave në dispozicion për të ndihmuar personat që nuk janë përcaktuar si viktima, por që qartazi janë migrantë të shfrytëzuar (në migracion të brendshëm ose të jashtëm)
Mekanizmi i reagimit	Procese formale ose informale nëpërmjet të cilave viktimat mund të japin reagimin e tyre për shërbimet që kanë marrë/nuk kanë marrë
Burime financimi	Qeveritare, donator qeveritar i jashtëm, fondacion privat që siguron fonde për vendet e Ballkanit ose organizatat që ofrojnë mbrojtje ose shërbime/mbështetje/ndihmë për personat që kanë qenë objekt trafikimi ose shfrytëzimi në migracion (si brenda ashtu edhe jashtë)

III. Përshkrimi i boshllëqeve në burime (Memo e brendshme, tema: BOSHLLËQET KRYESORE)

5. Cilat janë boshllëqet në mekanizmat e identifikimit, mekanizmat e referimit, programet e mbrojtjes dhe ndihmës?

Kodi	Përkufizimi
Boshllëk identifikimi	Mekanizëm i munguar ose i papërshtatshëm, struktura, ligji/dispozita ligjore, politika ose procedura në rajon (vend) në lidhje me **gjetjen dhe përcaktimin e statusit** të personave që mund të jenë trafikuar ose shfrytëzuar dhe kanë nevojë për ndihmën
Boshllëk referimi	Mekanizëm i munguar ose i papërshtatshëm, struktura, ligji/dispozita ligjore, politika ose procedura në rajon (vend) në lidhje me **identifikimin dhe kontaktimin e ofruesve të shërbimeve** që mund të ndihmojnë personat të cilët mund të jenë trafikuar ose shfrytëzuar me çdo lloj nevoje që mund të kenë (fizike, mendore, ligjore, udhëtimi etj)
Boshllëk mbrojtjeje	Mekanizëm i munguar ose i papërshtatshëm, struktura ose shërbimi në rajon (vend) në lidhje me **ofrimin e mbrojtjes** për personat të cilët mund të jenë trafikuar ose shfrytëzuar
Boshllëk shërbimi/mbështetjeje	**Shërbimet apo mbështetja e munguar ose e papërshtatshme** në rajon (vend) të cilat i kërkojnë personat që mund të jenë trafikuar ose shfrytëzuar
Boshllëk në kthim dhe integrim	**Shërbimet e munguara ose të papërshtatshme të kthimit ose riintegrimit** në rajon (vend) të cilat i kërkojnë personat që mund të jenë trafikuar ose shfrytëzuar
Boshllëk tjetër	Çdo mekanizëm **tjetër i munguar** ose i papërshtatshëm, strukturë, politikë, procedurë, shërbim ose mbështetje në rajon (vend) të cilat i kërkojnë personat që mund të jenë trafikuar ose shfrytëzuar

IV. Nevojat sipas përparësive (Memo e brendshme, tema: NEVOJAT PRIORITARE)

6. Çfarë vendosin si prioritare aktorët e interesuar për t'ju përgjigjur boshllëqeve në mekanizmin ekzistues të identifikimit, referimit dhe mbështetjes?

Kodi	Përkufizim
Prioriteti i identifikimit	Ato boshllëqe në mekanizma në lidhje me **gjetjen dhe përcaktimin e statusit** të personave që mund të kenë qenë trafikuar ose shfrytëzuar të cilat të intervistuarit i prioritizojnë si të tilla që kanë nevojë për zhvillim ose përmirësim të menjëhershëm në rajon (ose vend në rajon)
Prioriteti i referimit (akses)	Ato boshllëqe në mekanizma në lidhje me **identifikimin dhe kontaktimin** e ofruesve të shërbimeve për **të ndihmuar** personat që mund të kenë qenë trafikuar ose shfrytëzuar të cilat të intervistuarit i prioritizojnë si të tilla që kanë nevojë për zhvillim ose përmirësim të menjëhershëm në rajon (ose vend në rajon)
Prioriteti i mbrojtjes/mbështetjes ligjore (akses)	Ato boshllëqe në mekanizma në lidhje me **ofrimin e mbrojtjes**/mbështetjes ligjore për personat që mund të kenë qenë trafikuar ose shfrytëzuar të cilat të intervistuarit i prioritizojnë si të tilla që kanë nevojë për zhvillim ose përmirësim të menjëhershëm në rajon (ose vend në rajon)
Prioritetii shërbimit/mbështetjes (cilësi)	**Shërbimet ose mbështetja** për personat që mund të kenë qenë trafikuar ose shfrytëzuar të cilat të intervistuarit i prioritizojnë si të munguara dhe në nevojë urgjente për zhvillim ose përmirësim në rajon (ose vend në rajon)
Boshllëku në kthim dhe riintegrim	**Shërbimet e kthimit ose riintegrimit** të cilat të intervistuarit i prioritizojnë si të munguara dhe në nevojë urgjente për zhvillim ose përmirësim në rajon (ose vend në rajon)
Përparësi tjetër	Boshllëqe të tjera në mekanizmat e reagimit ndaj trafikimit të qenieve njerëzore ose shfrytëzimit të migrantëve të cilat të intervistuarit i prioritizojnë si të munguara dhe në nevojë urgjente për zhvillim ose përmirësim në rajon (ose vend në rajon)

V. Rekomandimet prioritare (Memo me temë: REKOMANDIME)

7. Çfarë rekomandojnë aktorët si (1) hapat e ardhshme të menjëhershme që duhet të merren, (ii) qëllime të përkohshme, dhe (iii) qëllime afatgjata, shtrirjen ose përmirësimin e mekanizmave ekzistuese dhe burimeve për të luftuar TP dhe për të ndihmuar viktimat në Ballkanin Perëndimor?

Kodi	Përkufizim
Hapi tjetër	Të intervistuarit **rekomandojnë** që çdo reagim ndaj TP dhe shfrytëzimit të migrantëve të zhvillohet, forcohet ose përmirësohet **menjëherë**; përfshini arsyet që japin të intervistuarit për këtë rekomandim
Qëllimet të përkohshme dhe afatgjata	Të intervistuarit **rekomandojnë** që çdo reagim ndaj TP dhe shfrytëzimit të migrantëve të zhvillohet, forcohet ose përmirësohet **në periudhën afatmesme ose afatgjatë**; përfshini arsyet që japin të intervistuarit për këtë rekomandim

Referenca

MacQueen, Kathleen M., Eleanor McLellan, Kelly Kay, dhe Bobby Milstein (2008) "Team-Based Codebook Development Structure, Process and Agreement." *Handbook for Team-Based Qualitative Research*, G. Guest and K. MacQueen, eds. Plymouth, UK: AltaMira Press: 119-136.

APPENDIX G:
PROVISIONAL LIST OF PARTICIPANTS
Validation Seminar
Needs Assessment of the Regional Counter-Trafficking Situation in the Western Balkans
May 2014
Skopje

TAKIM VLERESIMI

	VENDI	TITULLI/INSTITUCIONI ose ORGANIZATA	
1	Shqipëri	Zëvendës Ministre e Punëve të Brendshme, Koordinatore Kombëtare e Anti-Trafikimit	
2	Shqipëri	Coordinator, Anti Trafficking Unit, Ministry of Internal Affairs	
3	Shqipëri	Specialiste e Anti-Trafikimit, Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit/ Anëtare e Autoritetit Përgjegjës	
4	Shqipëri	Specialiste, Shërbimi Social Shtetëror / Anëtare e Autoritetit Përgjegjës	
5	Shqipëri	Presidenti I radhës, Koalicioni Kombëtar I Strehëzave Anti-Trafik	
6	Bosnjë Hercegovinë	Koordinatori Kombëtar Anti-Trafikim, Ministria e Sigurisë	
7	Bosnjë Hercegovinë	Inspektor I Lartë, Drejtoria për Koordinimin e Organeve Policore të Bosnjë Hercegovinës	
8	Bosnjë Hercegovinë	Asistent I Ministrit, Ministria e Shtetit ptë Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët	
9	Bosnjë Hercegovinë	Senior Inspector, Service for Foerign Affairs, State Minsitry of Security	
10	Bosnjë Hercegovinë	OJQ Medica, Zenica	
11	Mali i Zi	Zyra për Luftën Kundër Trafikimit	
12	Mali i Zi	OJQ Montenegrin Woman's Lobby	
13	Mali i Zi	Drejtoria e Policisë, Njësia kundë Krimit të Organizuar	
14	Serbi	Koordinatori Kombëtar Anti-Trafikim, Ministria e Brendshme	
15	Serbi	Këshilltar, Ministria e Punes, Politikat e Punesimit dhe Sociale	
16	Serbi	Koordinator, Qëndra për Mbrojtjen e VT	
17	Kosovë	Zëvendës Minister, Koordinatori Kombëtar i Anti-Trafikimit	
18	Kosovë	Departamenti kundër Krimit të Organizuar, Sektori për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore;	
19	Kosovë	Qëndra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve– OJQ lokale	
20	Kosovë	Terre des Homes	
21	Maqedoni	Zëvendës Koordinator Kombëtar i Anti-Trafikimit	
22	Maqedoni	State Counselor, Misitry for Labor and Social Policy	
23	Maqedoni	President, OJQ Open Gate/La Strada Maqedoni	
24	Maqedoni	President, OJQ Open Gate/La Strada Macedoni	
25	Maqedoni	Drejtues, Njësia për Luftën kundër Trafikimit	
26	Maqedoni	Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj	
27	Maqedoni	OJQ Equal Access	

APPENDIX G:
PROVISIONAL LIST OF PARTICIPANTS
Validation Seminar
Needs Assessment of the Regional Counter-Trafficking Situation in the Western Balkans
May 2014
Skopje

		ORGANIZATAT NDERKOMBETARE DHE DONATORET	
28	**Delegacioni Europian**	Këshilltar Politik	
29	**Delegacioni Europian**	Program Menaxher/EIDHR	
30	**Ambasada Amerikane**	Political Officer, U.S. Embassy in Skopje	
31	**Ambasada Amerikane**	Political Assistant, U.S. Embassy in Skopje	
35	**Departamenti I Shtetit Amerikan, Zyra për Monitorimin dhe Luftëen kunder Trafikimit të Personave**	Koordinator I Lartë për Programet, Zyra për Monitorimin dhe Luftëen kunder Trafikimit të Personave	
		RCG	
36	**RCG**	Researcher, Social and Development Policy Specialist	
37	**RCG**	Researcher, International Human Rights, Public and Social Policy	
		IOM	
38	**IOM**	Specialist i Lartë për Asistencën Rajonale të Migrantëve, zyra rajonale e Vjenë	YES
39	**IOM**	Koordinatori Rajonal per Ballkanin Perendimor	YES
40	**IOM**	AVRR dhe Asistent Kundër Trafikimit, zyra rajonale Vjenë	YES
41	**IOM**	Konsulent, IOM Sarajev	YES
42	**IOM**	Specialist për Ndihmen ndaj Migrantëve, IOM Shkup	YES
43	**IOM**	Shef I Zyrës, IOM Shkup	YES
44	**IOM**	Pikë Kontakti Anti-Trafikim, IOM Beograd	YES
45	**IOM**	Head of Office, IOM Belgrade	YES
46	**IOM**	Koordinatore e Projekteve Anti-Trafikim, IOM Tiranë	YES
47	**IOM**	Shefe e Zyrës, IOM Shkup	YES
48	**IOM**	Shefe e Zyrës, IOM Podgoric	YES
49	**IOM**	Koordinator Projekti AVR	YES
50			
51			

RCG

Shtojca H:

Studim për Vlerësimin e Nevojave Situata Rajonale e Anti-Trafikimit në Ballkanin Perëndimor

7 maj 2014

Prezantim i përmbajtjes

- Sfondi dhe qëllimi i Vlerësimit të Nevojave
- Metoda dhe metodologjia e Studimit
- Gjetjet e studimit
  - Situata
  - Boshllëqet
- Rekomandime
- Diskutime dhe Përmirësime

Një shënim i rëndësishëm për vlerësimin e nevojave



Qëllimi i tryezës së punës

- Rishikim i qëllimit dhe metodës së vlerësimit të nevojës
- Prezantimi i gjetjeve dhe rekomandimeve
- Diskutimi, debatimi, përmirësimi, dhe/ose vlerësimi i gjetjeve dhe rekomandimeve
- Përdorimi i rezultateve për të rishikuar dhe prioritizuar raportin
- Informimi i hapave dhe masave të ardhshme drejt zhvillimit të reagimit më të efektshëm ndaj TP në rajon

Sfondi

Sfondi

- TP si një sfidë e vazhdueshme dhe komplekse rajonale
- Kërcënim i vazhdueshëm për njerëzit që lëvizin në kërkim të mundësive për punë
- Keqësuar nga flukse të reja migratore pas zgjerimit të BE-së dhe ngushtimit të kufirit rajonal
- Më serioze mes grupeve shoqërore të pa mbrojtura

Source: FRAN and ëB-RAN as of 15 February 2012, ESRI geodata



Metoda dhe Metodologjia


Metoda
Këndvështrimi i aktorëve përdoret si provë empirike
Përcaktimi i Pyetjes së Studimit dhe matricës studimin
Trekëndëzim i të dhënave cil, sas & të palës së tretë
Rekomandime:
° Aktorët
° Të dhënat


Metodologjia
Identifikimi i Aktorëve
Identifikimi i grupit të qëndrueshëm të pjesëmarrësve
Rishikim i dokumenteve
Prezantimi i mendimeve të palës së tretë
Intervista në terren/me telefon
Mbledhja e të dhënave të detajuara
Sondazh në internet
Përfshirja e këndvështrimeve më të gjera
Kodimi dhe analizimi i të dhënave
Sigurimi i analizës sistematike
Tryezë pune e aktorëve
Zhvillimi, përmirësimi dhe vlerësimi i rezultateve të studimit
Informimi dhe përmirësimi I përgjigjes ndaj TP

Gjetjet

Situata: Tendencat që po shfaqen

TP në rajon përfshin shumësi modelesh, formash shfrytëzimi dhe shtrëngimi

- Më shumë raste trafikimi sesa ato që janë identifikuar
- Shumica e rasteve *të identifikuara*: gra të shfrytëzuara në industrinë e seksit
- Shumë raste lidhen me forma shtesë të shfrytëzimit për punë
- Shfaqja e formave të reja të shfrytëzimit të fëmijëve
- Trafikimi i brendshëm shfaqet në rritje
- Konflikte në Azinë Qendore/Afrikë kanë nxitur lëvizjen e migrantëve drejt Ballkanit Perëndimor si pikë transiti për zonën Shengen



Situata e identifikimit: Pikat e forta

- Strategji Kombëtare dhe Plane Veprimi të mirë hartuara
- Ligj, rregulla dhe rregullore të konsoliduara

  - Procedura Standarde Pune
  - Ndërhyrje multi-disiplinore
  - Bashkëpunim mes sektorëve kyc

- Raste të bashkëpunimit të fuqishëm dhe MKR aktiv, përfshirë mendimin e atyre që marrin shërbimin
- Theks i ri në trajnimin, uljen e vulnerabilitetit dhe metoda multidisiplinore identifikimit

Situata e identifikimit: Sfidat

- Sisteme të ndryshme dhe ndonjëherë kontradiktore për identifkimin e rasteve të TP
- Mangësi në mekanzimat e identifikimit
  - Roli parësor i policisë
  - Mospërputhje në përkufizim
  - Kufizime institucionale
- Pengesa kryesore për identifikimin
  - Përjashtimi I shfrytëzimit për punë nga përkufizimet e TP
  - Mospjesëmarrja e inspektorëve të punës në proceset e identifikimit



Situata e mbështetjes: Pikat e forta

- **Ndihma thelbësore** duket se ofrohet nga strehëzat në të **gjitha** vendet, përfshirë **kujdesi mjekësor emergjent, falas**
- **Si shteti ashtu dhe OJQ-të** janë të angazhuara për të dhënë mbështetje, shpesh në shembull të bashkëpunimit pozitiv

- **Linja telefonike** që njerëzit të kërkojn ndihmë në mënyrë anonime ekzistojn në shumicën e vendeve
- Shembuj të suksesshëm të mekanizmave të **reagimit të viktimës** kanë filluar të shfaqen

Situata e mbështetjes: Sfida

- Mbështetja dhe shërbimet variojnë sipas llojit të trafikimit – të brendshëm, ndërkombëtar dhe sektor i punës
- Akomodimi = në strehëz dhe drejtuar nga OJQ
  - Nuk ka strehëza vetëm për fëmijët
  - Nuk ka strehëza për meshkujt
- Periudha e reflektimit dhe lejet e përkohshme të qëndrimit varen nga bashkëpunimi me autoritetet
- Shumë pak dëmshpërblim për viktimat
  - Procedura komplekse ose jo funksionale
  - Mungesa e mbështetjes ligjore
  - Disa raste mosinkurajimi

Shërbimet mbështëtëse që ofrohen

	Plotësisht mjaftueshëm	Disi mjaftueshëm	Mjaftueshëm vetëm për disa grupe	Pamjaftueshëm	Tërësisht pamjaftueshëm	Nuk e di
Strehëz afatshkurtër	34.7	24.5	20.4	4.1	2.0	14.3
Strehëz ose strehim afatgjatë	30.6	22.8	19.2	6.2	2.1	19.2
Kujdes mjekësor	31.6	41.8	12.2	9.2	0.0	5.1
Shërbime psiko-sociale	41.8	34.7	15.3	3.1	0.0	5.1
Vlerësim i riskut	33.0	37.1	14.4	10.3	1.0	4.1
Mbështetje ligjore (civile ose penale)	27.3	34.0	13.4	12.9	5.7	6.7
Mbështetje punësimi	10.8	32.6	24.0	14.9	2.4	15.3
Kthim dhe/ose riintegrim	28.0	34.2	14.0	6.7	2.6	14.5
Rivendosje ose integrim	18.5	20.5	13.8	15.4	4.1	27.7

Situata: Bashkëpunimi



Boshllëqe: Mekanizma identifikimi

Boshllëqe: Mbështetje, Shërbime, Cilësi

- Shumë VT nuk shërbehen mjaftueshëm nga shërbimet në dispozicion
- Shërbimet afatgjata të riintegrimit mbeten sfidë në rajon
- Mekanizmat e mbrojtjes për personat e trafikuar nuk funksionojnë/zbatojnë në mënyrë të qëndrueshmë
- Ekzistojnë pak sisteme për të siguruar që ndihma që u jepet viktimave
  - Plotëson standardet minimale
  - Konsiderohet e përshtatshme nga ata që e kërkojnë

Rekomandime

Rekomandime



Rekomandime: Identifikim 1

1. Përfshirja e një game më të gjerë aktorësh: në *identifikimin proaktiv*: inspektorë të punës, staf shëndetësor, punonjës social dhe mësues
2. Forcimi i aftësive dhe kapaciteteve të policë për identifikimin e trafikimit, përfshirë përzgjedhjen, intervistimin dhe referimin e rasteve në mënyrën e duhur
3. Forcimi i kapaciteteve dhe motivimit të aktorëve jo-policorë përgjegjës për identifikimin e personave të trafikuar

Rekomandime: Identifikimi 2

4. Ndjekja e një metode proactive për identifikimin e rasteve të trafikimit

Rekomandime: Mbështetja

1. Dhënia e mbështetjes për të gjitha format e trafikimit
2. Zhvillimi i shërbimeve dedikuar fëmijëve
3. Përmirësimi i cilësisë së të gjitha shërbimeve
4. Dhënia e mbështetjes afatgjatë, të qëndrueshme e për riintegrim

Rekomandime: Bashkëpunimi

1. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit mest aktorëve kombëtare në përgjigje të trafikimit
2. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet
   - Përmirësimi i zbatimit dhe institucionalizimit të MNR rajonal
   - Forcimi i formave të tjera të bashkëpunimit ndërkufitar
   - Krijimi i Ekipeve të Përbashkëta Hetimore

Rekomandime: Drejtësia Penale

1. Forcimi i kapacitetit të aktorëve të drejtësisë penale për të
   - mbrojtur viktimat e trafikimit
   - ndjekur trafikantët në plotësinë e ligjit
2. Forcimi i mbështetjes në procesin e drejtësisë penale
   - Realizim i plotë i periudhës së reflektimit
   - Mbështetje e duhur gjatë procesit ligjor
   - Ndihmë ligjore për të kërkuar dëmshpërblim

Rekomandime: Angazhimi i qeverisë

1. Rritja e financimit për programet kundër TP, sidomos për OJQ-të dhe institucionet që mbështesin personat e trafikuar

Rekomandime: Qëndrime

1. Përfshirja e veprimtarive për të trajtuar qëndrime që pengojnë reagimin ndaj trafikimit
   - Trajnime përkatëse
   - Fushata ndërgjegjësimi
   - Takime për përmirësimin e aftësive

Diskutim dhe Përmirësim

Diskutim në grup të vogël

- **Grupe të vegjël** trajtojnë çështje dhe identifikojnë prioritetet më të rëndësishme për t'u trajtuar në nivel rajonal

Shënime përmbyllëse

- Vlerësimi i nevojave është hap pozitiv, produktiv që fokusohet në nevojat, boshllëqet dhe prioritetet për veprim në të ardhmen
- Të gjitha vendet kanë marrë dhe vazhdojnë të marrin, masa të rëndësishme për të luftuar dhe reaguar ndaj TP
- Natyra e sfidave të TP e bën të vështirë që të realizohet kthimi me investim, sidomos në këtë kohën të mungesës së burimeve dhe prioriteteve konkurruese

Shënime përmbyllëse

- Reduktimi i numrit të personave të trafikuar kërkon që ata të identifikohen dhe të ndihmohen për të dalë nga situata shfrytëzuese
- Arritja e këtij qëllimi kërkon
  - Ndihmë për viktimat, përfshirë mbështetjen afatgjatë për riintegrim
  - Trajtimi I shkaqeve, trafikantët, duke e bërë trafikimin një biznes jo fitimprurës
- Këto dy fusha janë të lidhura ngushtë
  - Nëse ofrohen shërbime më të mira, ka më shumë mundësi që viktimat të kërkojnë ndihmë dhe të bashkëpunojnë me autoritetet ligjore
  - Nëse afrohen më shumë viktima, identifikohen rrjetet e trafikimit
  - Progresi me dëmshpërblimin i shërben si qëllimit për riintegrim ashtu edhe qëllimit për ta bërë trafikimin sa më pak tërheqës

Faleminderit për vëmendjen dhe reagimin tuaj